

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 392 KORRIK 2023



OBJEKTIVAT E EDUKIMI ISLAM

MEDIATIZIMI I FESË APO FEJA MEDIATIKE

MIRUPAFSHIM, MEKË!

Urimi i Myftiut të Kosovës me rastin e festës së Bajramit të Kurbanit 2023

Të nderuar besimtarë,

Vëllezër e motra,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Më lejoni që në këtë ditë të madhe të Arafatit, në prag të festës së Bajramit të Kurbanit, të ju drejtohem me urimet e përgëzimet më të mira, duke e lutur Zotin, xh.sh., që të ju begatojë me shëndet, harmoni, mbarësi e mirëqenie!

Sot, në këtë ditë të madhe – Ditën e Arafatit, kam nderin dhe kënaqësinë që në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve të saj, si dhe në emrin tim, t'u bashkohem lutjeve e adhurimeve të besimtarëve myslimanë që sot gjenden në rrafshnaltën e Arafatit, ku të gjithë të veshur me petkun e bardhë – me ihram, të barabartë e pa asnjë dallim, me çiltërsinë shpirtërore e me bindje dhe sinqeritet, po e kryejnë obligimin e haxhit.

Në mesin e miliona hanxhinjve nga e gjithë bota të cilët sot gjenden në Arafat, sigurisht se janë edhe besimtarët tanë nga Kosova dhe viset e tjera, e të cilët në formën më të mirë dhe me lutje e adhurim, të përkushtuar e pa dallim statusi shoqëror, gjinie, etnie, gjuhe e origjine, shprehin me ndjesinë më të thellë besimin dhe përkushtimin e tyre ndaj Krijuesit të gjithësisë.

Të nderuar besimtarë,

Vëllezër e motra,

Me kryerjen e haxhit besimtari shpreh, në mënyrë shpirtërore, emocionale e fizike, përkushtimin vetjak e kolektiv për Zotin, xh.sh., i bindur në faljen e mëkateve dhe në shpërblimet e shumta dhe të veçanta të premtuara prej Zotit Fuqplot.

Kryerja e haxhit përmban në vete urtësi e begati të shumta. Haxhi na e rikujton udhëtimin për te Zoti, xh.sh., duke pasur për qëllim që haxhiu të kthehet i pamëkate. Zoti, xh.sh., thotë: "Vizita e shtëpisë (Qabesë) është obligim, për ata që kanë mundësi udhëtimi tek ajo." (Ali Imran)

Po ashtu, haxhi bart në vete edhe ndjenjën e barazisë mes njerëzve, pa dallim. Në Arafat që të gjithë ndihen të barabartë, e kjo është një dëshmi e madhe, ku tregohet e manifestohet uniteti i fortë në besim, në ndjenja dhe në rituale.

Qëndrimi në Arafat prandaj është një ibadet i rëndësishëm, dhe në këtë ditë Allahu, xh.sh., derdh rahmetin e Tij mbi besimtarët që gjenden aty dhe mbi njerëzimin mbarë, i pranon lutjet e tyre dhe u përgjigjet në dua. Për këtë arsye lutja më e mirë dhe më e pranueshme tek Zoti është: "Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut Një, Ai nuk ka ortak".

Edhe prerja e kurbanit në Ditën e Bajramit sakaq është një ibadet tjetër shtesë, dhe argumenton po ashtu shpirtin e bindjes për Zotin dhe, në të njëjtën kohë, ka për qëllim, qoftë edhe për një kohë të caktuar, mbylljen e hendekut dhe të ndasive mes shtresave të ndryshme shoqërore, duke e rritur bashkëpunimin, e duke e afruar ndihmën dhe duke ia dhënë dorën njëri-tjetrit.

Zoti, xh.sh., në Kuranin fisnik, thotë: "Në të vërtetë të dhamë ty shumë të mira. Prandaj t'i falu dhe ther kurban për hir të Zotit tend!" (El Kevther: 1-2.)



Therja e kurbanit historikisht na e rikujton veprimin e Ibrahimit, a.s., me birin e tij, Ismailin, a.s., i cili ishte i gatshëm ta flijonte edhe të birin e vetëm për hir të Zotit, xh.sh.

Sakrifica, pra, ka kuptim të veçantë vetëm atëherë kur bëhet për hir të Krijuesit, dhe vetëm atëherë e merr kuptimin dhe dimensionin sa hyjnor, po aq edhe human e social. Zaten, këtë mision e ka edhe prerja e kurbanit; derisa te nevojtarët arrin mishi i kurbanit, te Zoti arrin vetëm qëllimi dhe nijeti i mirë i punëve bërë në emër të Tij.

Të dashur besimtarë,

Festa e Bajramit të Kurbanit te ne vazhdimisht e ka përçarur në formën më të mirë të mundshme shpresën, begatinë, solidaritetin, ndihmën për tjetrin, urtësinë, paqen e mirëkuptimin, vlera këto që shoqërisë i japin kuptim, dhe këtë na e kërkon edhe Krijuesi ynë.

Sot po jetojmë në një kohë trazirash, luftërash, pasigurish, konfliktesh e frike. Në këtë ditë të madhe, në vigjilje të Bajramit të Kurbanit, lutemi që mesazhet dhe porositë që i bart kjo festë të kuptohen drejt prej të gjithëve; lutemi po ashtu që bota të ketë sa më pak konflikte, ngatërresa, luftëra e çrregullime. Festa e Bajramit të Kurbanit e ka edhe domethënien e paqes, të drejtësisë, të unitetit e të mirëkuptimit.

Duke ju uruar për festën e madhe të Bajramit të Kurbanit, e lus Zotin për shëndet, mbarësi, begati, dashuri e harmoni në familjet tuaja!

*Me fat e mbarësi festa e Bajramit të Kurbanit!
Prishtinë, 27 qershor 2023.*

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnavë.

- 2 Urimi i Myftiut të Kosovës me rastin e festës së Bajramit të Kurbanit 2023

EDITORIAL

- 5 Le të vazhdojmë t'i qëndrojmë pranë njëri-tjetrit!

FE & SHKENCË

- 8 Komentimi i sures El Fet'h (6)

Sabri Bajgora

- 12 Objektivat e edukimit islam

Dr.Valmire Batatina Krasniqi

- 16 Besimtari dhe pastërtia

Hetem Sopjani

- 18 Fëmijëria e të dërguarit të Allahut, a.s.

Mr. Besim Krasniqi

- 21 Kodi islam i mirësjelljes në telefon dhe në mediet sociale

Dr. sci. Flamur Sofiu

- 24 Përse nuk mund t'i shijoj namazet që i fali?!

Doç. Dr. Soner Duman

- 27 Mediatizimi i fesë apo feja mediale

Festim Rizanaj, PhD

- 30 Kimikatet dhe ndikimi i tyre në shëndet

MSc. Njomza Sadriu

FAMILJE & EDUKIM

- 33 Shkurorëzimet e shpeshta dhe shkaqet e tyre

Nehat Shehu

- 37 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore

Argjent Xheladini



- 40 Sfidat e edukimit të brezave në kohën e internetit

Dr. Azmir Jusufi

PERSONALITETE

- 43 Ibën Hazm, kolosi mysliiman spanjoll

Nexhat Ibrahim

- 47 Knud Ali Holmboe

Klodiana Xhaferaj

KULTURË

- 49 Mirupafshim, Mekël

(Besnik Jaha)

- 51 Një vështrim filleve të literaturës islame në gjuhën shqipe në Kosovë (2)

Arbin Ahmeti

HISTORI & CIVILIZIM

- 54 Legjislacioni Osman për Ruajtjen e Rendit Publik në Hapësirën e Kosovës gjatë viteve 1700-1800

Prof. Ass. Dr. Agron Islami

- 58 Koncepti i Gazasë në shtetin Osman

Agon Krasniqi

AKTIVITETE

- 60 Në Kosovë u kremtua festa e Bajramit të Kurbanit



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 392 • viti 37 • korrik 2023
• Dhul-Hixhxe 1444
• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi

Anëtarë:

Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci, mr. Muharrem Tërnavë, mr. Vedat Shabani.

Sekretar redaksie: Dr. Rexhep Suma

Lektor & korrektor: Bajram Zeqiri

Redaktor artistik & teknik:

Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame", rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +384 38 224 024

E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net

Shtypi:

"Europrint", Prishtinë



“Thuaj: “Kush i ndaloi bukuritë e Allahut dhe ushqimet e mira që Allahu i krijoi për robërit e Vet?!”. Thuaj: “Ato janë në këtë botë për ata që besuan, e në Ditën e Kiametit janë të posaçme për ta. Kështu ia sqaron argumentet një populli që kupton.”.

(El Aëraf, 22)

Eleganca si imazh i Islamit

Eleganca, duke qenë se s'mund të jetë tjetër përveçse një shije për dukje të jashtme e të Ezbukurimit, si hijeshi me dinjitet dhe e përmbushur, e ndoshta edhe si një përmbajtje ndaj një stili estetik në jetë, do të na e mundësojë ta kemi më të lehtë gjykimin për normën e saj, madje edhe për ligjshmërinë e përfshirjes së saj në jetën e besimtarit. Si për shumë koncepte të tjera, edhe për elegancën myslimanët kanë goxha një përpëlitse idesh, dhe sigurisht edhe një konfuzion hamendës, e që duket se vështirë do t'i vijë fundi. Dilemat ngjallen në mendjet tona, ngase ndiejmë disi një pafuqi për ta ruajtur parasëshën në mes të dëshirës për devocion e asketizëm fetar, në njërën anë, dhe tendencës për elegancë e për imazh të kuruar, në anën tjetër. Ai që ka përkushtim të çekulibruar fetar, dhe anon më kah çiltërsia e shpirtit, e sheh shmangien nga eleganca si fetarësi e devocion. Rrjedhimisht, është i gatshëm për ta stereotipizuar atë si tipar të ballpërballshëm me thjeshtësinë e modestinë e Islamit. Ironikisht, ajo edhe tingëllon si tundim e ngarendje pas të mirave të kësaj bote, dhe duket si ndoshta harresë e vendpërhyes sonë përfundimtare-Ahiretit.

Megjithatë, një studiues i paanshëm i fesë së Zotit do të gjejë se eleganca dhe estetika janë pjesë e mishëruar e shpirtit, po edhe e praktikës së Islamit. Ajo në thelb është si një simbiozë e bukur dhe pjesë plotësuese e mozaikut mahnitës të normativave të ndryshme të kësaj feje. Dhe, është paradoksale të mendohet se në Islam mund të ketë vetëm ndonjë elegancë të stisur, joreale, e cila do të mund të instrumentalizohet sa për të krijuar imazh joshës për fenë tonë, dhe vetëm kaq. Jo, asses! Ajo është krejt autentike, e ngjizur dhe e shtresuar thellë në themelet e dinit të Zotit. Atë e gjejmë të kërkuar, madje në shkallë të urdhëresës në disa adhurime e praktika tjera jetësore, e natyrisht në shkallë të preferencës e të sugjeruarës edhe në disa pjesë të tjera. Në adhurimin më kulmor të Islamit-namaz, Allahu kërkoi elegancë, si parapërgatitje të kushtëzuar për ta filluar atë. Ai në një verset kuranor tha: “O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz (lutje)...!” El Aëraf, 31. Veshja e bukur, pedanteria, estetika, pastërtia fizike e, madje edhe parfumimi, nuk janë kërkesa që na drejtohen nga Islami, që t'i marrim parasysh vetëm në raste festash e kremtesh, siç janë ditët e Bajramit, që porsa i lamë pas. Përtej kësaj, ato janë porosi që, në saje të mundësive, do të duhej të mishëroheshim me to në përditshmërinë tonë, po aq sa është i përditshëm për ne edhe vetë namazi ynë. I Dërguari ynë (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të), me gjithë asketizmin kulmor që e tregonte ndaj të mirave të kësaj bote, megjithatë, rrallë dilte në rrugë pa u parfumuar. Aroma e miskut të tij mbetej edhe pas kalimit të tij, sa edhe kur shokët e tij nuk e shihnin, e nuhatnin parakalimin e tij nga era e miskut që atypari kishte kundërmuar.

Sikur për t'iu përgjigjur dilemave që mund të kenë besimtarët e përkushtuar ndaj çiltërsisë së shpirtit, kur ata e braktisin elegancën fizike, Ibën Abasi - Zoti pastë qenë i kënaqur më të, pati thënë: “Ha çfarë të duash, dhe vish çfarë të duash, mirëpo kujdes vetëm nga dy gjëra: teprimin dhe krekosjen-mendjemadhësinë!”. Ibën Ebi Shejbe.

Pikat mbi shkronja i ka vënë edhe Ibën Umeri - Zoti pastë qenë i kënaqur me të, kur tha: “Nga shenjat e burrërisë së njeriut është edhe pastërtia e petkut të tij”. (Adab Esherijje, Ibën Muflih).

Thënë shkurt, s'mund të afroresh te Zoti Fuqiplotë me braktisje e shpërfillje të kodit minimal të elegancës. Ai të do elegant e të përmbushur edhe me tiparet e estetikës. Muhamedi, a.s., Atë e përshkroi duke thënë: “Allahu është i Bukur, dhe e do të bukurën”. Sahihu i Muslimit.

Me një gjuhë tejet qortuese dhe më një qasje krejt eksplicite, Zoti Fuqiplotë e mbylli derën që dikush të ndalojë diç të bukur e të këndshme, e të cilën Zoti ua lejoi robërve të Tij. Ai tha: “Thuaj: “Kush i ndaloi bukuritë e Allahut dhe ushqimet e mira që Allahu i krijoi për robërit e Vet?!”. Thuaj: “Ato janë në këtë botë për ata që besuan, e në Ditën e Kiametit janë të posaçme për ta. Kështu ia sqaron argumentet një populli që kupton.”. El Aëraf, 22.

Bukuritë në këtë ajet Krijuesi ia atribuoi Vetvetes. Ai, pra, është Krijuesi dhe burimi i gjithë të bukurës, dhe si të tillë e bëri atë joshëse dhe, sigurisht se pastaj edhe të lejuar për robërit e Tij. E, nëse në jetën e kësaj bote, në këto bukuri, janë konkurrentë edhe ata që Zotin e mohuan, atëherë të tillat mbesin ekskluzivitet i besimtarëve në Jetën e Përmotshme. E, pra, Islami e ka sinonim edhe elegancën.

Mr. Driton Arifi

Hytbeja e Myftiut të Kosovës mbajtur në xhaminë Mehmed Fatih, më 28.06.2023, me rastin e festës së Bajramit të Kurbanit

Le të vazhdojmë t'i qëndrojmë pranë njëri-tjetrit!

Falënderimet dhe lutjet e përgjithshme ia drejtojmë vetëm Zotit, xh.sh., përshëndetjet qofshin mbi Muhamedin, a.s., të dërguarin e fundit, zotërinë e mbarë njerëzimit!

Të nderuar dhe shumë të respektuar besimtarë,

Haxhi është farz-obligim fetar islam, për atë që ka mundësi ta kryejë. Zoti, xh.sh., thotë: “Vizita e shtëpisë (Qabesë) është obligim për ata që kanë mundësi udhëtimi tek ajo” (Ali Imran, 97)

Haxhi është njëra nga pesë shtyllat e fesë sonë islame. Prandaj edhe, nisur nga ky parim, sot në vendet e shenjta kemi edhe 1600 vëllezër e motra nga Kosova, të cilët janë bashkangjitur me miliona haxhilerëve të tjerë nga e mbarë bota, në lutjet e adhurimet e tyre drejtuar Krijuesit të kësaj gjithësie. Edhe dje në Arafat, e edhe sot në Mina, me lutje të vazhdueshme drejtuar Zotit, xh.sh., për falje e mëshirë, përmirësim të gjendjes së shoqërisë njerëzore anekënd globit, duke u lutur për një të ardhme sa më të mirë për të gjithë njerëzit, pa dallim.

Me kryerjen e haxhit kuptojmë arritjen e kënaqësisë së Zotit, xh.sh., faljen e mëkateve, shpërblim të veçantë për ata që e falin namazin në Qabenë e bekuar, shpërblim për tavaf, për sajnin dhe ibadetet - adhurimet e tjera. Kryerja e haxhit përmban në vete urtësi e begati të shumta; udhëtimi për në haxh përkujton udhëtimin për te Zoti, xh.sh., duke pasur për qëllim që haxhiu të kthehet i falur nga mëkatet, i shoqëruar gjithherë me vepra të mira, të cilat në vazhdimësi e çojnë individin, familjen dhe shoqërinë nga një e ardhme e sigurt, për të mirën e të gjithëve, duke siguruar po për të gjithë siguri, drejtësi, harmoni, sinqeritet, tolerancë, solidaritet, bashkëpunim dhe mirëkuptim mes njerëzve.

I Madhi Zot, xh.sh., na tregoi se shtëpia - xhamia e parë e ndërtuar për njerëzit për të adhuruar Zotin, xh.sh., është Qabeja. Zoti, xh.sh., thotë:





“Shtëpia-Xhamia e parë e ndërtuar për njerëz është ajo që u ngre në Bekë (Mekë), e dobishme, udhërrëfuese për mbarë njerëzimin. Aty ka shenja të qarta, vend i Ibrahimit, dhe kush hy në të, ai është i sigurt.” (Ali Imran, 96-97)

Të nderuar vëllezër e motra,

Islami dy festat kryesore i ka lidhur edhe me detyrime materiale, të parën me sadakatul fitrin, e tjetrën me therjen e kurbanit, e kjo është dëshmi se kjo festë është edhe shoqërore. Prandaj, përkushtimi për shoqërinë mbetet jetik për fenë islame, që askush mos të ndihet i privuar nga të mirat e këtyre festave, si nga ana shpirtërore, ashtu edhe nga ajo materiale. Duhet ruajtur vëllazërinë, harmoninë, respektin e dashurinë mes vete, dhe bashkërisht ta përjetojmë gëzimin që sjellin festat tona! Të vazhdojmë e t'i qëndrojmë pran njëri-tjetrit, nëse dëshirojmë që ndihma e Zotit të jetë në anën tonë. O, Besimtarë, vlera e këtyre ditëve është e madhe! Nga këto dallojnë Dita e djeshme, e Arafatit, dhe ajo e sotmja, dita e

Bajramit, dhe lutja më e mirë drejtuar Zotit, xh.sh., në këto ditë është: “Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut Një, Ai nuk ka ortak”.

Haxhi bart në vete edhe ndjenjën e barazisë mes njerëzve, nga të gjitha anët e botës, pa dallim ngjyre race pozite e pasurie. Në Arafat të gjithë ndihen të barabartë, e kjo është një dëshmi e madhe që tregon unitetin e vendosur në besim ndjenja dhe ritual. Zoti, xh.sh., thotë: “O ju njerëz, Ne vërtet ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise, që të njiheni ndërmjet vete!” (El Huxhuratë, 13).

Në këtë ditë feste të Bajramit të Kurbanit besimtarët anekënd botës therin edhe kurban. Qëllimi i therjes së kurbanit është afrimi edhe më i madh te Zoti, xh.sh., duke e rikujtuar dhe përmendur në vazhdimësi emrin e Allahut, xh.sh. Zoti, xh.sh., thotë: “Ne vërtetë të dhamë ty shumë të mira. Prandaj ti falu dhe ther kurban për hir të Zotit tënd!”. (El Kevther, 1-2).

Therja e kurbanit sikur na ringjall dhe na e rikujton në vazhdimësi ndodhinë shumë domethënëse të Ibrahimit, a.s., me birin e tij, Ismailin, i cili ishte gati ta flijojë edhe birin e tij të vetëm për Zotin, xh.sh., mirëpo mëshira e Zotit ishte që atë gatishmëri dhe atë sakrificë ta zëvendësonte me një kurban. Zoti, xh.sh., thotë: “Dhe Ne e zëvendësuam atë me kurban të madh” (Safat, 107).

Të nderuar motra e vëllezër, të nderuar besimtarë,

Duhet ta dimë se stabilitetin dhe funksionalitetin e një shoqërie më së shumti e kërcënojnë veprat e këqija dhe dhuna me të gjitha llojet e veta. Ndër veprat e këqija që më së shumti e kërcënojnë familjen janë: tradhtia bashkëshortore, përdorimi i alkoolit, bixhozi, përdorimi substancave narkotike etj., e pothuajse këto nuk ndahen nga njëra-tjetra. Fatkeqësisht për këto të liga është krijuar edhe një sektor i posaçëm i përfitimit material, një industri e veçantë për përfitim të pandershëm.

Elementi tjetër që më së shumti e kërcënon familjen është edhe dhuna brenda familjes, e cila marrë në përgjithësi edhe vërehet shumë pak; ajo në të shumtën e rasteve mbetet e fshehtë dhe e padukshme, e struktur në harresë, e si e tillë mbetet edhe e padënuar, ngase te ne, fatkeqësisht, ende mbretëron mendësia se kjo është pjesë e jetës private. Dhuna asnjëherë nuk është mjet i zgjidhjeve të problemeve, por është ushtrim i presionit dhe i shtypjes së tjetrit. Derisa shkaqet janë të shumta dhe nga më të ndryshmet, ato edhe duhet të kërkojnë nga edukata në familje, si celulë themelore, deri te niveli më i lartë i organizimit institucional i shoqërisë.

Degradimi i familjes në masë të madhe ka shkaktuar kriza, janë shtuar divorcet, janë pakësuar lindjet, kemi shumë fëmijë të braktisur, shumë nëna kanë mbetur kryefamiljare, kemi shumë familje në varfëri, fëmijë pa përkujdesje të

bollshme, fëmijë që braktisin shkollën, të rinj që qëndrojnë në rrugë, konsumojnë drogë, alkool, merren me prostitucion... Nga familjet e shthurura shumë pleq edhe mbeten të vetmuar e pa kujdesin minimal të fëmijëve të tyre. Zoti, xh.sh., thotë: *“Ruajeni veten dhe familjet tuaja nga Zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët!”* (Tahrim, 6).

Të gjitha llojet e dhunës janë në kundërshtim me parimet e drejta të fesë sonë islame, e më e rrezikshmja është ajo brenda familjes, ngase ajo dhunë nuk është kërcënim vetëm për individ, por për mbarë shoqërinë, ngase ajo i lëkund themelet e mbarë shoqërisë, duke shkaktuar plagë fizike, por edhe shpirtërore e psikike, të cilat me vështirësi edhe mund të riparohen.

Muhamedi, a.s., thotë në hadith kudsij: *“(Zoti tha:) Unë ia kam ndaluar Vetvetes padrejtësinë dhe zullumin, e këtë jua ndaloj edhe ju, prandaj mos i bëni padrejtësi njeri-tjetrit!”* (Muslimi). Problem tjetër shumë i madh është largimi i një pjese të popullatës nga vendet tona, si nga Shqipëria, Maqedonia, Mal i Zi, Lugina, Medvegja, Kosova e kudo.

Shqetësim tjetër shumë i madh për ne duhet të jetë edhe asimilimi i shqiptarëve para syve tanë brenda trojeve tona, dhe ne sillemi sikur nuk po ndodh asgjë, ata (pra vëllezërit dhe motrat tona) po e harrojnë gjuhën shqipe, po e harrojnë traditën, adetet e zakonet që i kanë mbajtur gjithëherë freskët në shpirt gjithë shqiptarët, duke e zëvendësuar këtë gjuhë kaq të bukur e kaq të dëlirë me gjuhë të tjera të huaja, po edhe me identitet tjetër. Institucionet tona duhet të merren me këtë problematikë sa më shpejt dhe shumë seriozisht, duke marrë masa të parandalimit të kësaj tashmë dukurie shqetësuese.

Çështja tjetër e ngutshme me të cilën duhet të merren të gjitha institucionet e vendit, e në veçanti qeveria e Kosovës,

është edhe ndikimi te të rinjtë në veçanti, që mos të largohen në këtë numër kaq të madh nga trojet tona. Si qeveri, po edhe si shoqëri, duhet bërë edhe më shumë që të rinjtë tanë të kenë mundësi të sigurojnë ardhmëri të sigurt për veten dhe familjet e tyre në atdheun e tyre, të krijohen mundësi e kushte ekonomike për të qëndruar në atdheun tonë, në këtë nënqiell kaq të bukur, në këtë vend ku na fali i Madhi Zot.

Vëllezër e motra,

Gjendja e përgjithshme e sigurisë në vendin tonë nuk është e qëndrueshme sa dhe siç duhet. Në veri të vendit tash e sa muaj kemi tensionim të gjendjes. Qeveria, po edhe të gjitha institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare, duhet të kontribuojnë edhe më shumë, me të gjitha mundësitë e tyre, për shtensionim të situatës dhe ulje të tensioneve. Të gjitha problemet duhet të zgjidhen përmes dialogut dhe larg nga përdorimi i mundshëm i dhunës. Sigurisht se e vlerësojmë punën e institucioneve tona dhe të bashkësisë ndërkombëtare për kontributin e dhënë në shtensionimin e situatës dhe vendosjen e rendit dhe të sigurisë.

Kosova i ka kufijtë e vet, e ka sovranitetin e vet, e ka kushtetutën, të cilën edhe duhet respektuar në çdo rrethanë, për ta çuar në vend amanetin e dëshmorëve të kombit dhe amanetin e popullit për besimin e dhënë të zgjedhurve të tyre.

Lutemi në këtë ditë feste që në Kosovë të mbretërojë paqja, harmonia, bashkëjetesa, toleranca, siguria, respekti dhe qetësia!

Zoti e ruajttë vatanin tonë!



Komentimi i sures El Fet'h (6)

GJENDJA E ATYRE QË HEZITUAN TË ISHIN NË HUDEJBIJE ME MUHAMEDIN, A.S.

Sabri Bajgora

سَيَقُولُ لَكَ الْمُخَلَّفُونَ مِنَ الْأَعْرَابِ شَغَلَتْنَا أَمْوَالُنَا وَأَهْلُونَا فَاسْتَغْفِرْ لَنَا يَقُولُونَ بِآلِسِنَاهُمْ مَّا لَيْسَ فِي قُلُوبِهِمْ قُلْ فَمَنْ يَمْلِكُ لَكُمْ مِنَ اللَّهِ شَيْئًا إِنْ أَرَادَ بِكُمْ ضَرًّا أَوْ أَرَادَ بِكُمْ نَفْعًا بَلْ كَانَ اللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرًا ﴿١١﴾ بَلْ ظَنَنْتُمْ أَنْ لَنْ يَنْقَلِبَ الرَّسُولُ وَالْمُؤْمِنُونَ إِلَىٰ أَهْلِيهِمْ أَبَدًا وَزُيِّنَ ذَٰلِكَ فِي قُلُوبِكُمْ وَظَنَنْتُمْ ظَنًّا سَوْءًا وَكُنْتُمْ قَوْمًا بُورًا ﴿٢١﴾ وَمَنْ لَمْ يُؤْمِن بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ فَإِنَّا أَعْتَدْنَا لِلْكَافِرِينَ سَعِيرًا ﴿٣١﴾ وَلِلَّهِ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ يَعْزُفُ لِمَنْ يَشَاءُ وَيُعَذِّبُ مَنْ يَشَاءُ ۚ وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا رَحِيمًا ﴿٤١﴾ سَيَقُولُ الْمُخَلَّفُونَ إِذَا انطَلَقْتُمْ إِلَىٰ مَغَائِمٍ لِّتَأْخُذُواهَا دَرُونا تَتَّبِعْكُمْ طَرِيدُونَ أَنْ يُبَدِّلُوا كَلَامَ اللَّهِ قُلْ لَنْ تَتَّبِعُونَا كَذَلِكُمْ قَالَ اللَّهُ مِنْ قَبْلُ فَسَيَقُولُونَ بَلْ تَحْسُدُونَنَا بَلْ كَانُوا لَا يَقَفُوهَا إِلَّا قَلِيلًا ﴿٥١﴾ قُلْ لِلْمُخَلَّفِينَ مِنَ الْأَعْرَابِ سَتُدْعُونَ إِلَىٰ قَوْمٍ أُولَىٰ بَأْسٍ شَدِيدٍ تُقَاتِلُونَهُمْ أَوْ يُسْلِمُونَ فَإِنْ تُطِيعُوا يُزَيِّنْكُمْ اللَّهُ أَجْرًا حَسَنًا ۖ وَإِنْ تَتَوَلَّوْا كَمَا تَوَلَّيْتُمْ مِنْ قَبْلُ يُعَذِّبْكُمْ عَذَابًا أَلِيمًا ﴿٦١﴾ لَيْسَ عَلَى الْأَعْمَىٰ حَرْجٌ وَلَا عَلَى الْأَعْرَجِ حَرْجٌ وَلَا عَلَى الْمَرِيضِ حَرْجٌ ۖ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ يُدْخِلْهُ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ ۖ وَمَنْ يَتَوَلَّ يُعَذِّبْهُ عَذَابًا أَلِيمًا ﴿٧١﴾

“Do të të thonë ty arabët e shkretëtirës, të cilët ngelën pas jush: “Ne na penguan pasuria dhe familjet tona, prandaj kërkoni falje (Allahut) për ne!” Ata thonë me gjuhët e veta atë që nuk e kanë në zemrat e tyre. Thuaju: “Kush mund ta pengojë Allahun ndaj jush, nëse Ai dëshiron t’ju përfshijë ndonjë dëm, ose nëse dëshiron t’ju gjejë ndonjë e mirë?!”. Jo, por Allahu e di hollësisht atë që ju bëni. Ju menduat se i Dërguari dhe besimtarët nuk do të ktheheshin kurrë te familjet e veta, dhe kjo (bindje), u duk si gjë e mirë në zemrat tuaja. Ju patët mendim të keq, sepse jeni njerëz të prishur. Kush nuk i beson Allahut dhe të Dërguarit të Tij, le ta dijë se Ne kemi përgatitur për jobesimtarët një zjarr shumë të fortë! Vetëm Allahut i takon pushteti i qiejve dhe i Tokës. Ai fal kë të dojë, dhe ndëshkon kë të dojë. Allahu është Falës i gjynaheve, Mëshirëplotë. Kur ju të niseni për ta mbledhur plaçkën e luftës, ata që ngelën pas jush, do të ju thonë: “Na lini edhe ne që të vijmë me ju!”. Ata duan ta ndryshojnë urdhrin e Allahut. Thuaju: “Kurrresi! Ju nuk keni për të ardhur me ne. Kështu ka thënë Allahu më herët!”. E ata do të ju thonë: “Nuk është ashtu, por ju na keni zili”. Ah, sa pak që kuptojnë! Thuaju atyre arabëve beduinë që ngelën pas jush: “Ju do të thirreni kundër një populli luftarak e të fuqishëm, që do t’i luftoni ose do të dorëzohen. Nëse i përgjigjeni (thirrjes), Allahu do të ju japë shpërblim të mirë, e nëse shmangeni, ashtu siç keni bërë edhe më parë, Ai do të ju ndëshkojë me dënim të dhembshëm. Nuk është gjynah (që mos të marrin pjesë në luftë) për të verbrin, për të çalin, e as të sëmurin. E, kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai do ta futë në xhenete, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, kurse ai që shmanget, Ai do ta ndëshkojë me një dënim të dhembshëm.” (El Fet’h, 11-17)

SHKAKU I ZBRITJES SË AJETIT TË 17-TË

Në lidhje me zbritjen e këtij ajeti, është përcjellë prej Ibën Abasit të ketë thënë: “Pasi zbriti ajeti i 16-të i kësaj sureje: “...por nëse shmangeni, ashtu siç keni bërë edhe më parë, Ai do t’ju ndëshkojë me dënim të dhembshëm”, ata që ishin me të meta fizike u pikëlluan e thanë: “Si do të jetë puna jonë, o i Dërguar i Allahut”, dhe menjëherë pas kësaj zbriti ajeti i 17-të, i cili ua heq obligimin e pjesëmarrjes në luftë të

drejtpërdrejtë këtyre kategorive, si në vijim: “Nuk është gjynah (që mos të marrin pjesë në luftë) për të verbrin, për të çalin, e as të sëmurin...”¹.

LIDHJA E KËTYRE AJETEVE ME ATO PARAPRAKE

Këto ajete kanë një ndërlidhje me ajetin e 6-të të kësaj sureje, në të cilin i Madhërishmi flet për hipokritët që në zemrat e tyre e fshihnin kufrin dhe urrejtjen ndaj besimtarëve.

Gjatë kthimit nga Hudejbija, Allahu, xh.sh., duke i zbritur ajetet e kësaj sureje, njëkohësisht e njoftoi të Dërguarin e Vet për arsyet e vërteta të atyre që nuk iu bashkuan të Dërguarit, a.s., në umre, e cila përfundoi me nënshkrimin e një marrëveshjeje paqësore mes myslimanëve dhe kurejshëve.

Edhe tash në këto ajete pjesa më e madhe e tyre flet për disa fise beduinësh arabë, të cilët banonin përreth Medinës, te të cilët, siç duket, Imani ende nuk kishte lëshuar rrënjë aq sa duhej në zemrat e tyre, e të cilët kishin hezituan të ishin me myslimanët në Hudejbije, duke gjetur arsye të ndryshme, për ta shmangur pjesëmarrjen në luftë. Mirëpo, të gjitha këto intriga të tyre Allahu, xh.sh., ua shfaqti haptazi, duke i demaskuar qëllimet e tyre të vërteta, duke sqaruar se vetëm ata që janë me ndonjë të metë fizike, si të verbrit, të çalët apo të sëmurët, janë të liruar nga pjesëmarrja në luftë.

KOMENT

11. Do të të thonë ty arabët e shkretëtirës, të cilët ngelën pas jush: “Ne na penguan pasuria dhe familjet tona, prandaj kërko falje (Allahu) për ne!” Ata thonë me gjuhët e veta atë që nuk e kanë në zemrat e tyre. Thuaju: “Kush mund ta pengojë Allahun ndaj jush, nëse Ai dëshiron t’ju përfshijë ndonjë dëm, ose nëse dëshiron t’ju gjejë ndonjë mirësi?” Jo, por Allahu e di hollësisht atë që ju bëni.

Gjatë kthimit nga Hudejbija, Allahu, xh.sh., duke i zbritur ajetet e kësaj sureje, njëkohësisht e njoftoi të Dërguarin e Vet për arsyet e vërteta të atyre që nuk iu bashkuan të Dërguarit, a.s., në umre, e cila përfundoi me nënshkrimin e një marrëveshjeje paqësore mes myslimanëve dhe kurejshëve. Këta ishin beduinët arabë që banonin përreth Medinës, nga fiset Eslem, Xhuhejne, Muzejne, Gifar, Eshxhaë dhe Ed Dil.² Ata do të sajnin dhjetë arsye të pengimit të tyre, duke thënë se i penguan pasuritë dhe familjet e tyre, përndryshe do të kishin ardhur! Ata madje edhe do t’i kërkonin të Dërguarit të Allahut që t’i kërkonte Allahut falje për ta. Mirëpo, Allahu, xh.sh., nëpërmjet këtyre ajeteve i turpëron ata haptazi, duke ua shfaqur hipokrizinë që ende e kishin në zemra, kur thotë: “Ata thonë me gjuhët e veta atë që nuk e kanë në zemrat e tyre.” Pra, i demaskon fuqishëm, duke u thënë se nuk janë të sinqertë, dhe po gënjajnë haptazi, sepse që nga fillimi nuk deshën t’i

bashkoheshin të Dërguarit, a.s., i cili u nis në mënyrë paqësore që ta vizitonte Qabenë, me qëllim të kryerjes së umres, ashtu siç kishte parë në ëndërr.

Këta që refuzuan të niseshin në umre me të Dërguarin, a.s., sikur harruan se po të donte Allahu që dikë ta përfshinte ndonjë dëm apo ndonjë mirë, asgjë nuk mund ta pengojë vullnetin e Tij që të zbatohet. Përveç kësaj, Allahu është hollësisht i informuar për çdo veprim dhe mendim të tyre, dhe Atij nuk mund t’i fshihet ajo çka ata mbajnë në zemra.

12. Ju menduat se i Dërguari dhe besimtarët nuk do të ktheheshin kurrë te familjet e veta, dhe kjo (bindje) ju duk si gjë e mirë në zemrat tuaja. Ju patët mendim të keq, sepse jeni njerëz të prishur.

Këta që gjetën plot arsye të mos të merrnin pjesë në udhëtim me Pejgamberin, a.s., ishin shumë të bindur se i Dërguari, a.s., dhe besimtarët që ia kishin mësyre paqësisht Mekës, për ta kryer umren do të ndesheshin me ushtrinë kurejshite, dhe do të mposhteshin, dhe nuk do të ktheheshin më në shtëpitë dhe familjet e tyre.³ Teksa e mendonin këtë mendim kaq të ligë për myslimanët, ata thellë në zemrat e tyre të prishura e ndjenin këtë gjë si diçka të mirë dhe që u pëlqente. Kjo tregon për nifakun-hipokrizinë që kishin në zemra, sepse shejtani i mallkuar ua kishte hijeshuar edhe më mendimet e tyre të këqija. Prandaj, i Madhërishmi i cilëson këta njerëz si të prishur, ndaj të cilëve edhe do të bjerë ndëshkimi i Tij në Ahiret.

13. Kush nuk i beson Allahut dhe të Dërguarit të Tij, le ta dijë se Ne kemi përgatitur për jobesimtarët një zjarr shumë të fortë!

Ky është paralajmërim kërcënues i Zotit Fuqiplotë ndaj atyre që nuk i kanë besuar sinqerisht, me shpirt e me zemër, Krijuesit të Tij, sepse besimi i sinqertë, përveç tjerash, nënkupton sinqeritet në bindje dhe në vepra, qoftë haptazi apo fshehurazi. Këta njerëz të prishur e përzien besimin e tyre me një dozë hipokrizie, prandaj ata që nuk e besojnë Allahun dhe nuk e pasojnë të

Dërguarin e Tij, do të jenë në zjarr të Xhehenemit, si pasojë e veprave të tyre të shëmtuara.

14. Vetëm Allahu i takon pushteti i qiejve dhe i Tokës. Ai fal kë të dojë, dhe ndëshkon kë të dojë. Allahu është Falës i gjynaheve, Mëshirëplotë.

Pa dyshim se i tërë pushteti mbi këtë ekzistencë, përfshirë qiejt dhe Tokën, i Takon Atij që i krijoi ato nga mosqenia, dhe vullneti i Tij zbatohet mbi çdo gjë. Ai e fal kë të dojë nga robërit e Tij, nëse ata pendohen dhe kthehen të përlulur e të penduar para Madhërisë së Tij, dhe po ashtu e ndëshkon kë të dojë, nëse ata nuk përudhen dhe hiqen si të lartë, duke e ndjekur kotësinë dhe të pavërtetën. Çdo gjë në këtë univers i nënshtrohet Allahu. Pushteti i Tij është absolut. Askush nuk mund të ndërhyjë në punët e Tij, dhe nuk ka nevojë për asnjë prej krijesave të Tij. Ajeti përfundon me përmendjen e dy emrave të bukur të Allahut: **Gafur- Gjyahnfalësi dhe Rahim- Mëshirëploti**, për të na treguar se mëshira e Tij është më e madhe se hidhërimi dhe ndëshkimi i Tij, dhe pikërisht për këtë qëllim e ka lënë të hapur derën e pendimit edhe për ata njerëz të sëmurë me sëmundjen e hipokrizisë, e që dëshirojnë të kthehen tek Allahu, sepse kjo çështje është pjesë e mëshirës së Tij, e cila edhe përfshin çdo send. Mirëpo, me kusht që këta, pas pendimit, ta braktisin dhe lënë anash lakminë ndaj kësaj bote, t'i braktisin egot e tyre të sëmura, e sidomos ta braktisin lojën e tyre të dyfishtë!⁴

15. Kur ju të niseni për ta mbledhur plaçkën e luftës, ata që ngelën pas jush, do të ju thonë: "Na lini edhe ne që të vijmë me ju!". Ata duan ta ndryshojnë urdhrin e Allahut. Thuaj: "Kurrresi! Ju nuk keni për të ardhur me ne. Kështu ka thënë Allahu më herët!". E ata do të ju thonë: "Nuk është ashtu, por ju na keni zili.". Ah, sa pak që kuptojnë!

Në këtë ajet, shohim edhe një përgëzim tjetër nga ana e Allahut, i cili vlen për myslimanët që u besatuan në Hudejbije. I Madhërishmi ia zbriti të Dërguarit, a.s., këtë sure përnjëherë, duke e njoftuar të Dërguarin e Vet se çfarë do të thoshin ata që ngelën në rrethinat e Medinës, kur këta të arrinin në Medinë. Ata beduinë, që imanin e tyre e kishin mbështjellë me petkun e hipokrizisë, pas kthimit triumfal të Pejgamberit, a.s., në Medinë, do të përpiqeshin të arsyetoheshin për mospjesëmarrjen e tyre, se gjoja ishim të zënë me familjet dhe pasuritë e tyre. Madje, do të shprehnin dëshirë që në ekspeditat e ardhshme, në të cilat do të kishte plaçkë lufte, të ishin së bashku me Pejgamberin, a.s., dhe, e para nga këto ekspedita do të ishte çlirimi i Hajberit, fortifikatës më të madhe dhe më të mbrojtur të çifutëve në Gadishullin Arabik, që ndodhi katërdhjetë ditë pas kthimit nga Hudejbija. Mirëpo Allahu, xh.sh., duke i ditur qëllimet e tyre dinake dhe urrejtjen që ende e mbanin në zemra ndaj besimtarëve, po ashtu e njoftoi të Dërguarin, a.s., se "*Çlirimi i Hajberit*" dhe pasuritë që do të merreshin nga aty u takonin vetëm atyre që u



besatuan në Hudejbije, dhe askujt tjetër.⁵ Ky ishte shpërblimi i parë për besimtarët e besatimit të singertë në Hudejbije, të cilët ishin të gatshëm të flijoheshin për lartësimin e Fjalës së Allahut. Pikërisht nëpërmjet këtij ajeti vjen refuzimi dhe urdhri i prerë i Allahut në lidhje me ata që ngelën prapa radhëve të myslimanëve, e të cilën urdhëresë i Dërguari i Allahut ua komunikoi atyre nëpërmjet fjalës hyjnore: "*Kurrresi! Ju nuk keni për të ardhur me ne. Kështu ka thënë Allahu më herët!*"

Edhe ajeti i 83-të i sures *Et Tevbe*, flet përafërsisht për një rast të ngjashëm, për një grup që nuk i qenë bashkuar të Dërguarit të Allahut në betejën e Tebukut. Edhe në këtë ajet shohim të njëjtin përgjigje të prerë, madje të veshur pak edhe me një dozë kërcënimi: "*Nëse Allahu të kthen (prej Tebukut) te ndonjë grup i tyre (hipokritëve), e ata të kërkojnë leje për të dalë (me ty në ndonjë luftë), thuaj: "Ju kurrë nuk do të dilni me mua, dhe kurrë nuk do të luftoni ndonjë armik së bashku me mua! Ju ishit të kënaqur (kur nuk erdhët për të luftuar) herën e parë, prandaj rrini me ata që mbetën pas!"*

Ajeti i 15-të i kësaj sureje përfundon me fjalët: "*E ata do të ju thonë: "Nuk është ashtu, por ju na keni zili". Ah, sa pak që kuptojnë!*", dhe nënkupton se pas refuzimit të prerë që ata të marrin pjesë në ndonjë ekspeditë të re ushtarake, ata do t'u thonë myslimanëve: "*Ju nga zilia nuk po na lini të marrim pjesë në luftë për ndarjen e presë së fituar.*" Mirëpo, e vërteta është krejtësisht ndryshe, sepse ky refuzim nga ana e Allahut dhe e Pejgamberit, a.s., për ta vjen si dënim për shmangien nga pjesëmarrja në umren e Hudejbijes, e më vonë të disave edhe në luftën e Tebukut.⁶

16. Thuaju atyre arabëve beduinë që ngelën pas jush: “Ju do të thirreni kundër një populli luftarak e të fuqishëm, që do t’i luftoni ose do të dorëzohen. Nëse i përgjigjeni (thirrjes), Allahu do të ju japë shpërblim të mirë, e nëse shmangeni, ashtu siç keni bërë edhe më parë, Ai do të ju ndëshkojë me dënim të dhembshëm.

Allahu i Gjithëmëshirshëm është shumë i dhimbshëm për krijesat, sidomos për njerëzit, të cilëve sërish e sërish ua jep rastin të pendohen dhe ta dëshmojnë në vepër pendimin e tyre të sinqertë. Në këtë rast pendimi i atyre që ngelën pas e nuk iu bashkuan myslimanëve në Hudejbije do të pranohet vetëm pasi ata stoikisht të qëndrojnë në luftë kundër jobesimtarëve të fuqishëm ushtarakisht, duke mos e sjellë ndër mend tërheqjen nga fronti i luftës. Mirëpo, a thua se kush është ky popull i fuqishëm dhe luftarak, e të cilin Allahu, xh.sh., po e cilëson në këtë ajet? Sipas disa dijetarëve, këta ishin popujt Hevazin, Gatefan dhe Thekif, me të cilët myslimanët u ballafaquan në ditën e Hunejn. Disa të tjerë janë të mendimit se këta ishin fisi i Musejlemtul Kedhabit (gënjeshhtarit që pretendonte se ishte i dërguar), Benu Hanife. Ndërkaq, disa thonë se ky popull luftarak dhe i fortë mund të ishin persianët dhe romakët.⁷ Pavarësisht se cilin popull e ka synuar Allahu, kjo ka pak rëndësi, meqë nuk kemi ndonjë argument të qartë as nga Kurani e as nga Suneti për këtë, por me rëndësi është fakti se lufta kërkon sakrificë dhe durim të paparë, dhe për këtë arsye në luftën e vërtetë nuk do të ketë mundësi për shtirje. Nëse këta njerëz me iman të dobët e të dyshimtë pendohen dhe luftojnë në rrugën e Allahut me zemër të pastër, atëherë Ai do t’ua falë mëkatën e shmangies nga radhët e myslimanëve, siç ishte rasti në Hudejbije dhe ai në Tebuk. Ndërsa, nëse sërish largohen dhe mundohen të gjejnë ndonjë arsyetim të paqenë për mospjesëmarrje në luftë, atëherë ata i pret zjarri i Xhehenemit dhe ndëshkimi i përjetshëm në Ahiret.

17. Nuk është gjynah (që mos të marrin pjesë në luftë) për të verbrin, për të çalin, e as të sëmurin. E, kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai do ta futë në xhenet, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, kurse ai që shmanget, Ai do ta ndëshkojë me një dënim të dhembshëm.

Ajeti i 17-të i kësaj sureje i përcakton shumë qartë kategoritë që lirohen nga pjesëmarrja aktive në luftë, për shkak të dobësive të ndryshme, siç janë sëmundja, mungesa e ndonjë gjymtyre, siç janë: syri, këmba, dora etj. Që të gjitha këto kategori janë të falura, dhe nuk janë të ngarkuara me obligimin e xhihadi apo pjesëmarrjes në luftë, për shkak të

Allahu i Gjithëmëshirshëm është shumë i dhimbshëm për krijesat, sidomos për njerëzit, të cilëve sërish e sërish ua jep rastin të pendohen dhe ta dëshmojnë në vepër pendimin e tyre të sinqertë.

të metave fizike me të cilat janë sprovuar në këtë dynja.⁸ Në këtë ajet shohim një nxitje në përpjekjen e vërtetë për lartësimin e fesë së Allahut, pra për të gjithë ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta do t’i gëzojnë të gjitha begatitë e Krijuesit në Xhenet, ndërsa ata që shmangen qëllimisht nga lufta, dhe nuk kanë ndonjë arsye e as ndonjë të metë fizike, por bëjnë hile e mashtrim, ata i pret ndëshkimi i dhimbshëm dhe hidhërimi i përjetshëm i Allahut ndaj tyre.

POROSIA E KËTYRE AJETEVE

- Ata që ngelën në Medinë, nga fiset arabe, dhe nuk iu bashkuan të Dërguarit të Allahut, ishin njerëz me iman të dobët, që i afrohet bukur shumë përshkrimi të mynafikëve. Arsyetimet e tyre ishin aq të mjera, sepse kur është në pyetje ideali i pastër islam, as pasuria e as familja nuk mund të jenë pengesë për ta

arritur kënaqësinë e të Madhit Zot.

- Ata e fshihnin hipokrizinë e tyre në zemra, sepse në vete ishin lutur që myslimanët të pësonin disfatë prej kurejshëve. Allahu ua kishte shfaqur haptazi gënjeshtrat dhe mendimet e tyre të këqija. Madje ata haptazi do të kërkonin të merrnin pjesë në luftërat e ardhshme, ku do të ndahej plaçka e luftës, mirëpo një gjë të tillë nuk ua lejoi Allahu, xh.sh.

- Allahu e ka lënë të hapur gjithmonë derën e pendimit, e kjo vlen edhe për ata që ngelën pas myslimanëve dhe nuk iu bashkuan atyre. Nëse pendohen sinqerisht, Allahu është i Mëshirshëm dhe i fal, e nëse sërish shfaqin mosbindje dhe anojnë kah intrigat, Allahu do t’i marrë me ndëshkim të dhimbshëm në Ahiret.

- Nga pjesëmarrja në luftë janë të liruar disa kategori të caktuara, sikurse: i verbri, i çali, i sëmuri rëndë etj., sepse pjesëmarrja e tyre përveçqë nga aspekti fizik do të ishte e padobishme, në të njëjtën kohë ata do të bëheshin barrë për myslimanët e tjerë pas fillimit të ballafaqimit me armikun.

- Ata që i binden Allahut, Ai do t’i shpërblejë në xhenet, kurse të pabindurit dhe hipokritët i pret dënimi me Zjarr. - vijon -

1 Imam Kurtubiu, *El Xhamiu li Ahkamil Kuran*, Bejrut, 2006, vëll. 19 f. 313 (redaktuar prej Dr. Abdullah Turkit, dhe, bashkëredaktues në këtë vëllim ishte edhe Muhamed Ridvan Arkasusi); Tefsiri i Begaviut, *Mealimu Et Tenzil*, Rijad, 1412 h., vëll. VII, f. 303.

2 *Et Tefsirul Munir*, vëll. 26, f. 496.

3 *Et Tahriru ve Et Tenviru*, vëll. 26, f. 162.

4 Muhamed el Gazali, *Nahve tefsirin mevduij li suveril Kurani Kerim*, Kajro, 2000 (botimi i IV), f. 399.

5 Abdul Kahir El Xhurxhani, *Durxhud Durer fi Tefsiril Kurani Adhim*, Aman, 2009, vëll. II, f. 575.

6 Nexhmuddin Et Tufi, *Isharat el Ilahije ilel mebahithil usulijje*, Kajro, 2002, vëll. II, f. 259.

7 Ebu Lejth Es Semerkandi, *Bahrul Ulum*, Bejrut, 1993, vëll. III, f. 255.

8 Ahmed Mustafa El Meragij, *Tefsirul Meragij*, Kajro, 1946, vëll. 26, f. 99-100.

Objektivat e edukimit islam në kuadër të kaptinës Llukman

Dr.Valmire Batatina Krasniqi

Lidhshmëria e kaptinës Llukman me kaptinën Sexhde, është evidente edhe në faktin se të dy kaptinat përmbajnë argumentet mbi Njeshmërinë e Zotit, që është parim themelor i besimit. Po ashtu kaptina Sexhde, sikurse ajo Llukman, trajton çështjet e besimit, ndër të cilat si më kryesore atë të ringjalljes.

Edukimi islam si një element bazë për një shoqëri të shëndoshë, kërkon prej një edukatori që dëshiron të jetë i dobishëm për shoqërinë që, përveç ndjekjes së të dhënave aktuale dhe zhvillimit të shkencës bashkëkohore, ai t'i njohë edhe parimet themelore të edukimit kuranor. Një vështrim mbi këto parime dhe objektiva e hasim edhe në kaptinën Lukman, kaptinë kjo e përbërë nga 34 ajete, e zbritur në Mekë. Edhe kjo kaptinë, sikurse kaptinat e tjera mekase, si cak dhe qëllim ka tri pikat më qendrore të besimit islam: Zotin, pejgamberët dhe ahiretin. Njashtu përfshin një pjesë të tregimit për Llukmanin e urtë, për mençurinë që ia dhuroi Zoti, për këshillat që ia drejtoi të birit e, përmes tij edhe gjithë njerëzve, këshilla këto shumë të rëndësishme për njohjen e objektivave të edukimit islam dhe formimin e një shoqërie të dobishme. Kaptina përfundon me pasqyrimin e Ditës së Kiametit, ditës në të cilën nuk do të mundet t'i bëjë farë dobie prindi fëmijës a fëmija prindit, ngaqë çdokush do të jetë i preokupuar me çështjet e veta.

LIDHSHMËRIA E KËSAJ KAPTINË ME KAPTINËN PARAPRAKE DHE ATË PAS SAJ

Lidhshmëria mes kaptinave është një interpretim i përgjithshëm i Kuranit, i cili jep një shembull të mrekullueshëm në aspektin e harmonisë kuranore. Nga ky aspekt shihet se edhe kaptina Llukman përmban një lidhshmëri të ngushtë me

kaptinat që zënë vend para dhe pas saj në renditjen kuranore. Lidhshmëria e saj me kaptinën paraprake, kaptinën Rrum, kuptohet nga fakti se përmbajtja e përgjithshme në kaptinën paraprake ka si tema çështjet më themelore të besimit të drejtë: besimin në një Zot të vetëm, në të dërguarit e Tij, si dhe në ringjalljen, tema këto të përfshira edhe në kaptinën Llukman. Përveç tjerash, në kaptinën Rrum, gjegjësisht në versetin e 58-të, theksohet se Zoti i Madhërishtëm në Kuran u ka sjellë njerëzve shembuj nga të gjitha llojet, fakt ky që argumentohet edhe në kaptinën Llukman, gjegjësisht në ajetin e dytë, në të cilin thuhet se ato janë ajete të librit me plot urtësi të përsosura.¹ Në të njëjtën mënyrë, në fund të kaptinës Rrum, theksohet qëndrimi mohues i mushrikëve ndaj ajeteve të Kuranit, ndërsa në atë Llukman shprehet qëndrimi i ngjashëm i mohuesve: *E kur i lexohen atij ajetet Tona, ai kthehet kryelartë dhe bëhet sikur nuk i ka dëgjuar ato, bëhet sikur në veshët e tij ka shurdhim të rëndë, pra, ti përgëzoje atë me një dënim të dhembshëm.*² Në të dy kaptinat po ashtu theksohet për fuqinë e përsosur dhe për madhërinë e pakufishme të Zotit, e që dokumentohen në krijimin e njeriut të parë, krijim që Zoti e bëri nga dheut, e pastaj përmes proceseve të zhvillimit; krijimi i njerëzve që veprojnë në lëmenj të ndryshëm të jetës së tyre, të ndryshëm për nga dituria, bukuria, pasuria fatbardhësia etj.; krijimi i gjinisë tjetër prej llojit të njeriut; krijimi i qiejve e i Tokës; i njerëzve me gjuhë dhe raca të ndryshme; i



natës për gjumë e i ditës për punë; i vetëtimës që mbjell frikë e rrufesë, dhe shpresën për shi; i stabilizimit të qiejve e Tokës edhe i ringjalljes pas vdekjes.³

Lidhshmëria e kaptinës Llukman me kaptinën Sexhde, është evidente edhe në faktin se të dy kaptinat përmbajnë argumentet mbi Njeshmërinë e Zotit, që është parim themelor i besimit. Po ashtu kaptina Sexhde, sikurse ajo Llukman, trajton çështjet e besimit, ndër të cilat si më kryesore atë të ringjalljes, të cilën e mohonin idhujtarët me këmbëngulje dhe e përdornin si çështje me të cilën donin ta shpallnin Muhamedin, a.s., shpikës të mësimëve të veta.⁴ Po ashtu, edhe në këtë kaptinë sillen fakte që dokumentojnë për fuqinë e Zotit, si krijimin e qiejve e të Tokës, përsosjen e krijimit të çdo gjëje, krijimin e njeriut të parë nga balta, ashtu edhe për origjinën e tij nga një ujë i dobët, e pastaj dhurimin e shpirtit, shqisave dhe të të menduarit. Këtu përmendet edhe vdekja dhe meleku që është i caktuar për marrjen e shpirtave.⁵

OBJEKTIVAT E EDUKIMIT ISLAM NË KAPTINËN LLUKMAN

Një ndër synimet parësore të fesë islame është motivimi i njerëzve, duke i udhëzuar në besimin e drejtë dhe në sjellje të duhura - vepra të mira - t'i edukojë ata në frymën e mirësisë, paqes dhe ndershmërisë. Nisur nga ky fakt edhe mund të thuhet se personaliteti i Pejgamberit, a.s., paraqet sinonim dhe mozaik të virtyteve më të larta morale me të cilat u qëndis qenia njerëzore. Nuk ndodh të përmendet ky njeri-pejgamber i madh, e mos të na bjerë ndër mend sasia e vlerave të larta njerëzore që kishte, si simbol i unifikimit të virtyteve morale. Se si ka qenë karakteri i Muhamedit, a.s., më së miri e shohim në Kuranin fisnik, ku përveç tjerash thuhet: “Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut.”⁶

Aspekti edukativ kuranor përmendet edhe në kaptinën Llukman, në mënyrë të shkoqitur. Në lidhje me këtë komentuesi Sejjid Kutbi thekson se temat që trajton kjo kaptinë janë të një stili të përsosur. Për ta kuptuar këtë stil të mrekullueshëm të Kuranit, i cili tërheq zemrën dhe natyrën e njeriut, kërkohet mendim dhe meditim i thellë mbi to. Prandaj, çdo thirrës në rrugën e Zotit duhet të mendojë mbi këtë mënyrë edukative të thirrjes, dhe ta zotërojë atë.⁷ Në kaptinën Lukman, sa i përket objektivave të edukimit islam, mund të konsiderohen dy parime, edukimi i njerëzve që të jenë të drejtë dhe vepërmirë, dhe - si rezultat i natyrshëm i qëllimit të parë - t'i bëjë njerëzit të lumtur në të dy botët.

Niveli që i Plotfuqishmi e dëshiron për robërit e Tij, përmes edukimit kuranor, është niveli i “individit të drejtë, vepërmirë/salih”. Në lidhje me këtë thuhet: “E ata që besuan dhe bënë vepra të mira, për ata janë xhenetet e begatshme, që në to janë përgjithmonë. Premtimi i Allahut është i prerë, e Ai është i Gjithëfuqishmi, i Urti.”⁸ Shprehja salih rrjedh nga “sa-la-ha” që në leksik do të thotë “korrektësi, të qenët në vend, përshtatshmëri, zbatueshmëri, përdorshmëri”.⁹ Ibën Abbasi, në interpretimin këtij ajeti, konceptin “vepra të mira” në kuptimin gjithëpërfshirës, dhe i përshkruan si të gjitha adhurimet që paraqesin lidhjen ndërmjet Zotit të Plotfuqishëm dhe robit të Tij, ndërsa në kuptim të veçantë e kufizon atë me faljen e namazit dhe agjërimin.¹⁰ Ndërsa, komentuesi Kurtubiu “veprat e mira” i përkufizon si adhurime të obliguara prej Allahut.¹¹ Ibën Kethiri i përshkruan si “vepra të mira që besimtari i beson me zemër dhe i kryen me gjymtyrët e tij”. Përdërisa interpretuesit e Kuranit theksojnë se koncepti “vepra të mira”, ashtu siç i përfshin të gjitha ato vepra që janë të miratuara prej Zotit dhe të Dërguarit të Tij,¹² të vërtetuara me prova racionale dhe transmetime¹³, vepra të cilat në vete përfshijnë të gjitha sjelljet

e mira,¹⁴ në kaptinën Llukman përmenden pesë elemente themelore që e bëjnë njeriun vepërmirë përmenden: Teuhidi/Njësimi i Allahut të Lartësuar, zbatimi i urdhrave të Tij, durimi, morali i mirë dhe urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga të këqijat.

Teuhid që do të thotë “Njëshmëri”, dhe paraqet besimin në Njëshmërinë absolute të Allahut të Lartë, pra, është çelës, princip fundamental i Islamit dhe bazë e besimit të një myslimani. Në Kuran ekziston një lidhje aq e fortë ndërmjet besimit dhe veprave të mira, sa pothuajse kudo që përmendet besimi, menjëherë pas tij vjen vepra e mirë. Ashtu siç hija e ndjek njeriun, veprat e mira e pasojnë besimin në Kuran. Me fjalë të tjera, veprat e mira janë pasqyrim i jashtëm i besimit në zemër. Si rrjedhojë, edhe tregimi për këshillat e Llukmanit drejtuar birit të vet, i përmendur në këtë kaptinë, ashtu siç është një fakt bindës se njerëzit e mençur gjithnjë e kanë ndjekur rrugën e drejtë, rrugën e Zotit, e jo siç bënin idhujtarët injorantë, po ashtu është një metodë kuranore edukimi mbi elementin parësor të thirrjes. Në lidhje me këtë është shpallur: “(Kujtoja popullit tënd) *Kur Llukmani, duke e këshilluar, birit të vet i tha: “O djali im, mos i përshkruaj Allahut shok, sepse idhujtaria është padrejtësia më e madhe!”*¹⁵ Pra, Llukmani filloi edukimin islam duke e luftuar politeizmin, ngase është një përpjekje e kotë të përpiqesh në edukimin e individit dhe përsosmërinë e tij me virtyte të larta morale dhe vepra të mira kur në zemrën e tij akoma ekzistojnë elemente të shirkut/politeizmit. Prandaj, hapi i parë dhe më i rëndësishëm i edukimit islam është edukimi i mirëfilltë mbi besimin në Zot. Sepse, që një vepër të konsiderohet si e mirë, duhet të jetë e kryer prej një besimtari të larguar nga shirku, të bëhet me qëllim të mirë, me sinqeritet dhe në harmoni me parimet e Islamit. Punët e mira e të dobishme, të bëra prej ndonjë jobesimtari, nuk mund të konsiderohen brenda fushës së “veprës së mirë”. Sepse besimi është i domosdoshëm për vlefshmërinë e një veprë. Në Kuran thuhet: “*E kush e mohon (e tradhton)*

Njeriu, për të qenë prej vepërmirëve, duhet të stoliset dhe të fitojë shprehi të përmbushjes së adhurimeve, e që janë ushqim dhe lumturi e çdo besimtari të sinqertë, kënaqësi e shpirtit dhe mëshirë e dhuruar prej Zotit për robërit e Tij.

*besimin, ai e ka asgjësuar veprën e vet, dhe ai në botën tjetër është prej të shkatërruarve.”*¹⁶

Elementi i dytë që një person të konsiderohet vepërmirë është përmbushja e obligimeve të urdhëruara prej Zotit të Madhërishëm. Komentuesi Zuhajli thekson se nuk mjafton vetëm besimi që një person ta arrijë shpëtimin, përderisa nuk i përmbush obligimet që ndërliken me besimin e tij.¹⁷ Në këtë kaptinë përmendet që Llukmani, pasi e thirr djalë e tij për largim nga politeizmi dhe ia tërheq vëmendjen për diturinë dhe fuqinë e Allahut, e këshillon atë që të bëjë vepra të mira, të cilat e pasqyrojnë besimin e tij: “*O djali im, fale namazin, urdhëro për punë të mira dhe ndalo nga të këqijat, përballo me durim çdo gjë që të godet, se vërtet këto janë nga çështjet më të preferuara!”*¹⁸ Pra njeriu, për të qenë prej vepërmirëve, duhet të stoliset dhe të fitojë shprehi të përmbushjes së adhurimeve, e që janë ushqim dhe lumturi e çdo besimtari të sinqertë, kënaqësi e shpirtit dhe mëshirë e dhuruar prej Zotit për robërit e Tij.

Pa dyshim se një ndër këto adhurime është edhe namazi, që ka një pozitë madhështore në Islam, dhe një vlerë të madhe tek Allahu, tek i Dërguari i Tij dhe te besimtarët, për vetë faktin se është shtylla e dytë e Islamit, menjëherë pas Shehadetit (Dëshmisë). Po ashtu, urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga të këqijat, po edhe durimi karshi çdo fatkeqësie, konsiderohen disa nga aspektet më të rëndësishme të besimit dhe nga tiparet që e plotësojnë një individ vepërmirë. Të besuarit pa mbështetje me vepra të mira mund të jetë çështje kohe që të mjugullohet, apo edhe të humbasë fare.

Një nga elementet që duhet ta posedojë një vepërmirë, të përmendura në këtë kaptinë, është dhe morali i mirë: “*Dhe mos e shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve, mos ec nëpër tokë kryelartë, se Allahu nuk e do asnjë mendjemadh e që shumë lavdërohet! Të jesh i matur në ecjen tënde, ule zërin tënd, se zëri më i egër është zëri i gomarit!”*¹⁹ Sejjid Kutubi, në interpretimin e ajetit sqaron se Hz. Llukmani, pasi e thirri të birin e tij në teuhid dhe adhurim, e ftoi atë për disa sjellje



morale, ngase ai dëshironte që biri i tij të qëndronte larg sjelljeve që nuk i përshtaten një besimtar, dhe të kishte moral të mirë në raport me njerëzit.²⁰ Në këtë kontekst i Dërguari i Zotit thotë: “*Ki frikë Allahun kudo që je, dhe paso të keqen me të mirën që ta fshin atë, dhe sillu me njerëzit me një moral të lartë.*”²¹ Ibën Kajim El Xhevziu thotë se Pejgamberi, a.s., ka bashkuar mes frikës ndaj Allahut dhe moralit të mirë, dhe kjo për shkak se frika ndaj Allahut i përmirëson raportet mes robit dhe Zotit të tij, ndërsa morali i mirë i përmirëson raportet mes tij dhe krijesave të tjera. Po kështu, me frikën ndaj Allahut fitohet dashuria e Tij, dhe me moralin e mirë fitohet dashuria e krijesave të tjera.²² Kështu kuptohet se nuk përkryhet besimi i robit përderisa nuk plotësohet morali i tij, ngase morali është bazament për ngritjen e civilizimit njerëzor.

Në Kuran vihet në pah fakti se Allahu i Madhëruar e krijoi njeriun në mënyrën më të përsosur, dhe se shpëtimi i besimtarit në Ditën e Gjykimit varet nga pesha e veprave të tij të mira. Po ashtu, në kaptinën Llukman thuhet: “*E ata që besuan dhe bënë vepra të mira, për ata janë xhenetet e begatshme, që në to janë përgjithmonë.*” Këtu bëhet fjalë për fatin e të mirëve, pra, për ata që besuan në Zotin dhe të Dërguarin e Tij, që bënë vepra të mira, duke i ndjekur urdhrat

e Zotit, se për ta janë përgatitur kopshtet e larta, në të cilët do ta shijojnë atë që syri nuk e ka parë, veshi nuk e ka dëgjuar dhe asnjë zemër njerëzore nuk e ka imagjinuar.²³ Pra, të tillët do të jenë në mesin e të shpëtuarve dhe të lumturve në botën tjetër.

Nisur nga këtu, konsiderohet se objektivi përfundimtar i edukimit kuranor, e si rrjedhojë edhe i kaptinës Llukman, është ngritja e robit në nivelin e “njeriut të drejtë e vepërmirë”, dhe ofrimi i lumturisë në të dy botët: “*Të cilët rregullisht e falin namazin dhe e japin zeqatin, dhe ata, mu ata, janë të plotbindur për botën tjetër (Ahiretin). Të tillët janë të udhëzuar në një rrugë të qartë prej Zotit të tyre, dhe ata janë fatlumë.*”²⁴. Duke qenë se shprehja “dhe ata janë fatlumë” është përdorur në kuptim të përgjithshëm, kjo nënkupton shpëtimin si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.²⁵ Si rrjedhojë, një besimtar salih/vepërmirë e arrin lumturinë edhe në këtë botë, e edhe në Ahiret. Lumturinë e kësaj bote e arrin duke e shijuar besimin dhe kënaqësinë e tij, edhe nëse jeton i sprovuar në varfëri, pra është i durueshëm dhe ngushëllohet nga shpërblimi që do ta marrë në botën tjetër. Në anën tjetër, nëse posedon mundësi të mëdha financiare, nuk devijon nga rruga e drejtë. Përkundrazi, ai e fiton dhe e shpenzon atë në rrugën e Zotit, duke e shpresuar kënaqësinë e Tij. E, ky synim mund të realizohet si rezultat i natyrshëm i të qenët vepërmirë, dhe është një premtim i Zotit të Lartësuar për ata që besojnë dhe jetojnë në harmoni me besimin e tyre.

1 Llukman, 31/2.

2 Llukman, 31/7.

3 Rrum 30/27; Llukman 31/28.

4 Llukman 31/4; Sexhde 32/1, 2, 3.

5 Es Sekafi, El Burhan fi Tenasubi Suveri'l Kuran, f. 144-145.

6 Ahzab 33/21.

7 Sejjid Kutub, Fi Dhilali'l Kur'an, V/2780.

8 Llukman, 31/8-9.

9 Isfahani, Mufredat, f. 230.

10 Taberi, Xhamiu'l Bejan, XXIV/590.

11 Kurtubi.

12 Taberi, Xhamiu'l Bejan, I/383.

13 Zemahshri, I/125.

14 Ibën Kethir, Tefsiru'l Kur'ani'l Adhim, VIII/480.

15 Llukman, 31/13.

16 Maide, 5/5.

17 Zuhajli, Tefsiru'l Munir, XXI/129.

18 Llukman, 31/17.

19 Llukman, 31/18-19.

20 Sejjid Kutub, Fi Dhilali'l Kuran, V/2780.

21 Sunen Et Tirmidhi, 4/355, nr. 1987.

22 Ibën Kajim El Xhevzi, El Fevaid, f. 84-85.

23 Ibën Kethir, Tefsiru'l Kur'ani'l Adhim, VIII/480.

24 Llukman, 31/4-5.

25 Zuhajli, Tefsiru'l Munir, XXI/128-129.

Besimtari dhe pastërtia

Hetem Sopjani

Pastërtia cilësohet edhe si obligim fetar për besimtarin, i cili duke qenë vetë i pastër, kërkon pastaj edhe nga shoqëria e tij të jenë të pastër fizikisht dhe shpirtërisht.

Allahu, xh.sh., thotë në Kuran: “Ai që e pastroi vetveten vërtet se ka shpëtuar. Dhe ka dështuar ai që e poshtëroi veten!”¹.

Detyrat e besimtarit në këtë botë janë të shumta, dhe një nga ato detyra të tij është edhe kujdesja për trupin, të cilin do të duhej ta ruante ashtu siç duhet dhe siç është urdhëruar. Në radhë të parë, besimtari duhet të kujdeset për pastërtinë trupore, sepse pastërtia trupore është kushti themelor i shëndetit të njeriut. Për këtë kemi shumë versete të Kuranit dhe thënie të pejgamberit Muhamed, a.s., që flasin për pastërtinë. Allahu, xh.sh., thotë: “... dëshiron të ju pastrojë ju...”², pra, ky ajet tregon përgjithësimin e kërkesës për pastrim dhe kërkesën për eliminimin e ndyrësirës në gjymtyrët e abdesit. Kështu që, edhe abdesi është disi pjesë (element) në pastrimin e trupit të njeriut. Ndërsa, në anën tjetër, edhe pejgamberi ynë, Muhamedi, a.s., thotë se “pastërtia është gjysma e imanit-(besimit)”³.

Nga këtu kuptojmë se Islami mban një qëndrim shumë të qartë dhe shumë të prerë mbi pastërtinë trupore, ndaj së cilës njeriu duhet të ketë shumë kujdes.

Mirëpo, njeriu e ka edhe natyrën e vet të brendshme, e që është shpirti i tij. E, besimtari e ka për obligim të kujdeset edhe për këtë lloj pastërtie; pastërtinë shpirtërore. Nga këtu duket qartë se një nga veçoritë kryesore të Islamit është pastërtia, nga e cila buron forca trupore, shëndeti dhe gjallëria. Një perëndimor i kthyer në Islam thotë: “Sikur mos të kishte në Islam asgjë tjetër përveç pastërtisë, prapë kjo do të mjaftonte.”. Për këtë arsye, besimtarit i mbetet si detyrë ta ruajë pastërtinë trupore dhe atë shpirtërore, duke e stolisur me virtyte të larta morale, ngase vetëm kështu ai arrin të afrohet te Krijuesi i tij.

QËNDRIMI I ISLAMIT NDAJ PASTËRTISË

Feja jonë islame i ka kushtuar shumë rëndësi pastërtisë trupore dhe shpirtërore. Besimtari, para së gjithash, mund të prezantohet dhe të dëshmohet si i tillë vetëm nëse vepron dhe sillet në pajtim me rregullat që i përcakton Kurani dhe tradita e Pejgamberit, a.s. Besimtarit nuk guxon të shfaqë përtaci e plogështi gjatë ruajtjes së pastërtisë së tij, por duhet të ndihet krenar për pastërtinë e tij, ngase Allahu i do kështu robërit e Tij të devotshëm. Allahu, xh.sh., në Kuranin fisnik thotë: “..Allahu i do të pastrit.”⁴.

Pastërtia cilësohet edhe si obligim fetar për besimtarin, i cili duke qenë vetë i pastër, kërkon pastaj edhe nga shoqëria e tij të jenë të pastër fizikisht dhe shpirtërisht. Në të kundërtën, besimtarit i kërkohet që të largohet nga shoqëria e papastër vetëm atëherë kur shihen punët e tyre të liga. Njeriu duhet ndjekur rrugën e drejtë dhe të vërtetë gjatë jetës në këtë botë, dhe mos ta tregojë veten të dobët, duke lejuar që me fatin e tij të luajë epshi dhe materia, të cilat njeriu mund ta hedhin në një nivel tejet të ulët, e që më së paku përkon me karakterin e tij.⁵

Në një proverb arab thuhet: “Kurrë mos pyet për njeriun se çfarë është, por pyet për shokun e tij, sepse shoku në shokun shikohet.”⁶.

EDUKIMI I VETVETES, SI RRUGË E PASTËRTISË SHPIRTËRORE

Ilaçi më i mirë kundër papastërtisë trupore dhe shpirtërore është vetë besimi në Allahun, xh.sh., dhe respektimi i urdhrave të Tij. Përpiqu që në këtë besim ta edukosh vetveten, e ta duash Allahun, xh.sh., ngase pastaj gjuha, veshët, sytë, këmbët dhe duart tua do të jenë patjetër të pastra. E, kur Allahu të të dojë ty,

ka për të të ndihmuar në rrugën tënde të pastër. Prandaj, prej besimtarit kërkohet që ta ruajë pastërtinë dhe organet e trupit, si nga gjërat e pahijshme, ashtu edhe nga veprat e liga. Muhamedi, a.s., ka thënë: *“Myslimani i vërtetë është ai që s’u sjell dëm njerëzve as me gjuhë, dhe as me dorë.”* Nga kjo thënie e Pejgamberit, a.s., kuptojmë se plaga e gjuhës është më e rëndë sesa e dorës. Një poet arab thotë: *“Plaga e gjuhës shërohet disi, kurse e gjuhës kurrësi.”* Ndërsa, Muhamedi, a.s., ka thënë: *“Kush e beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit, le të flasë fjalë të mira, ose le të heshtë!”*⁷.

SI TA RUAJMË PASTËRTINË TRUPORE DHE ATË SHPIRTËRORE?

Sipas Kuranit dhe haditheve të Pejgamberit, a.s., turpi është një bazë e fuqishme që ndikon në ruajtjen e pastërtisë sonë morale. Turpi e ngre njeriun në shkallen më të lartë të moralit, e ruan dhe e mbron atë, që mos të degradohet në veset e liga e të njollosjes, ngase njeriu që nuk ka marre, nuk ka as besim të plotë. Pejgamberi, a.s., ka thënë: *“Kur nuk ke turp, puno çka të duash.”*⁸.

Sikurse që duhet të ruhen organet trupore nga gjërat e pahijshme, përmes turpit, ashtu duhet të ruhet edhe ana e brendshme e trupit, pra, nga çdo gjë që është e pahijshme. Turpi mund ta ndihmojë njeriun më së miri në ruajtjen e pastërtisë trupore dhe të asaj shpirtërore. Ai është si një forcë shpirtërore që e pengon njeriun nga çdo punë e keqe dhe e shëmtuar. Meqë turpi e ruan njeriun nga të këqijat, këtë Muhamedi, a.s., e numëroi ndër pjesët e Imanit, duke thënë: *“Besimi është gjashtëdhjetë e sa pjesë-degë, e edhe turpi është një nga ato pjesë-degë të besimit.”*⁹. Në historinë islame tregohet se njëherë, kur Pejgamberi, a.s., ishte duke kaluar rrugës, e kishte dëgjuar një ensar duke e qortuar vëllanë e vet, për shkak se ai ishte i turpshëm. Pejgamberi, a.s., i ishte afrua afër, dhe i kishte thënë: *“Lëre, se turpi është pjesë e imanit.”*¹⁰. Këto porosi të Pejgamberit, a.s., na e bëjnë të qartë rëndësinë dhe peshën që ka turpi në jetën e besimtarit, po edhe të njeriut në përgjithësi; kush e ka këtë cilësi e ka ruajtur besimin dhe nderin, kurse kujt i mungon kjo cilësi, atij i mungon besimi, nderi edhe punët e mira.

Turpi, sipas mendimit të dijetareve, është tre llojesh:

Turpi prej Allahut, xh.sh.;

Trupi prej njerëzve në përgjithësi, dhe;

Turpi prej vetvetes.

a) Turpi ndaj Allahut, xh.sh., është ai që na bën të jemi të vullnetshëm në kryerjen e urdhrave të Tij, si në: faljen e namazit, dhënien e zekatit, agjërimin e Ramazanit, kryerjen e Haxhit, dhe kryerjen e të gjithave punëve të mira, atyre që Allahu xh.sh., na ka urdhëruar t'i kryejmë. Dhe, ai është që na pengon ne nga kryerja e atyre punëve që Ai na ka ndaluar. Një ditë prej ditëve Muhamedi, a.s., u tha shokëve



te tij: *“Turpërohuni para Allahut me turpërim të vërtetë!”*¹¹, e shokët e pyetën: *“O i Dërguari i Allahut, si të turpërohemi vërtet para Allahut, xh.sh.?”*. Atëherë ai u tha: *“Me të vërtetë Allahut, xh.sh., i turpërohen ata që e ruajnë kokën e tyre dhe çka ka në të, dhe që e ruajnë e ruajnë barkun e tyre, që kënaqësinë e kësaj bote e këmbëjnë me kënaqësi të tjera, dhe ata që nuk e harrojnë vdekjen.”*

b) Turpi prej njerëzve në përgjithësi na bën që të largohemi nga ajo që është e keqe, e cila si veti e shëmtuar natyrisht se do të ngjallte urrejtje te njerëzimi. Ai person që nuk ka frikë prej Allahut dhe nuk turpërohet prej Tij, së paku mund të pengohet nga veprat e liga, nëse ai turpërohet prej të tjerëve.

c) Turpi prej vetvetes është një mirësi e madhe dhe virtyt me vlerë. Ruajta e vetvetes dhe kujdesi ndaj vetvetes, qoftë nga puna e keqe apo edhe nga një gjë e pahijshme, edhe kur je në vetmi, do të ishte suksesi më i madh për njeriun. Njeriu turpërohet të bëjë veprime të pahijshme edhe në vetmi, ngase ai e ka bindjen se Allahu është duke e parë e duke e vëzhguar kudo qoftë. Për këtë kemi fjalët e Allahut Fuqiplot, kur thotë: *“Pa dyshim se Allahu sheh e vëzhgon gjithçka mbi ju.”*¹².

O Zoti ynë, na mbulo me mëshirën Tënde, dhe na e stolis shpirtin tonë me pastërti e çiltërsi, se Ti je i Plotfuqishëm e Bujar!

1 El Shems, 9-10.

2 El Maide, 6.

3 Transmetues: Buhariu dhe Muslimi, f. 233.

4 El Teube, 108.

5 Naim Tërrnava, *Morali Islam, Ahlaku II*, Prishtinë, 1996. f. 18.

6 Dr. Muhsin Abdullah, *Xhudhurul Et Terihije*, Kajro, 1980. f. 57.

7 Transmetues: Imam Buhariu dhe Imam Muslimi.

8 Sahih El Buhari

9 Muttefak Alejhi.

10 Amër Halid, *Përmirësimi i zemrave*, Shkup, 2006, f. 51.

11 Tirmidhiu, 2458.

12 En Nisa, 1.

Fëmijëria e të dërguarit të Allahut, a.s.

Mr. Besim Krasniqi

Në historinë njerëzore nuk do të gesh ndonjë njeri që i është studiuar e hulumtuar jeta më shumë të Dërguarit të Allahut, *alejhi selam*. Çdo detaj i jetës së tij të bekuar është shënuar në regjistrat e historisë, gjë që nuk ka ndodhur me askënd tjetër para tij, dhe nuk do të ndodhë me askënd pas tij.

Në historinë njerëzore nuk do të gesh ndonjë njeri që i është studiuar e hulumtuar jeta më shumë të Dërguarit të Allahut, *alejhi selam*. Çdo detaj i jetës së tij të bekuar është shënuar në regjistrat e historisë, gjë që nuk ka ndodhur me askënd tjetër para tij, dhe nuk do të ndodhë me askënd pas tij. Shekuj me radhë sheh miliona e miliarda njerëz, që studiojnë në hollësi historinë e tij të bekuar, prejardhjen e familjes së tij, fjalët dhe veprat e tij, deri te gjërat më të imta, si mënyra e të ushqyerit, të fjeturit, madje e sheh se si diskutohet edhe për numrin e qimeve të bardha në mjekrën e tij. Kjo është mbresëlënëse! Kjo nuk ka mundësi të ndodhë, përveçse me ndihmën dhe suksesin prej Allahut të Lartësuar, i Cili i premtoi të Dërguarit të Tij, *alejhi selam*, në Kuran, duke i thënë: “Dhe Ne ta ngremë lart famën tënde!”¹

S’ka dyshim se e gjithë jeta e të Dërguarit, *alejhi selam*, është e bekuar dhe e mbushur me mirësi, e kështu ishte edhe fëmijëria e tij. Kjo jo për shkak të përkujdesjes së mirë të babait të tij, ngase babai i kishte vdekur duke qenë i Dërguari, *alejhi selam*, në barkun e nënës së tij, por për shkak të përkujdesjes së Allahut dhe mëshirës së Tij. Allahu i Lartësuar ia kujton këtë mirësi të Dërguarit të Tij, *alejhi selam*, kur i thotë: “A nuk të gjeti ty jetim, e Ai të bëri vend (të dha përkrahje). Dhe të gjeti të paudhëzuar e Ai të udhëzoi. Dhe të gjeti të varfër, e Ai të begatoi.”²

Prandaj, nëse e studiojmë jetën e të Dërguarit, *alejhi selam*, do ta shohim se jeta

e tij, që nga fillimi e deri në mbarimin, ishte jetë e begatë, e mbushur me urtësi e begati. Ai i bekuar lindi në vitin e elefantit,³ në ditën e hënë, në vitin 571, sipas kalendarit diellor. Ajo ishte ditë e bekuar, të cilën ditë i Dërguari, *alejhi selam*, e ka kujtuar gjatë tërë jetës së vetë, dhe e kujtojnë edhe sot myslimanët. Njëherë një njeri e pyeti të Dërguarin, *alejhi selam*, për agjërimin e ditës së hënë, e atëherë ai ia ktheu: “Kjo është dita në të cilën kam lindur, dhe po në këtë ditë më ka ardhur shpallja!”⁴

Momentin kur ai i bekuar erdhi në jetë e kishte përshkruar edhe nëna e tij, Emineja, e cila kishte thënë: “Kur e kam lindur, bashkë me të kam lindur edhe një dritë të madhe, nga e cila kanë shkëlqyer pallatet e Shamit!”⁵

Myzhdeja e lindjes së tij u përhap shpejt në Mekë, akoma pa iu vënë emri, dhe njerëzit thoshin se kishte lindur jetimi i birit të Abdul Mutalibit.⁶ Pavarësisht si e quanin njerëzit, Allahu e inspiroi gjyshin e tij, Abdul Mutalibin, që ta emëronte atë me emrin Muhamed, emër që deri atëherë nuk ishte i njohur e as i përmendur ndonjëherë. Kush e dinte se ky jetim do ta ndryshonte fatin e botës, do të bëhej ai që i fton njerëzit në përkujdesjen e jetimit e skamnorit, do të bëhej ai që u thotë njerëzve: “Unë dhe kujdestari i jetimit do të jemi në Xhenet së bashku, sikur këta dy gishta!” – duke i bashkuar gishtin tregues dhe të mesmin.⁷

Mirëpo, atë kohë nga ky jetim largoheshin të gjitha gratë mëndesha, të cilat kishin ardhur të gjenin nga një foshnje që ta



Nga dashuria
e madhe që
Ebu Talibi
kishte për
Muhamedin,
atë nuk e
ndante prej
vetes
asnjëherë.

ushqenin me gji e ta merrnin me vete në viset malore, kjo kundrejt një pagese që ia bënin familjet e foshnjave. Kështu, të gjithë fëmijët e lindur atë vit gjetën nga një nënë që t'i ushqente e nga një familje ku të qëndronin, përveç Muhamedit, birit të Abdullahut.

Dielli i asaj dite gati sa s'kishte perënduar, dhe Halimja, nga fisi Benu Sad, nuk kishte gjetur asnjë fëmijë që ta ushqente, ndërsa fisi i saj e priste që të ktheheshin në vendin e tyre. Kështu, duke mos dashur të kthehej duarthatë, shkoi tek Emineja, dhe ia kërkoi prapë jetimin e saj, të cilin në mëngjes e kishte refuzuar. Ajo e mori jetimin e vogël në duar, duke thënë: "Do ta ushqej pavarësisht se është jetim e i varfër. Ndoshta Allahu do të na bekojë me të!". Dhe me të vërtetë akoma pa u larguar nga lagjet e Mekës filloi të vërehej bereqeti i tij, i cili vinte nga çdo anë.⁸

Ky fëmijë i bereqetshëm ia ndryshoi jetën Halimes dhe familjes së saj. Rugës për në shtëpi gomari i Halimes i printe

karvanit, ani pse kur erdhën në Mekë me zor ecte, dhe mbetej i fundit në radhë. Delet e Halimes dhe të burrit të saj asnjëherë më shumë nuk kishin pasur qumësht, dhe një qetësi e mbuloi shtëpinë e tyre; kjo ngase Allahu i kishte begatuar me Pejgamberin, alejhi salam, në mesin e tyre.

Koha kalonte shumë shpejt, dhe jetimi i vogël në shtëpinë e Halimes rritej dita ditës. Sa rritej ai, aq shtoej edhe bereqeti dhe mirësitë përreth tij. Kur i mbushi dy vjet, dhe Halimja e plotësoi kohën e gjdhënies, dhe erdhi koha që Muhamedi të kthehej në shtëpinë e tij, në Mekë. Sa zor ishte ndarja prej një fëmije të tillë! Halimja do bënte çmos që ta bindte nënën e tij për ta lënë edhe për pak kohë Muhamedin tek ta. Këtë e përshkruan vetë Halimja, e cila thotë: "Atëherë vendosëm që t'ia dërgojmë nënës së vet. Ishim të pikëlluar dhe të mjerë, për shkak të ndarjes. Nënës së tij i treguam se çfarë mbarësie kishim në shtëpi me të, dhe i thashë: "Sikur ta lije te ne edhe për pak kohë, që të forcohet edhe më, do ta kishte më mirë se në qytet! Kam frikë se do t'i bëj keq ajri i qytetit!"⁹ Kështu u bind edhe Eminja, dhe lejoi ta merrnin Muhamedin prapë me vete, dhe ai qëndroi aty deri në moshën katër-pesë vjeçare.

Halimja shpeshherë mendonte ta kthente Muhamedin te nëna e tij, shkak që frikësohej nga xhelozia e të tjerëve, që mund të kishin për të. Si mos të kishin xhelozia kur e shihnin bukurinë dhe trupin e tij, oratorinë dhe mençurinë e tij! Po, ajo nuk mund të ndahej aq lehtë prej një fëmije të bekuar sikur ishte ai.

Një ditë ajo nuk mund t'i besonte veshëve të saj se çfarë po dëgjonte! Djali i saj erdhi duke vrapuar me shpejtësi, dhe thërriste: "Eja, oj nënë, shpëtoje Muhamedin! Dy persona me rroba të bardha e kanë shtrirë në tokë, dhe ia kanë larguar zemrën nga vendi, e po ia pastrojnë me ujë e borë! Eja, oj nënë, se Muhamedi ka mbetur i shtrirë përtokë!".

Ajo me vrap shkoi te Muhamedi, dhe e kapi atë, duke e pyetur se çfarë kishte ndodhur. Ai i bekuar e tregoi rastin ashtu sikur e kishte treguar edhe vëllai i tij nga qumështi! Atë natë Halimja nuk kishte vënë gjumë në sy, sa që të nesërmen, qysh në mëngjes, ishte nisur për në Mekë, dhe Muhamedin e kishte kthyer te nëna e tij. Emineja nuk u frikësua shumë kur e dëgjoi rastin. Ajo e dinte se fëmija i saj nuk ishte i zakonshëm, dhe e dinte mjaft mirë se fati i këtij fëmije do të ishte madhështor.¹⁰

Pas një kohe, Emineja e mori djalin e saj Muhamedin, dhe shkoi në vizitë te dajallarët e babait të tij, Abdullahut¹¹ dhe njëkohësisht ta vizitonte edhe varrin e tij. Rugës për në Mekë Emineja u sëmur dhe vdiq. Kështu ai i bekuar, me duart e tij të vogla prej gjashtëvjeçari, e varrosi nënën e tij, dhe u kthye në Mekë, i mërzhitur, pa të dy prindërit dhe pa ndonjë vëlla ose motër që të luante me të.

Kështu, përkujdesjen për të e mori përsipër gjyshi i tij Abdul Mutalibi. Ai plak i urtë dhe me autoritet, që ulej

përkaj Qabesë dhe gjykonte mes fiseve arabe, nga dashuria e madhe që kishte për nipin e tij, ia kishte bërë një vend afër vetes, e afronte dhe nuk e largonte për asnjë moment.

Përkujdesja e gjyshit e përcolli të Dërguarin, alejhi salam, deri në moshën tetë vjeçare, atëherë gjyshi i tij, që bënte çmos që nipi mos ta ndiente mungesën e prindërve, vdiq.¹² A e dini se cili ishte amaneti i tij i fundit? Mund ta merrni me mend se amaneti i tij ishte përkujdesja për Muhamedin. Dhe, këtë amanet ai ia la djalit të tij, Ebu Talibit, i cili e afroi nipin e tij dhe u kujdes për të më mirë se për fëmijët e vet.

Nga dashuria e madhe që Ebu Talibi kishte për Muhamedin, atë nuk e ndante prej vetes asnjëherë. Njëherë, duke u shëtitur rrugëve të Mekës, e shohin se kishte ardhur një parashikues, e arabët i dërgonin fëmijët tek ai, për t'i parë cilësitë e fëmijëve, e në bazë të tyre për t'i informuar ata për fatin e tyre në të ardhmen. Kështu, kur Ebu Talibi shkoi aty me Muhamedin dhe me fëmijët e tjerë, akoma pa hyrë brenda, parashikuesi filloi të bërtasë: "Atë djalë, atë djalë, silleni këtu! Për Zotin çështja e fatit të tij do të jetë e madhe!". Atë ditë e gjithë Meka fliste për Muhamedin!

Ebu Talibi, nga frika që e kaploi për nipin e tij, iku së bashku me të, dhe u kthyen në shtëpi. Frikësohej se mos do ta godiste diçka nga sytë e njerëzve, prandaj nuk largohej asnjëherë prej tij, flinte me të dhe e ushqente me duart e veta.¹³



Cilësitë e këtij fëmije të bekuar nuk fshiheshin. Ato i dallonte çdo njeri! Kur Ebu Talibi shkoi në Sham, së bashku me Muhamedin, prifti Behira porsa e pa një re mbi karvanin e kurjeshëve, e dinte se në mesin e tyre ishte dikush i bekuar. Kur e pa Muhamedin, qëndrimin e këtij fëmije të pjekur para kohe, mënyrën e të ushqyerit e të folurit të tij, ai i tha Ebu Talibit: "Kush është ky?" "Ai është djali im!" - menjëherë ia ktheu Ebu Talibi. Atëherë Behira tha: "Jo! Këtij djali nuk i takon që ta ketë babanë gjallë!". Dhe e këshilloi Ebu Talibin që ta ruante atë, sidomos nga hebrenjtë, ngase fati i këtij djaloshi nuk është sikurse i fëmijëve të tjerë!

Kështu u kthyen në Mekë, e dashuria e Ebu Talibit për nipin e tij rritej çdo ditë e më shumë. Ky djalosh me edukatë e moral, i mbushur me begati, të cilit çdo ditë e më shumë i dilnin në pah cilësi të mira e të pastra, në mesin e arabëve u bë i njohur me epitelin "I Sinqerti - Besniku".

Kjo ishte fëmijëria e të Dërguarit, alejhi salam, i cili qëkurse ishte fëmijë, u përgatit nga ana e Allahut të Madhëruar për një mision të madh, prandaj edhe ai i bekuar thoshte: "*Mua më ka edukuar Zoti im, në formën më të mirë!*"¹⁴.

Misioni i tij ishte edukimi i të tjerëve në formën që Zoti e kishte edukuar atë. Këtë mision e nisi pikërisht prej Aliut, djalit të Ebu Talibit, xhaxhait të tij. Kjo nuk ishte një rastësi, por nga kjo buron një urtësi e madhe, ngase i Dërguari i Allahut, alejhi salam, kishte për qëllim që të mirën ta kthente me të mirë. Ashtu sikurse Ebu Talibi u përkujdes për të Dërguarin, alejhi salam, kur ky ishte fëmijë, tashmë kishte ardhur koha që i Dërguari t'ia kthente me të mirë, dhe t'ia lehtësonte sadopak barrën xhaxhait të tij, duke u përkujdesur për njërin prej fëmijëve të tij të shumë.

Kështu ai i bekuar e nisi misionin e tij me edukimin e rinisë, duke i ftuar ata drejt parimeve të besimit dhe të moralit të mirë. (vazhdon)

1 Inshirah, 4.

2 Duha, 6-8.

3 Hafidh bin Kethir Ed Dimeshkij, *El Bidaje ve En Nihaje*, (Beirut: Daar El Kutub El Ilmijeh, 1985, vll. I), f. 232.

4 Muslimi, 167.

5 Safiju Rrahman El Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i Xhenetit*, (Prishtinë: Gjurma, 2018), f. 53.

6 El Keksij, Shejh Ahmed, "Jetim beni abdul mutalib". 02/10/2006. <http://www.wata.cc/forums/archive/index.php/t-336.html> (parë për herë të fundit më: 11/06/2023).

7 Muslimi, 2983.

8 Halil Mahmud Es Simadij, *Atfaal haule Resul*, (Kairo, Daar El Marafah, 2021), f. 11.

9 Safiju Rrahman El Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i Xhenetit*, 55.

10 Shih: Halil Mahmud Es Simadij, *Atfaal haule Resul*, f. 13!

11 Imam Shemsudin Ahmed bin Othman Edh Dhehebij, *Sijeru Alam En Nubela*, (Beirut, Er Risaleh, 1998, v. I), f. 54.

12 Muslim Ejnash, "Tufiletu Resul". 19/08/2021. <https://mawdoo3.com> (parë për herë të fundit më: 11/06/2023).

13 Shih: Halil Mahmud Es Simadij, *Atfaal Haule Resul*, 16!14. Hadithin e shënon Imam Sheukani në "El Feva'id El Mexhmua" (1020).

Kodi islam i mirësjelljes në telefon dhe në mediet sociale

Dr. sci. Flamur Sofiu

HYRJJE

Në kohën tonë bashkëkohore, pothuajse nuk ka shtëpi që nuk ka telefon, qoftë me rrjet tokësor qoftë mobil dhe që nuk ka qasje në rrjetin e internetit. Këto mjete të komunikimit janë një prej mirësive dhe begative të Allahut, që ia ka mundësuar njeriut t'i ketë në përdorim, si dhe se luajnë një rol shumë të madh në komunikimin e njerëzimit mes vete, duke kursyer kohën, angazhimin dhe aspektin material. Kjo begati që ne e shfrytëzojmë ka rregullat e mirësjelljes me të.

DISA NGA RREGULLAT BAZË QË KANË TË BËJNË ME PËRDORIMIN E TELEFONIT:

Të kihet kujdes për orarin e thirrjes:

Ai që thërret duhet të jetë i kujdesshëm se në cilën kohë po e realizon thirrjen, pra duhet që të mos thërras në orët shumë të hershme e as në orët e vona. Telefonatat janë të ngjashme me rregullat e vizitës, pra duhet zgjedhur kohën për thirrje, ashtu siç e zgjedh kohën për vizitë.

Moderimi në tonet e thirrjes:

Ajo se sa herë duhet të bëjmë thirrje në telefon, është e ngjashme me rregullat e kërimit të lejes për të hyrë në shtëpinë e tjetrit. Sipas sunetit të Pejgamberit a.s., duhet trokitur tri herë në derë për të marrë leje për të hyrë, përndryshe duhet të kthehemi pa kurrfarë hidhërimi. Andaj edhe në rastin e thirrjes, duhet të mos e teprojmë numrin e të cingëruarit, duke e ndalur thirrjen pas tri cingërimave. Ky rregull nuk vlen në raste të jashtëzakonshme.

Të filluarit e bisedës me selam:

Prej sunetit të Pejgamberit a.s. është që para bisedës të fillohet me selam. Transmetohet nga

Xhabir bin Abdilahi r.a., se i Dërguari a.s. ka thënë: **“Të jepet selam para bisedës.”**¹ Po ashtu duhet përmbyllur bisedën me selam, e assesi me forma të tjera. Ky rregull vlen kur flasim me atë që është mysliman, ndërsa me të tjerët përdorim format e zakonshme.

Të mos zgjatet biseda shumë nëse nuk ka nevojë:

Myslimani nuk duhet të veprojë asgjë kot dhe nuk flet për atë që nuk ka dobi, kështu që, një person duhet të shmangë të folurit shumë në telefon. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“(Besimtarët janë ata) të cilët shmangen nga fjalët e kota.”** (El Muminune, 3).

Duhet pasur kujdes që të mos përgojmë (gibet) dhe që të mos zgjasë biseda gjatë, gjë që ndodh të zgjasë edhe me orë të tëra. Ne si myslimanë, feja na urdhëron që të jemi të kujdesshëm edhe në aspektin e shpenzimit, në mënyrë të kotë në çdo aspekt të jetës. Në fenë islame konsiderohet vepër e urryer të folurit e kotë, duke folur se kështu e kështu po thuhet e të ngjashme. I Dërguari i Allahut, a.s. ndalonte thashethemet, shpërdorimin e parave, pyetjet e shumta.²

5. Vendosja e receptorit të telefonit tokësor me qetësi:

Duhet pasur kujdes kur ta vendosim receptorin e telefonit pas kryerjes së bisedës. Ta vendosim me qetësi e jo me forcë vetëm e vetëm që tjetri të mos mendojë se ka ndodhur diçka jo e mirë.

6. Të mbyllet telefoni kur të hyhet në xhami:

Prej edukatës së hyrjes në xhami është që të mbyllet telefoni ose të vendoset në statusin e heshtjes, me të vetmin qëllim që të mos i pengojë

Telefonatat janë të ngjashme me rregullat e vizitës, pra duhet zgjedhur kohën për thirrje, ashtu siç e zgjedh kohën për vizitë.



ata që do të falen në xhami apo edhe të mos bëhet shkaktar që dikush ta prish namazin. Kur ndodh që dikush e harron telefonin me zë të hapur dhe i cingëron brenda namazit, atij i lejohet disi ta ndalë.

7. Duhet të largohemi prej atij që është duke folur në telefon me qëllim që të mos e dëgjojmë tjetrin duke folur:

Është pjesë e mirësisë së Islamit të një personi që të ndalojë përgjimin e të tjerëve dhe nuk ka dyshim se një veprim i tillë është i refuzuar dhe i urryer. Pejgamberi a.s. e ka ndaluar një veprim të tillë, duke thënë: “Nëse dikush i dëgjon bisedat e njerëzve të tjerë kur ata përpiqen t’i shmangen atij, në Ditën e Kiametit do t’i derdhet plumbi në vesh.”³

8. Të folurit me zë të moderuar:

Sa e bukur është moderimi në jetën tonë, në adhurimin, sjelljen, transaksionet, ndjenjat dhe fjalët tona! Nuk ka as teprim, as neglizhencë dhe moderimi është një nga karakteristikat e ymetit tonë. Mu për këtë Allahu i Lartësuar ka thënë: “*Të jesh i matur në ecjen tënde, ule zërin tënd...*” (Llukman, 19).

Duhet të kihet kujdes qoftë nga ana e mashkullit apo e femrës që të mos folët me zë të lartë në vendet publike dhe në mjetet e transportit.

9. Assesi të mos përdoret telefoni i tjetrit, pos me lejen e tij:

Nuk është nga morali i një myslimani të përdorë gjërat e të tjerëve pa lejen e tij. Ndalohej që njeriu ta marrë telefonin e shokut ose vëllait të tij, ndalohej që ta hap atë dhe të shikon se çfarë ka në të, ngase në të ka gjëra personale vetëm të pronarit, që nuk lejohet dikush tjetër të ketë qasje.

Kujdes! Kur ndodh që të gjeni telefonin e tjetrit, assesi mos tentoni të shfletoni atë që ka në brendësi, se është vepër e ndaluar rreptësisht sipas Islamit dhe m[pastaj pasojnë dënimet nga ana e Allahut xh.sh.. Të shfletosh telefonin e tjetrit është sikur të hysh në gjërat private e sekrete të tij, e që një veprim i tillë është haram dhe i dënueshëm sipas të drejtës islame dhe veprim shumë i ultë në mesin e shoqërisë.

10. Të mos mburremi me telefonin:

Kjo sjellje nuk është e përshtatshme për një mysliman, si p.sh. mburrja me telefonin e tij para kolegëve të tij, ose dikujt që pëlqen të tërheqë vëmendjen, ose të bëjë thirrje false para njerëzve në mënyrë të rreme, vetëm e vetëm që të reklamohet se ka telefon të shtrenjtë apo të veçantë.

11. Kujdes nga regjistrimi i bisedave:

Nëse një thirrje është regjistruar pa lejen e palës tjetër, atëherë kjo konsiderohet si çështje mashtrimi dhe mos mbajtjeje amanetesh. Allahu i Lartësuar na ka ndaluar në formë të prerë që të tradhetojmë amanetin që e kemi

Prej edukatës së hyrjes në xhami është që të mbyllet telefoni ose të vendoset në statusin e heshtjes, me të vetmin qëllim që të mos i pengojë ata që do të falen në xhami apo edhe të mos bëhet shkaktar që dikush ta prish namazin.

ndaj Allahut, të Dërguarit të Tij dhe gjithë besimtarëve. Allahu i Lartësuar ka thënë: *“O besimtarë! Mos e tradhtoni Allahun dhe të Dërguarin e mos i tradhtoni amanetet që i keni mes jush me vetëdije”* (El Enfal, 27).

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Mysliman është ai nga gjuha dhe dora e të cilit janë të sigurt njerëzit, dhe besimtar është ai prej të cilit janë të sigurta jeta dhe pasuria e njerëzve.”⁴

12. Të sigurohemi që e kemi fikur-mbyllur telefonin në tubime dhe takime:

Të cingëruarit e telefonit u shkakton pakënaqësi-neveritje të pranishmëve, nuk është e përshtatshme që të lihet të cingërojë telefoni apo të zbavitet me të duke luajtur kot me të dhe më shumë se kaq, është gabim i rëndë që dikush në tubime t'i përgjigjet telefonatës, ngase një veprim i tillë vije në kundërshtim me rregullat e tubimit. Kur ndodh që është e domosdoshme përgjigja në telefonat, duhet marrë leje atyre që janë të pranishëm.

Shënim: Të preokupuarit me telefon duke i injoruar ata që janë prezent në tubime është vepër e ndaluar.

Ibën Abasi r.a., tha se i Dërguari i Zotit mori një unazë, por kur e vendosi, tha: “Kjo më ka larguar nga ju; që sot po i hedh një sy asaj dhe po ju hedh një sy juve.” Më pas e hodhi unazën.

Prej edukatës së Pejgamberit a.s. është që në tubime t'i kushtohet rëndësi atyre që janë prezent e jo te preokupohemi me diçka tjetër siç është telefoni. E veçanërisht duhet pasur kujdes kur i ke prezent prindërit, të mos preokupohesh me telefonin.

Ndërsa sa u përket rrjeteve sociale, siç janë: Facebooku, Whatssapi, Twiteri, Viberi etj., janë këto rregulla:

Duhet vërtetuar atë që është publikuar:

Secili duhet pasur kujdes në atë se çfarë po publikon. Thënë më qartë, duhet pasur kujdes kur publikon f.v. ndonjë hadith të Pejgamberit a.s., që mund të jetë hadith i trilluar e të ngjashëm.

Duhet shmangur nga llogaritë e rreme:

Disa të rinj mund të përdorin llogari të rreme dhe mund të krijojnë një llogari që tërheq miqësitë, korrespondencat dhe telefonatat e vajzave dhe mashtrime të tjera.

Mos humbja e kohës:

Disa mund t'u dorëzohen këtyre mjeteve të komunikimit, ndaj i dorëzohen kohës dhe e zvarritin deri sa të kalojë një orë ose dy orë, ose ndoshta e gjithë dita, duke lënë një gjë dhe duke hyrë në një tjetër.

Kujdesuni të publikoni atë që u sjell dobi të tjerëve:

Nëse çdo përdorues i Facebook-ut dhe WhatsApp-it do të kishte si synim nga ajo që publikon përfitimin e të tjerëve, atëherë sigurisht se nuk do të kishim kaq shumë gjëra të pavlefshme e të kota.

Moderimi në postime:

Ajo që shkakton mërzinë është kur gjen dikë që publikon dhe shpërndan më shumë se një postim, dhe rezultati tjetër është se ai nuk pranon asnjë postim prej të tjerëve. Mjafton të bësh një postim ose dy më së shumti.

Mos shtimi i të huajve - të panjohurve në listën e shoqërisë:

Mos pranoni të shtoni të huaj në një grup të ri, ose të bëni “tag” atë, ose të shpërndani një postim, përveçse me lejen e atij që ka postuar.

Kujdes nga shfrytëzimi i rrjeteve të internetit - WIFI-së nga të tjerët, pos me lejen e tyre:

Ky veprim pa leje konsiderohet vepër e ndaluar dhe cenim në pasurinë e tjetrit.

Bëhu çelës i së mirës dhe mbyllës ndaj së keqes:

Përdoruesi nuk duhet të marrë pjesë në përhapjen e veseve të ulëta, as të ndihmojë në përhapjen e lajmeve të rreme. Pra, duhet të jetë gjithmonë çelës i veprave të mira dhe të jetë i atillë që verifikon çdo lajm që i vije. Mu për këtë, Allahu i Lartësuar ka thënë: *“O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë, ashtu që të mos e goditni ndonjë popull pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë.”* (El Huxhurat, 6).

Mos e shfletu postën elektronike të tjetrit:

Nëse e has postën elektronike të dikujt që ka mbetur e hapur, mbylle dhe assesi mos tento të gjurmosh në të, ngase ky veprim është në kundërshtim me parimet e të drejtës islame. Mu për këtë, Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Mos jini kureshtarë për çështjet e njëri-tjetrit.”*⁵

PËRFUNDIM

Besimtari është përgjegjës për atë se si vepron në jetën e tij dhe se si sillet me të tjerët. Prandaj, në aspektin e përdorimit të mjeteve të komunikimit, duhet të jetë shumë i kujdesshëm, se një pakujdesi mund të shkaktoj probleme dhe telashe te vetvetja dhe shoqëria. Shfrytëzimi i begative të Allahut të Madhërishëm bëhet duke i respektuar parimet dhe rregullat e përcaktuara nga e drejta islame me qëllimin e vetëm që të mos bëhet ndonjë veprim i palejuar. Andaj neve si besimtarë mysli-manë na mbetet obligim që në shfrytëzimin e mirësive, në rastin konkret mjeteve të komunikimit, duhet të jemi shumë syhapur që me përdorimin e tyre të mos bëjmë veprime që e hidhërojnë Allahun e Madhërishëm dhe që u shkaktojnë telashe njerëzve.

1 Transmeton El Buhariu, hadithi nr. 2125.

2 El Buhariu dhe Muslimi.

3 Ebu Davudi, hadithi nr. 5024.

4 Transmeton En Nesaiu, hadithi nr. 4995.

5 Transmeton Muslimi, hadithi nr. 2563.

Përse nuk mund t'i shijoj namazet që i fali?!

Doç. Dr. Soner Duman

Abdullah bin Abasi ka thënë: *“Dy rekate namaz me praninë e zemrës janë më të mirë sesa qëndrimi zgjuar dhe falja tërë natën në rastet kur zemra nuk është e pranishme.”*

Kjo është një pyetje që më bëhet shpesh. Sigurisht se kjo pyetje nuk bëhet vetëm për diagnozën e shkaqeve, por në të njëjtën kohë herë-herë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë lë të nënkuptohet për metodën e trajtimit. Dikush madje këtë pyetje e formulon edhe me fjalë të tjera: “Mendja dhe mendimet tona janë në gjëra të tjera. A nuk është e pakuptimtë t'i bëjmë ibadetet në këtë mënyrë?!”

Fillimisht më duhet ta them këtë: Si i adresuari me këtë pyetje, askujt nuk i përgjigjem si “një person që i shijojnë namazet që i fal”; nuk përpiqem të paraqitem si i tillë. Si mund të jetë kështu? E njëjta gjë më ndodh edhe mua, në shumicën e kohës. Megjithatë, do të ndalem në ato që kanë thënë dijetaret për këtë temë, dhe për të cilat së paku mundohem t'i praktikoj, dhe që e ndiej një brejtje ndërgjegjeje kur nuk i zbatoj ato. Në këtë artikull do të mundohem ta bëj këtë.

Përfundimi që e nxora nga të gjitha leximet e bëra ishte ky: Arsyeja bazë se përse nuk e shijojmë namazin e bërë është se nuk e dorëzojmë veten komplet. Ju mund ta quani këtë “të qenët i përqendruar”. Pra, duhet të ndalemi në arsyet për këtë, dhe ta bëjmë pyetjen: “Pse nuk mund të përqendrohemi në namaz?”. Prandaj, le të mundohemi t'i marrim me pika ato që janë thënë për këtë temë!

1. Në vendin që falemi gjenden elemente që na shqetësojnë me zërin dhe imazhin e tyre, dhe që na e tërheqin vëmendjen në gjëra të tjera

Për ta përqendruar mendjen tonë në diçka, është e nevojshme ta ndalojmë rrjedhën e të dhënave nga organet tona shqisore. Për shembull, nëse mësuesi këndon në klasë, ose celulari i bie kur një student është në provim, a mundet që ky nxënës t'i përqendrohet provimit.

A nuk ju mbeten sytë në qëndisjet, dizajnet, zbukurimet shumëngjyrëshe në vendin që falet namazi (tepih apo sexhade) ose rroba?! Sigurisht se po. Kjo nuk është për t'u çuditur! Edhe të Dërguarit të Allahut, a.s., i mbeti shikimi (në këto zbukurime). Një herë, të Dërguarit të Allahut, a.s., iu dhurua një rrobë, që kishte mbi të qëndisje dhe zbukurime. Gjatë një kohe të namazit, pasi e fali namazin, e hoqi këtë rrobë, dhe tha: “Kjo rrobë më shpërqendroi gjatë namazit. Ma sillni rrobën e vjetër!”¹.

2. Të falurit pa i plotësuar nevojat tona fizike, sikurse urinë, gjumin, tualetin

I Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë: “Nuk ka namaz kur ushqimi është gati dhe kur je duke e duruar nevojën e madhe ose të vogël.”².

I Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë: “Kur dikush prej jush kotet gjatë namazit (nafile), le të bëjë gjumë gjersa t'i kalojë gjumi! Sepse,



nëse dikush duke u falur kotet, ai nuk e di se nga kthehet dhe çka bën, prandaj në vend se të kërkojë falje (istigfar), ai e qorton vetveten (pa vetëdije)³

Shumicën e rasteve, për shkak se pritojmë të marrim përsëri abdes, qëndrojmë në namaz e duke u shtrënguar e duruar për ta mbajtur abdesin. Ose, edhe pse na dridhen duart dhe këmbët nga uria, ne qëndrojmë në namaz, duke menduar për ushqimin, me pretendim se do “të falemi sa më shpejtë që të mundemi, për ta ngrënë pastaj ushqimin rehat”. Kur nuk e ndjekim këshillën e të Dërguarit, a.s., nevojat tona fizike na pengojnë në përqendrimin në namaz.

3. Nuk mendojmë rreth kuptimit të asaj që e lexojmë në namaz

Në ajetin që thotë se duhet të qëndrojë larg namazit ai që ka pirë alkool dhe është i dehur, Allahu, xh.sh., thotë: “O ju që besuat, mos iu afroni namazit duke qenë të dehur, derisa të dini se çfarë flisni...!” (Nisa, 43).

Kur nuk dimë se çfarë po themi, edhe pse nuk jemi të dehur, ndodh një situatë e ngjashme me situatën e përshkruar në këtë ajet. Disa mund të thonë: “Çfarë do të thuash, hoxhë, a duhet t’i lëmë të gjitha punët tona, dhe ta mësojmë gjuhën arabe për ta ditur kuptimin e asaj që e lexojmë në namaz?!”. Kjo nuk është ajo që dua të them! Nëse të gjithë do të donim, shumë lehtë do të kishim mundësi ta mësonim kuptimin e Subhanekes, Et Tahijatit, Salavateve, Duasë së Kunutit, sures Fatiha, apo edhe sureve të vogla që i lexojmë në namaz. Përdërisa i lexojmë këto, mund të mendojmë për kuptimet e tyre, edhe nëse nuk përputhen ajet pas ajeti. Të kuptuarit e domethënies të asaj që e lexojmë mund të ketë një efekt që do ta ndryshojë tërë rrjedhën e namazit. Situata e shumicës

prej nesh ngjan si dikush që shkon te një zyrtar i lartë qeveritar dhe bën një kërkesë, duke thënë diçka në një gjuhë që nuk e kupton askush përveç tij. Ne themi gjëra pa e ditur se çfarë po themi dhe se çfarë po kërkojmë. Abdullah bin Abasi ka thënë: “Dy rekate namaz me praninë e zemrës janë më të mirë sesa qëndrimi zgjuar dhe falja tërë natën në rastet kur zemra nuk është e pranishme.”⁴.

4. Nuk e kuptojmë se çfarë nënkuptojnë veprimet që bëjmë në namaz

Ne nuk e kuptojmë plotësisht kuptimin e ngritjes së duarve gjatë bërjes së tekbitit, lidhjes së duarve, kryerjes së rukusë dhe të sexhdës... Megjithatë, ato janë me tërë kuptim dhe akte bindjeje. Me tekbitin fillestar hedhim pas vetes çdo gjë tjetër, përveç Allahut të Lartë. Duke i lidhur duart ne qëndrojmë përpara Tij, e dhe lexojmë

Fjalën e Tij. Ne tregojmë bindjen tonë ndaj Tij, duke u përkulur në ruku. Duke bërë sexhde, ne e arrijmë kufirin përfundimtar në afrimin dhe bindje ndaj Tij. Duke dhënë salam, në fund, e rivendosim lidhjen që kemi prerë me vëllezërit bashkëbesimtarë qysh me tekbitin fillestar, dhe i përhëndesim njerëzit me salam, që është një parullë islame.

5. Një nga arsyet më të mëdha pse nuk mund të përqendrohemi në namaz është se djalli vazhdimisht na pëshpërit, dhe ne nuk kemi informacione të mjaftueshëm se si të sillemi me të

Pejgamberi ynë, a.s., thotë: “Kur njeriu fillon të falet, i vjen shejtani, dhe për shumë gjëra që nuk i bien në mend herëve të tjera, ia sjell vesveset, duke i thënë: “Kujtoje këtë; kujtojë atë; mendo për këtë!”. Në fund njeriu harron se sa rekate namaz i fali.”

Pejgamberi ynë, a.s., thotë: “Kur njeriu fillon të falet, i vjen shejtani, dhe për shumë gjëra që nuk i bien në mend herëve të tjera, ia sjell vesveset, duke i thënë: “Kujtoje këtë; kujtojë atë; mendo për këtë!”. Në fund njeriu harron se sa rekate namaz i fali.”

Kur falim namaz, mendojmë se në të ardhmen do të kemi shanse të bëjmë shumë ibadete, dhe të falim shumë namaze. Mirëpo, namazi që po e falim mund të jetë i fundit.

kujtojë atë; mendo për këtë!”. Në fund njeriu harron se sa rekate namaz i fali.”⁵.

Që të kemi mundësi t’u bëjmë ballë këtyre vesveseve, menjëherë duhet ta braktisim këtë mendim, dhe të kujtojmë se jemi në namaz, në momentin që na vjen diçka e re; duhet që mos të humbasim në mendime rreth asaj që na vjen, dhe duhet të rikthehemi në namaz. Gjatë namazit njeriu duhet ta mbajë zemrën si lumë, jo si liqe. Nëse një papastërti bie në lumë, uji do të rrjedhë dhe

do ta marrë atë. Ndërsa, nëse bie në liqen, qëndron atje përgjithmonë. Edhe ne nuk duhet të ngecim me mendime të ndryshme, të cilat na vijnë në mendje “vetëm” kur falemi, por duhet t’i kthehemi namazit menjëherë.

6. Kur jemi në namaz, nuk mendojmë mjaftueshëm se përballë kujt po qëndrojmë

Nëse gjatë namazit do të kemi mundësi ta kuptojmë plotësisht se jemi duke qëndruar në praninë e Allahut, xh.sh., Zotit të botëve, çdo gjë do të ishte shumë më ndryshe. Tani, mendoni pak nëse shefi i vendit tuaj të punës, ose guvernatori i qytetit ku jetoni, ju fton në praninë e tij! Sigurisht se ju ngatërrohet dora dhe këmba duke menduar: “Po dal para një personi me pozitë të lartë”. Kështu që, edhe e rregulloni veten! Ndërsa, kur falim namaz, edhe pse jemi përpara Allahut të Lartë, nuk dridhemi dhe nuk emocionohemi. I biri Hysenit, r.a., Aliu, kur kishte falur namaz, i ndërrohej fytyra ngjyrangjyra. Kur u pyet pse po i ndodhte ajo, ai u përgjigj: “A e dini se para kujt do të dalë pas pak?!”.

7. Nuk mendojmë sikur po e falim namazin e fundit

Kur falim namaz, mendojmë se në të ardhmen do të kemi shanse të bëjmë shumë ibadete, dhe të falim shumë namaze. Mirëpo, namazi që po e falim mund të jetë i fundit. Tani, mendoni pak: Pas pak do të hyni në një operacion me rrezik të lartë për vdekje, dhe po e falni namazin tuaj të fundit! Ose, së shpejti armiq të do t’ju ekzekutojnë, dhe jeni duke e kryer namazin tuaj të fundit! Atëherë, si do ta falni?! A do të ju vijë në mend diçka tjetër përveç namazit?! Shikoni se çfarë u tha i Dërguari i Allahut, a.s., sahabëve, r.a., kur ia kërkuan

këshillë: “Kur të qëndroni në namaz, faleni si të jetë namazi juaj i fundit!”⁶.

8. Jo vetëm namazet, por që njeriu të ndiejë kënaqësi nga të gjitha ibadeten, duhet të jetë i ushqyer me kafshatë hallall

Nuk është e mundur që dikush që fitojë haram dhe të ushqehet me haram, dhe njëkohësisht të ndiejë kënaqësi nga ibadetet.

9. Më e rëndësishmja nga të gjitha është dobësia jonë në besim

Nëse më të vërtetë besojmë në ahiret, edhe qëndrueshmëria në këtë besim do të ishte më tepër drejt edukimit për t’u përkushtuar më mirë në namaz. Zoti ynë, xh.sh., në lidhje me këtë thotë: *“Kërkoni ndihmë (në të gjitha çështjet) me durim dhe me namaz! Kjo vërtet është e madhe (vështirë), (mirëpo jo edhe për ata që kanë frikë (Zotin). Të cilët janë të bindur se do ta takojnë Zotin e tyre, dhe se ata do t’i kthehen Atij.”*. (Bekare, 45-46).

Së fundi, le ta themi këtë: Armiku ynë i hapur, shejtani, nuk do të na lërë sa të jemi gjallë. Edhe nëse e falim këtë namaz me përqendrim dhe frikë të plotë, ai do të vijë te ne një ditë tjetër, dhe do ta shfrytëzojë rastin, duke thënë: “A thua, vallë, do të mundem ta shpërqendroj nga namazi?”. Sepse kjo është një luftë pa paqe. Në këtë luftë herë do të dalim fitimtarë, e herë të mundur. Vetëm nuk duhet asnjëherë t’i dorëzohemi këtij mashtrimit të shejtanit, duke thënë: “Meqë nuk po përqendrohem plotësisht në namaz, nuk do ta fali fare”; “Nuk është e drejtë ta fali namazin kur kam gjëra të tjera në mendjen time”. Kur e themi këtë, ne e humbim luftën. Do të bëjmë gjithçka që mundemi për të pasur frikërespekt në namaz. Po, le të supozojmë se dështuam! A nuk po mund t’i dorëzohemi namazit?! Megjithatë, ne nuk do ta braktisim. Do të jemi të vetëdijshëm për të metat tona, do të pendohemi, mirëpo nuk do ta braktisim namazin! Kush e di, ndoshta ky qëndrim yni do ta zemërojë edhe më shumë shejtanin!

Zoti ynë na bëftë prej njerëzve që kanë frikërespekt, dhe na bëftë prej atyre nga namazet e të cilëve është i kënaqur!

Përktheu dhe përshtati nga gjuha turke: Abide Gërbeshi
Burimi: Revista “Altınoluk” nr. 407 f. 24.

1 Buhari “Ebvabu’salat fi’siyab,13; Muslim, “Mesaxhid” f. 62.

2 Muslim, Mesaxhid, f. 67.

3 Buhari “Vudu”, 52; Muslim, “Salatu’l-musafirin”, f. 222.

4 Gazali, Ihya, I, 151 *në përkthimin shqip, f. 434.

5 Buhari “Ezan”, 4; Muslim “Salat”, f. 19.

6 Musned, transmetimi nr. 23498.

Mediatizimi i fesë apo feja mediale

Festim Rizanaj, PhD

Media është një element i rëndësishëm, që ndikon në jetën e përditshme, praktikat shoqërore dhe marrëdhëniet shoqërore globale me format e ndryshme të saj, nga politika në ekonomi, arti në letërsi, dhe zë vend në qendër të jetës individuale dhe shoqërore. Po ashtu, edhe feja ndikon ndjeshëm në jetën individuale dhe shoqërore, dhe paraqitet si një element i zakonshëm, e që është hasur në të gjitha shoqëritë, që nga kohërat më të hershme.

Për shkak të funksionalitetit të saj dhe strukturës shumëfunksionale, media ka qenë një mjet i rëndësishëm për fetë e ndryshme dhe anëtarët e saj, dhe mjetet mediatike që shërbejnë si një mjet i rëndësishëm në shpërndarjen e informacionit fetar, janë përdorur në mënyrë efektive në transmetimin e mesazheve fetare. Në këtë drejtim, shumë grupe fetare sot median e konsiderojnë si një mundësi. Mirëpo, si riprezentohet feja në media, apo çfarë vendi zë feja në media?

Media është një ndërmjetësues që e lidh prodhuesin e mesazhit me konsumuesin; është ndërmjetësues që i krijon dhe i bashkon masat. Media që e ka të zhvilluar aftësinë e reprezentimit (sipas Dan Laughey reprezentimi është pjesë e realitetit që interpretohet dhe riformulohet. Nuk mjaftohet vetëm në reprezentimin e realitetit, njëkohësisht kontribuon në kuptimin e realitetit¹), përcjelljen e mesazhit e bën në formë zbavitëse, informuese, edukuese e orientuese. Media është e lidhur ngushtë me reprezentimin, dhe për këtë shkak media transmeton një të vërtetë të riprezentuar. Ajo e konsumon gjithë realitetin, dhe e shkrin atë në një reprezentim

të montuar, duke e ndërtuar realitetin përsëri. Prandaj, media është vetë realiteti, realiteti mediatik. Realiteti mediatik, që zë vend në mediet, përfaqësohet nga riprezentimi (ripërfaqësim).

Studiuesi turk Mete Çamdereli thotë se media, për nga struktura e veçantë e funksionimit, është vetë fe (religion) si metaforë. Dhe, ajo e krijon atmosferën e vetë fetare. Media nuk ka nevojë për ndonjë ndërmjetësues apo medium si veten. Rendi i funksionimit të saj është i mjaftueshëm për t'i prodhuar të shenjtat dhe për t'i ndërtuar ritualet e veta. Ashtu siç çdo fe tjetër, ajo kërkon t'i bindemi asaj. Media kërkon xhemat për veten, dhe adhurim për zotërat që i krijon vetë. Për median i vetmi realitet është se çka është feja e medias, dhe jo feja e vërtetë. Realiteti i vetëm për median është feja mediale (metaforë mbi prezantimin, reprezentimin e fesë në media). Feja e vërtetë në media nuk mund shkojë përtej mediatizimit. Pra, shndërrohet në fe që i bindet rregullave të medias, e format e reprezentimit i pranon si të lejueshme, dhe tashmë shndërrohet në fe që mundohet të zërë vend në mesin e ritualeve të medias. Feja e vërtetë propozon jetën më fisnike, njohjen e jetës, të vërtetën e jetës sipas rendit midis Tokës dhe qiellit, në kontrast me fenë mediale, ku feja sekularizohet, zhvillohet dhe profanizohet nga dogmat. Feja e medias, pa dyshim, është një reprezentim i fesë së vërtetë.²

Mediet të gjitha këto kërkesa fetare i bëjnë në hapësirën e tyre riprezentuese, duke e azhurnuar me zhvillimet teknologjike. Kjo hapësirë, e cila aktivizohet përmes predikuesve mediatik, nuk është një

Media është një ndërmjetësues që e lidh prodhuesin e mesazhit me konsumuesin; është ndërmjetësues që i krijon dhe i bashkon masat.



hapësirë e shndërruar nga hapësira reale. Mirëpo është hapësirë e ndryshuar nga media. Prandaj, rregullat e fesë mediale kanë lejuar çdo veprim që në hapësirën e vërtetë fetare nuk praktikohen. Pra, qëndrimi i besimtarëve (edukata e sjelljes), që mbahet në kishë apo xhami, pranë televizionit apo në internet, mund të braktiset; ritualet e fesë së vërtetë, marrëdhëniet ndërmjet xhematit (komunitetit), mund të braktisen. Ndërsa kanalet mediatike prodhojnë besnikëri fetare ndaj vetvetes, ato prodhojnë pabesi ndaj domosdoshmërisë së fesë së vërtetë. Prandaj, krijohet një kod i sjelljes që është i afërt me fenë mediatike por larg fesë së vërtetë. Përderisa në një ligjëratë në një hapësirë të vërtetë fetare edukata nuk lejon që të dëgjohet shtrirë, apo nën përcjelljen e ndonjë kafeje apo çaji, në hapësirën mediatike këto janë të lejuara. Pra, një predikim fetar në kanalet mediatike i lë hapësirë besimtarit që ta ndjekë atë në format që bien ndesh me ato në hapësirën e vërtetë fetare.

Ndjeshmëria e audiencës nuk është e rëndësishme për mediet. E rëndësishme për të është që audiencës t'ia tërheqë vëmendjen, mos të ketë shpëputje, si dhe gjithmonë ta orientojë drejt vetes dhe orientimeve të saj. Çfarëdo që dëgjoni, shikoni apo lexoni, mesazhi kryesor i hapësirës mediale premtan argëtim të vazhdueshëm. Ashtu siç e dinë këtë të gjithë ata që marrin pjesë në medie, edhe predikuesit (ligjëruesit) fetarë mediale e dinë këtë shumë mirë. Prandaj, predikuesit fetar që i drejtohen xhematit nga faltorja e medies, janë predikuesit (pop ligjërues) popullarizues të medieve. Këta ligjërues, të cilët nuk arrijnë në asnjë mënyrë

ta njohin xhematin (xhemat kanë kamerën) janë ligjërues mediatik. Masat e synuara apo xhemati mediatik mund të jenë më shumë në numër sesa ai në hapësirën e vërtetë fetare (xhami, kishë) mirëpo krijimi i lidhjeve me ta është shumë i vështirë. Lidhja me xhematin mediatik është e mundur vetëm nëpërmjet rregullave mediatike (duartrokitje, pamjet vizuale, lojërat me drita, interaktivitet etj.), dhe jo atyre fetare. Duke e rritur atraktivitetin e programeve të tyre, njëkohësisht synohet që audienca mos të kalojë në ndonjë kanal apo faqe tjetër. Sepse xhemati mediatik është aq i pasinqertë, sa kur atraktiviteti i programit (ligjëratës) bie, ai ndërron kanal.

**Lidhja me
xhematin
mediatik është e
mundur vetëm
nëpërmjet
rregullave
mediatike
(duartrokitje,
pamjet vizuale,
lojërat me drita,
interaktivitet
etj.), dhe jo atyre
fetare.**

Hapësira mediale në të cilën jetojnë xhemati mediatik në asnjë formë nuk mund të kthehet në një hapësirë të vërtetë. Dhe, predikimi që bëhet në hapësirën e vërtetë nuk i takon predikimit medial. Prandaj, predikimet mediale përbëhen nga kërkesat dhe imponimet mediale. Edhe pse ligjëratat është e njëjtë, mjeti i përcjelljes e ka ndryshuar dhe e ka shndërruar në një diskurs (ligjërim) të rindërtuar (ristrukturuar), pra, në një diskurs medial. Ligjëruesit mediale, që e strukturojnë këtë diskurs, me kalimin e kohës shndërrohen në ikona që ndiqen me sinqeritet, sepse media ka nevojë për ikona të tilla. Këto ikona fetare të krijuara në medie shpeshherë dalin para mesazhit hyjnor, kur shpeshherë Zoti kalon në plan të dytë. Në fakt, rreziku i vërtetë, sipas Neil Postman, është jo pjesëmarrja e fesë në medie, apo prezantimi i fesë nëpërmjet medieve, por ndërfutja e medieve në përmbajtjen e fesë apo përcaktimin e drejtpërdrejt të përmbajtjes së fesë.³

Mete Çamdereli vlerëson se feja e medieeve nuk është një fe e vërtetë, për shkak të realitetit simulues fetar që prodhon, si dhe pranimin shoqëror që imponon. Pozita e fesë në medie është e zakonshme, sikurse produktet e tjera popullarizuese (futbolli, muzika etj.). Atë që feja e vërtetë nuk e sheh të hijshme (të lejuar), feja mediale e lejon dhe mbijeton po mbi ato lejime. Feja mediatike e popullarizuar është vetëm reprezentim (përfaqësim) i vetes, jo i fesë së vërtetë; kurrë nuk e prezanton Islamin, Krishterimin, Jahudizmin e vërtetë. Feja që riprezentohet në medie nuk është feja e vërtetë, por është një reprezentim i thjeshtë i saj. Sepse mediet, duke e riprezentuar fenë, nëpërmjet programeve dhe kanale të tyre, njëkohësisht e popullarizojnë (pop kulturë) atë. Popullarizimi do të thotë të bëhet e zakonshme, sipërfaqësore, bile-bile të lehtësohet, denigrohet, të kthehet në një hiç. Popullarizimi medial, çdo temë që e merr, çfarëdo qoftë ajo, ia humb vlerën. Feja mediale, për shoqërinë e spektaklit krijon fetar spektakolar, dhe ka nxitur fetarizëm spektakolar.⁴

POZICIONIMI I FESË NË MEDIA

S. Hjarvard deklaroi se mediatizimi ka shndërruar tre aspekte të rëndësishme të fesë. E para është se media është një nga burimet e rëndësishme të informacionit për shumë çështje fetare, dhe komunikimi masiv është bërë edhe prodhues, po edhe shpërndarës i disa përvojave fetare. Në këtë kontekst, media interaktive është një ofrues platforme për shprehjen dhe qarkullimin e besimeve individuale. E dyta është formimi i njohurive dhe i praktikave fetare në përputhje me kërkesat e medieeve, dhe përdorimi i simboleve, i praktikave dhe i besimeve ekzistuese fetare si lëndë e parë e riformulimeve mediale. E treta është se media, si një mjedis kulturor dhe shoqëror, merr shumë funksione kulturore dhe sociale të feve të institucionalizuara, duke ofruar udhëzime shpirtërore dhe morale, si dhe një ndjenjë të bashkësisë dhe të përkatësisë. Përveçqë janë një mjet, mundësitë në zhvillim të medieeve kanë prodhuar edhe shoqëri të reja shoqërore, të cilat janë alternative për mjediset tradicionale të shoqërizimit fetar, dhe i kanë hapur rrugë lindjes së bashkësive fetare të reja (komunitete në internet, grupe lutjesh në internet etj.). Media tani është bërë një mjedis ku praktikat fetare kryhen në terrenin e vet, në vend se të ishte thjesht një mjet.⁵

Funksioni ndërmjetësues i medias e ka bërë atë që ta kryejë funksionin e pasqyrës. Media është reflektuese, sikurse pasqyra, mirëpo nuk është reflektuese e zakonshme dhe natyrale; ajo e transformon atë që e reflekton. Reflektimi i medieeve, i shkurtuar, i rritur, i hiperbolizuar dhe i shtrembëruar, nuk është realiteti, por është një ri-realitet; realiteti medial, realiteti i pasqyrës mediale. Meqë media, për nga natyra e funksionimit po e transformon të vërtetën, duke e deformuar atë dhe çfarëdo teme që e shtjellon, duke e brumosur në realitetin e vet medial, atëherë, si çdo fushë tjetër, edhe feja do të ndikohet nga ajo.

Media, fenë dhe simbolet e saj mundohet t'i pozicionojë jashtë realitet të vet. Pozicionimi medial i fesë në planin politik realizohet në një trajektore politike nga fundamentalizmi në luftë, nga radikalizmi në terrorizëm. Kjo trajektore politike mundëson krijimin e një gjuhe mediale negative mbi fenë. Edhe pse nuk kanë ndonjë lidhje me fenë apo fetarizmin, konceptet e ndryshme si prapambeturi, terror, organizata ilegale, veshje primitive, fanatizëm etj., fetarizohen duke u shoqëruar nga diskursi medial me motive fetare, dhe pozicionohen në rrafshin medial, duke e përmendur përkatësinë fetare të tyre, si dhe paraqiten sikur të ishin fetare.

PËR FUND

Për arsye se media çdo gjë e sipërfaqëson, atëherë edhe temat si shpallja hyjnore, pejgamberët, hadithi, historia islame i shtjellon në trajtë sipërfaqësore. Feja, që në mënyrë sipërfaqësore prezantohet në medie, për shkak se gjithmonë do të kërkojë që të zërë vend në hapësirat mediale, me kalimin e kohës brenda saj nuk do të lërë gjurmë të fesë së vërtetë, por do ta marrë formën e një feje të re, virtuale apo digjitale. Edhe pse në prapavijë ekziston një nijet i sinqertë në këtë nismë, dhe ofron një përmbajtje serioze, hapësira mediale këtë nijet e verbëron, e shkatërron. Sepse gjuha dhe diskursi medial është, mbi të gjitha, qëllimet, dhe të gjitha qëllimet i kthen në natyrën e saj. Sipas Mete Çamdereli, nëse feja kthehet në argëtim, atëherë shumë lehtë edhe argëtimi mund të fetarizohet. Feja e kthyer në argëtim, si përfundim, do të thotë se është kthyer në fenomen kulturor, ose është kthyer në një fe folklorike me prirje popullarizuese.⁶

Media shihet si kërcënim në pikën e tëhuajsimin të praktikave fetare dhe erozionit të dijes fetare, mirëpo nëse dizajnohet duke u fokusuar në qëllimin dhe jo mjetin, mund të kthehet në mundësi të mirë të kuptimit dhe të përhapjes së drejtë të dijeve fetare. Sidoqoftë, feja në kuptim të plotë të fjalës nuk digjitalizohet, por të gjitha ato që kanë të bëjnë me fetarizmin. Pra, feja nuk ndryshon. Fetarizmi, mjetet dhe hapësira e saj po.

1 Dan Laughey, *Key Themes In Media Theory* (UK, Open University Press, 2007).

2 Mete Çamdereli, *Din Ekranda Nasıl Durur? Medyada Dinin Popüler Temsilleri* (Istanbul: Ketebe Yayınları, 2018).

3 Neil Postman, *Amusing Ourselves to Death: Public Discourse in the Age of Show Business* (UK: Penguin Books, 1985).

4 Mete Çamdereli, *Din Ekranda Nasıl Durur? Medyada Dinin Popüler Temsilleri* (Istanbul: Ketebe Yayınları, 2018).

5 Stig Hjarvard, *The mediatization of religion: Theorising religion, media and social change*, Culture and Religion, 2011, f. 119-135.

6 Mete Çamdereli, *Din Ekranda Nasıl Durur? Medyada Dinin Popüler Temsilleri* (Istanbul: Ketebe Yayınları, 2018).

Kimikatet dhe ndikimi i tyre në shëndet

MSc. Njomza Sadriu

REVOLUCIONI KIMIK

Kimia si shkencë ekzakte, së bashku me të gjitha gjërat e mahnitshme që ka sjellë në jetën tonë, ka sjellë edhe disa pikëpyetje dhe frikë, e që përshin një mori keqkuptimesh të zakonshme rreth kimikateve dhe lidhmërisë së tyre me shëndetin e njeriut.

Këtu do të theksojmë përsëri se sa e rëndësishme është doza e një kimikati, për ta kuptuar rrezikun prej tij, si dhe do të diskutojmë për anën negative, e që shpesh vjen nga ndalimi i disa kimikateve.

Gjithashtu do të përmendim si fillim edhe benefitet e kimikateve në jetën tonë. Nga avionët me energji diellore, te farmaceutika, industria kimike vetëm në vitin 2016 ka investuar pothuajse 100 miliardë dollarë në kërkim dhe zhvillim të produkteve të ndryshme si: detergjent, shirit ngjitës, antibiotikë, kimioterapi, plastikë, e që të gjitha këto janë të mundshme për shkak të kimisë.

Pra, nuk duhet të harrojmë se edhe uji është një kimikat, e po ashtu edhe molekulat që e përbëjnë ajrin tonë. Gjithçka është kimike. Prandaj, jo të gjitha kimikatet janë të rrezikshme.

Sipas toksikologjisë tradicionale, doza e një kimikati e krijon helmën. Pra, nëse një kimikat i caktuar merret në dozë më të madhe sesa është e lejuar, ai shkakton helm për organizmin e njeriut.

Shumica e njerëzve nuk e mendojnë ujin si toksik, por gjashtë litra ujë në tri orë mund të jetë qartësisht toksik. Tani, në të djathtë ju shihni një foto të cianidit të natriumit, dhe fjalën “helm” poshtë saj. Një lugë e vetme cianid kaliumi do ta vriste shumicën e njerëzve. Krahasoni dozën që duhet që uji të jetë vdekjeprurës, e që është gjashtë litra, me një dozë për cianidin, që është një lugë gjelle, pra, doza e bën helmën. Gjithashtu, dua të shtoj se cianidi është një kimikat natyral. Ai gjendet në shumë bimë, dhe në fakt është përdorur në luftërat konvencionale dhe në helmimet për mbi dy mijë vjet.

Pra, mesazhi përsëri është ta mbani mend se e natyrshe nuk do të thotë gjithmonë e sigurt. Ajo që ndodh shpesh është se njerëzit nervozohen për një kimikat të vetëm, dhe thonë: “Hiqeni qafe atë!”. Ju ndoshta keni dëgjuar për praninë e pararendësëve të formaldehidit në shampoon për fëmijë. Problemi është se ne shpesh dimë edhe më pak për kimikatet që përdoren për t'i zëvendësuar kimikatet që janë të rrezikshme, dhe mund të zbulojmë se ato kimikate zëvendësuese janë edhe më të rrezikshme sesa kimikati origjinal.

Revolucioni kimik që futi të gjitha llojet e kimikateve të reja në jetën tonë ishte një gjë e mirë; jo të gjitha kimikatet janë të këqija. Shumë prej tyre e kanë ndihmuar njerëzimin, si dhe e kanë përmirësuar jetën dhe shëndetin tonë.

Sipas toksikologjisë tradicionale, doza e një kimikati e krijon helmën. Pra, nëse një kimikat i caktuar merret në dozë më të madhe sesa është e lejuar, ai shkakton helm për organizmin e njeriut.



KIMIKATET NË MJEDISIN TONË:

Çfarë është një kimikat, dhe si jemi të ekspozuar ndaj tyre

Kimia në fakt është shkencë që mund të ndërlikohet në kuptimin e saktë të saj, mirëpo këtu dua të përpiqem ta thjeshtoj dhe të dëshmoj se të gjithë ne përbëhemi nga kimikatat. Trupi ynë është një bimë e vogël kimike, kështu që unë dua të flas vetëm për atë që nënkuptojmë me këtë. Atëherë, është e rëndësishme të kthehemi në fakt në sistemin periodik, sepse ne të gjithë përbëhemi nga elementë që ndodhen aty.

Elementi është vetë atomi, blloqet më themelore të ndërtimit të jetës, të mjedisit tonë dhe të mjedisit sintetik po ashtu (gjëra që ne i prodhojmë). Pra, kimia ka të bëjë me studimin se si këto elemente kombinohen për të krijuar molekula të ndryshme. Atomët kombinohen për të bërë molekula, e molekulat janë kimikate.


Pra, ju jeni njohur me një grup të tërë kimikatesh, dhe disa nga ato kimikate janë shumë të dobishëm, e disa sigurisht se edhe janë shumë të thjeshta, ndërkaq disa nga ato ndoshta mund të kontribuojnë në epideminë e obezitetit. Këtu kam një foto të molekulës së sheqerit, molekulës së ujit, dhe diçka që shpresoj se nuk po e merrni për momentin, amoksisilinë, një antibiotik shumë i zakonshëm.

Në skica mund të shihni se këto molekula, kimikate, mund të jenë shumë të thjeshta, si uji, dy atome hidrogjeni dhe një atom oksigjeni, ose shumë të komplikuar, si amoksisilina. Fjalori i Oksfordit e përcakton kimikatin si një përbërje të substancës që është pastruar ose e përgatitur, veçanërisht artificialisht.

Për shembull, shumë nga ndotësit tanë kimikë të dëmshëm, për fat të keq, prodhohen nga një proces djegieje, duke e djegur qymyrin apo nënproduktet e djegies.

Elementet që kemi ose përbërësit në tymin e cigares janë kimikate shumë të komplikuar, e që në fakt krijohen nga djegia e gjetheve të duhanit dhe e përbërësve të tjerë të cigares. Ndërsa, një banane është një produkt natural dhe, në fakt, është edhe një burim kaliumi. Po, a thu sa prej jush e dinit këtë?!

Kaliumi na nevojitet shumë për ta bërë trupin tonë të funksionojë mirë, duke i rregulluar rrahjet e zemrës, si dhe është një element biogjen thelbësor për jetën. Pastaj, ka elemente më pak thelbësore, e që ndodhen natyrshëm në mjedis, sikurse janë plumbi dhe arseniku, që ndoshta keni dëgjuar shumë për ta. Ata shkaktojnë efekte të dëmshme në sistemin nervor të njeriut.



Ekspozimi ndaj kimikateve paraqitet nëpërmjet një modeli konceptual, e që është një mënyrë për të menduar për rrugët e shumta të ekspozimit përmes ajrit, përmes ujit të pijshëm, ngrënies dhe përmes kontaktit të drejtpërdrejtë që ne mund ta kemi kur ekspozohemi ndaj kimikateve. Ky po që është një proces i gjatë, dhe mjedisi është i gjithi i ndërlidhur. Tani ka shumë ekspozime që ndodhin çdo ditë, e që janë shumë më pak dramatike sesa armët kimike të Luftës së Parë Botërore, si dhe shumë më të zakonshme.

Po ashtu, rezulton se shumica e kanaçeve tona janë të veshura me diçka që synon të na mbrojë nga metalet e dëmshme në kanaçe, po edhe ta rritë jetëgjatësinë, për të na mbrojtur nga mikroorganizmat e dëmshëm që mund të rriten dhe ta prishin ushqimin. Mirëpo, lloji plastik i veshjes së përdorur atje përmban një substancë të quajtur bisphenol A, ose BPA. Dhe, ne jemi shumë të shqetësuar se ky përbërës mund të ketë ndikime negative në shëndet. Pra, ekspozimet janë të komplikuar. Ato mund të jenë lloje të vjetra tradicionale të ekspozimeve, po edhe ekspozimet ndodhin në nivele shumë të ulëta dhe në shumë nga gjërat që bëjmë në jetën tonë të përditshme, qysh nga të ngrënies, tek infermeria e te thithja e ajrit jashtë. Pra, si hyjnë në të vërtetë kimikatat brenda trupit tonë, pasi ato janë në mjedis, për të filluar pastaj ushtrimin e efekteve të tyre, dhe ndoshta të ndikojnë në shëndetin tonë?!

Ne kemi një burim ndotës dhe, pastaj kemi atë që quhet transport mjedisor. Biota janë organizmat e gjallë në ekosistemin për të cilin ne jemi të shqetësuar, sa i përket ndotjes, dhe nga ta ne mund ta kemi thithjen e ndotësve përmes këtyre llojeve të medimeve mjedisore, e që çojnë në ekspozimet që kemi, nëse uji ku ndodhet biota është i kontaminuar. Ajri që thithim, brenda ose jashtë, mund të ketë gjurmë

Fjalori i Oksfordit e përcakton kimikatin si një përbërje të substancës që është pastruar ose e përgatitur, veçanërisht artificialisht.

kimikatesh. Nga ndotja e ujit mund të kemi puse private të kontaminuara. Ne mund të kemi furnizim publik me ujë ose ujë sipërfaqësor. Edhe noti ndonjëherë mund të jetë i rrezikshëm, nëse ka burime kimike afër. Këto janë disa nga pikat e ekspozimit. Thithja përmes ajrit është një rrugë kryesore e ekspozimit. Uji ynë vjen nga burime të ndryshme ujore e sipërfaqësore, dhe nga rezervuarët kryesorë, dhe na dërgohet me tubacione. E, nëse ka një ndotje të një furnizimi publik me ujë, pra, me një kimikat, banorët e qytetit ose banorët që shërbehen nga furnizimi publik me ujë mund të jenë po aq të prekshëm sa ata që shërbehen nga ndonjë pus i kontaminuar.

Prandaj, tri mënyrat kryesore se si i thithim gjërat janë përmes mushkërive, përmes lëkurës sonë, dhe më pas përmes gjellitjes nëpërmjet traktit gastrointestinal. Pra, duke menduar për këtë, lëkura është një pengesë mjaft e mirë, dhe ka disa kompozime ose kimikate që mund të kalojnë dhe kalojnë shumë lehtë përmes lëkurës, mirëpo ajo na ofron një shkallë mbrojtjeje.


Pasi të kemi gjellitur diçka, përballemi me rrezikun që ajo të shpërndahet në të gjithë trupin. Dhe, mund të fillojë duke udhëtuar nëpër gjak, dhe qelizat limfatike që i keni brenda gjakut, si përbërës të gjakut, dhe aty fillon metabolizmi, pra, fillon të prishet ajo që kemi ngrënë. Nëse i merrni gjërat përmes stomakut, mëlçia e fillon punën e saj, dhe fillon t'i detoksifikojë gjërat, ose t'i shkatërrojë gjërat, njësoj si me ushqimin. Dhe, pastaj përzihet me biliare, në mënyrë që ta keni këtë proces të tretjes dhe të prishjes së ushqimit, pastaj ju e keni trupin që ndoshta i ndan gjërat për ruajtje, disa ndotës, si ato Diklorodifeniltriokloretani – DDT, që mund të ruhen në indet yndyrore të trupit.

Pra rrugët kryesore që ndjek kimikati në organizëm janë thithja, shpërndarja, metabolizmi dhe eliminimi.

Plumbi nuk eliminohet shpejt. Ka një gjysmë jetë të gjatë, dhe në fakt ruhet në trup dhe në kocka, dhe për këtë arsye mund të ketë grumbullim afatgjatë. Dhe, për fat të keq, ka një efekt shkatërrues neurologjik, veçanërisht te fëmijët.

Këtu do t'i përmendim po ashtu edhe kimikatet që ndodhen në cigare. Dhe, është e vështirë të besohet se ne ende duhet të flasim për këtë temë, shumë vjet pasi e dimë se kimikatet në cigare janë të dëmshme. Disa nga kimikatet e dëmshme që gjenden në duhan gjenden natyrshëm në bimë. Të tjerët thithen nga toka dhe plehurat. Disa kimikate të rrezikshme formohen kur përpunohet duhani, kur prodhohen cigaret dhe kur cigarja digjet; pra, krijohen kimikate të reja.

Tymi i cigares është një përzierje komplekse e mbi 7000 kimikateve, dhe të paktën 69 prej tyre janë kancerogjene, nga ato që ne i quajmë kanceroze. Shumë nga këto kimikate që i gjejmë në produktet e duhanit gjenden edhe në produktet e konsumit, mirëpo këto produkte kanë etiketa paralajmëruese



mbi to. Ato na paralajmërojnë për rrezikun e helmeve në ato produkte, mirëpo nuk ka një paralajmërim të tillë për toksinat në tymin e duhanit.

Në vazhdim do t'i përmendim tri klasa kimikatesh që mund të gjenden në tymin e duhanit.

Ka kimikate që shkaktojnë kancer. Unë kam thënë se janë të paktën 69 prej tyre, dhe më lejoni të ju tregoj vetëm për disa. Ne kemi Formaldehyd, i cili përdoret për balsamimin e trupave të vdekur. Poloniumi 210 është radioaktiv, dhe është shumë toksik, dhe Vinyl kloride, që përdoret për prodhimin e tubave. Kromi mund të gjendet në çelik. Arseniku përdoret në pesticide. Ne e dimë se plumbi është i dëmshëm, pasi përdoret në bojëra dhe materiale të tjera, pastaj edhe kadmiumi, i cili gjendet në bateri, dhe ka gjithashtu shumë gazra helmues.

Monoksidi i karbonit, për shembull, siç e dini, gjendet në shkarkimet e makinave. Cianidi i hidrogjenit përdoret në armët kimike. Amonia gjendet në pastruesit e shtëpisë. Butani përdoret në lëngjet më të lehta, dhe Tolueni gjendet në tëhollësit e bojës. Dhe, ka mbi 500 aditivë që janë dokumentuar se përmbahen në cigare, e të cilët do t'i përshkruajmë së shpejti.

REFERENCAT

- Chemicals and Health - Megan Latshaw, PhD ('05), MHS ('01)/Johns Hopkins University.
- Chemicals in Our Environment: What Is a Chemical and How Are We Exposed? – Thomas A. Burke, PhD.
- Production, Occupational Health, and Regulation - J. Morel Symons, PhD.
- A Look Into the World of Toxicology - Michael Trush, PhD.
- The CDC's National Biomonitoring Program - Mary Mortenson, PhD.
- Using CDC Data at the State and Local Levels - Ewa King, PhD.
- Analyzing Health Effects - Cliff Mitchell, PhD.
- Risk Assessment in Environmental Decision Making - Keeve Nachmann, PhD.
- Approaches to Chemical Regulation - Richard Denison, PhD.

Shkursorëzimet e shpeshta dhe shkaqet e tyre

Nehat Shehu

Familja është ndër gjërat më të shtrenjta që posedon njeriu. Ajo është qeliza e parë mbi të cilën ndërtohet dhe ngrihet shoqëria. Nëse kjo qelizë është e shëndetshme dhe e ndritur, atëherë edhe shoqëria është e tillë, e nëse dështojmë në këtë aspekt, atëherë të jemi të sigurt se kemi dështuar në bazamentin e shoqërisë, dhe nuk kemi pse të çuditemi nga dështimi i shoqërisë. Prandaj me të drejtë thuhet se familja bazohet në dashuri të pastër, simpati, respekt e mirëkuptim, dhe përderisa funksionon kështu, atëherë pa dyshim se do të jetë vendprehje për shpirtin, stabilitet për ndërgjegjen dhe rehati për zemrën. Këto vlera më së miri manifestohen atëherë kur kemi një raport të shkëlqyer mes çiftit bashkëshortor, martesë e të cilëve është e ndërtuar mbi parimet e dashurisë e mëshirës, harmonisë e bashkëpunimit, durimit, tolerancës e këshillës. E, si e tillë kjo familje do të lulëzojë, dhe jehona e shkëlqimit të saj do të shihet në çdo sferë të jetës, si në punë, në aktivitete, ashtu edhe në shkollë e mësim, sepse si burri, ashtu edhe gruaja, nëse janë të lumtur dhe të qetë në familjen e tyre, do të jenë më produktivë edhe në punë e aktivitete. Po ashtu, edhe fëmijët do ta tregojnë të njëjtin rezultat, nëse rriten e frymojnë në një ambient të ndërtuar me këto parime.

Duke u nisur nga këto fakte, Islami ka bërë familjen ndër gjërat më të shenjta për një njeri, duke i treguar qartë që, nëse dështon në formimin e kësaj fortifikate të shoqërisë, ke dështuar në misionin tënd

jetësor. Dhe është pikërisht kjo fe madhështore që na mësoi çdo gjë rreth ndërtimit të familjes, dhe ndër gjërat e para të cilat na tregoi ishte edhe qëllimi final se, përse Zoti ynë e krijoi bashkudhëtarin e jetës sonë. Lidhur me këtë Allahu, xh.sh., thotë në Kuranin famëlartë: *“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush i krijoi, për ju, bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë.”*¹

Lidhur me këtë ajet dhe thënien e të Plotfuqishmit “dashuri dhe mëshirë” vlen të theksohet edhe një gjë: këtu kemi një karakteristikë shumë të përpiktë lidhur me këtë thënie, e ajo është se, nëse gruaja e mbush shikimin dhe dëgjimin e burrit të saj, ajo i ka arritur qëllimet e martesës. Kjo është dashuri. Po ashtu edhe burri, nëse e mbush shikimin dhe dëgjimin e gruas së tij, atëherë vijmë te një nga argumentet e Allahut, e që tregojnë për madhësinë e Tij, e që është dashuria mes bashkëshortëve. Mirëpo, ndodh që për një arsye apo tjetër burri ta humbë punën, apo nëse sëmuret rënd dhe mbetet në shtrat. Gjithsesi, ky institucion nuk guxon të bjerë, sepse është krijuar të qëndrojë, dhe të qëndrojë me dashuri kur dyja palët i arrijnë qëllimet e tyre, ose do të qëndrojë me mëshirë; pra, dashuria lind kur arrihen qëllimet e martesës, kurse mëshira kur këto qëllime prishen.²

Ndërsa, i dashuri ynë, a.s., lidhur me këtë temë, na informon për hadithe të shumta, e

Me të drejtë thuhet se familja bazohet në dashuri të pastër, simpati, respekt e mirëkuptim, dhe përderisa funksionon kështu, atëherë pa dyshim se do të jetë vendprehje për shpirtin, stabilitet për ndërgjegjen dhe rehati për zemrën.

në njërin ndër ta thotë: “Më i miri prej jush është ai që është më i mirë në shtëpinë e tij (familjen e tij), dhe unë jam më i miri për familjen time.”³.

Ky është realiteti i Islamit dhe mësimet e tij lidhur me familjen. Madje, Islami e ka ruajtur aq shumë familjen, sa edhe shakanë në shkurorëzim e ka llogaritur si seriozitet. Lidhur me këtë, Pejgamberi, a.s., thotë: “Në tri gjëra serioziteti në to është seriozitet, e edhe tallja është seriozitet: martesë, shkurorëzim dhe kthimi i bashkëshortes.”⁴.

Kështu është kujdesi i Islamit dhe mësimet e tij lidhur me familjen. Mirëpo, si erdhëm deri te këto shkurorëzime të shumta, ky është një fakt që duhet studiuar, sado i hidhur që është, pasi Islami ynë është i pastër dhe i jep rëndësi shumë të madhe familjes? Cilat janë motivet që po shtyjnë në rrënimin thuajse çdo ditë të një familjeje?

Në vijim do të mundohemi t’i sjellim disa nga shkaqet që kanë sjellë deri te ky fenomen tashmë i zakonit në shoqërinë e vendit tonë.

1. Dështimi në zgjedhjen e bashkëshortit\es së duhur. Njëri ndër faktorët më të rëndësishëm në ndërtimin e familjes është zgjedhja e bashkëshortes\tit të duhur, dhe se dështimi në këtë pikë na sjell në fenomenin e shkurorëzimeve të shumta. Ky kusht, aq sa

Islami e ka ruajtur aq shumë familjen, sa edhe shakanë në shkurorëzim e ka llogaritur si seriozitet. Lidhur me këtë, Pejgamberi, a.s., thotë: “Në tri gjëra serioziteti në to është seriozitet, e edhe tallja është seriozitet: martesë, shkurorëzim dhe kthimi i bashkëshortes.”

është i rëndësishëm, po aq është edhe delikat, prandaj duhet bërë zgjedhjen e duhur, sepse në rast dështimi, dështojmë edhe në vetë aktin e lidhur. Fatkeqësia jonë sot është që zgjedhja e bashkëshortit bëhet vetëm nga kriteri i bukurisë së jashtme, ose nga pasuria, duke u anashkaluar tërësisht elementet e tjera, sikurse janë: feja, morali, edukata etj. Natyrisht se edhe bukuria dhe pasuria janë gjëra relative, dhe humbin me kalimin e kohës, kurse ato që të shoqërojnë gjithmonë dhe të dhurojnë lumturi janë feja, morali i mirë dhe edukata. E, për përzgjedhjen e bashkëshortes Pejgamberi, a.s., na flet në një hadith shumë të bukur, kur thotë: “Gruaja martohet për katër gjëra: për pasurinë e saj, për prejardhjen e saj, për bukurinë e saj, dhe për fenë e saj; zgjidhe atë që është fetare, dhe do të kesh lumturi!”⁵.

Secili prej nesh mund ta shtrojë pyetjen: Përse vetëm te fetaria është garantuar lumturia bashkëshortore?! Përgjigjja është shumë e qartë: Ngase pasuria, bukuria e pozita, të gjitha këto mund të të braktisin një ditë, mirëpo fetaria, devotshmëria, morali, durimi e urtësia asnjëherë. Prandaj, dashuria e tillë është e çiltër, dhe nëse ndonjëherë ndodh që ndonjëri të bëjë gabime të paqëllimshme, ka mirëkuptim dhe falje mes tyre (gjë që te mungesa e fetarisë është e



rrallë). Kështu që, vendimi për martesë duhet marrë në mënyrë të saktë, dhe jo të nxituar, dhe me të drejtë thuhet se nuk është njerëzi thjesht të martohesh, por ta vazhdosh jetën duke qenë i martuar.

2. Mungesa e durimit ndërmjet bashkëshortëve. Edhe ky shkak mund të themi se luan rol të fuqishëm dhe ka efekt në shkatërrimin e lidhjeve bashkëshortore. Nga gjërat që i dimë të gjithë është edhe fakti se jeta nuk është e lehtë, dhe shpesh goditemi e sprovohemi nga nuk e kemi idenë. Ngarkesat dhe presioni nga vështirësitë e jetës mund të çojnë ndonjëherë deri te të folurit e diçkaje që nuk na përket apo nuk na shkon si bashkëshort e besimtar. Mirëpo, edhe në raste të tilla duhet të kemi mirëkuptim dhe durim ndaj bashkëshortit\tes. Mos të harrojmë se durimi është dritë, dritë e cila na e tregon rrugën e duhur që të dalim nga errësirat e sprovave në dritën e shpërblimit! Çelësat e një marrëdhënieje të shëndetshme janë mirëkuptimi dhe durimi i ndërsjellë. Fundja, çdonjëri prej nesh jemi njerëz dhe gabojmë, prandaj falja dhe durimi ndaj më të dashurve është vlere e tyre më e çmuar. Për më tepër, asnjëherë nuk duhet harruar se shpërblimi i durimtarëve nuk mund të llogaritet, siç na informon Allahu, xh.sh., në librin e Tij fisnik, kur thotë “*Vetëm ata që do të jenë të durueshëm do të shpërblehen pa masë.*”⁶. Pra, çdo lloj shpërblimi që mund ta paramendosh ti, shpërblimi i Allahut di të jetë akoma më i madh. Dhe, a nuk është gjëja më e bukur që në atë Xhenet që e ke ëndërruar në këtë botë të hysh dorë më dorë me bashkëshortin\ten tënde?! Sigurisht që po, prandaj duhet fuqizuar këtë pjesë, në mënyrë që mos të vijmë në një ndarje e shkatërrim të familjes.

3. Neglizhenca e njërit apo e tjetrit bashkëshort. Nga shkaqet më të rëndësishme të shkurorezimeve të shumta mund të themi se është edhe neglizhenca që mund të bëhet nga njëri apo të dy bashkëshortët. Një gjë duhet ditur dhe duhet pasur frikë: neglizhenca e bashkëshortit\es në fenë tonë të pastër është gjë e ndaluar. Pra, kurrë nuk do të jesh burrë i mirë nëse e neglizhon gruan tënde, dhe kurrë nuk do jesh grua e mirë nëse e neglizhon burrin tënd. Dhe, është e vërtetë e pamohueshme se nuk ka njeri më të përsosur sesa Pejgamberi, a.s., dhe se ky Pejgamber është shembulli ynë më i mirë, siç na tregoi edhe Zoti në Kuran. E, nëse i qasemi vetëm pak literaturës do të gjejmë se ky shembull ishte më i miri sa i përket angazhimit në familjen e tij, prandaj edhe na

Në Islam, në asnjë mënyrë dhe në asnjë rrethanë nuk lejohet zbulimi i sekreteve ndërbashkëshortore. Zbulimi i tyre është mëkat i madh. Ai që e bën këtë veprim, ka humbur, dhe nuk e ka xhelozinë për nderin e tij.

tha, në hadithin e tij të njohur: “Më i miri prej jush është ai që është më i mirë me gruan (familjen e tij), dhe unë jam ai që sillem më së miri me familjen time.”⁷.

Prandaj, edhe Pejgamberi a.s., që kishte kujdes në këtë pikë, dhe ai kalonte kohë me bashkëshortet e veta. Ai luante e garonte me to, argëtohej dhe u falte atyre përkëdhelje të butë, buzëqeshje të ngrohtë, e edhe më shumë se kaq. Aisheja, r.a., transmeton se bashkëshorti i saj luante shpeshherë me të, thjeshtë për t’ia bërë qejfin asaj. Madje, edhe Omeri, r.a., thoshte: “Burri duhet të jetë në familjen e tij si një fëmijë.” Kjo do të thotë në njerëzi dhe butësi, kurse me njerëzit e tjerë le të jetë tamam burrë. Ndërsa, sot e vërejmë se shumë prej burrave forcën dhe “burrërinë” e tyre e shprehin në shtëpi, ndërsa kur të dalin jashtë shtëpisë, janë të kuptueshëm, zemërbutë, fjalëmbël e të shoqërueshëm!⁸

Prandaj, është më se e nevojshme që të marrim nga shembulli i Pejgamberit, a.s., burrit më të mirë, dhe ta lëmë sot e përgjithmonë “burrërinë” e kamufluar, e cila i rrënon lidhjet bashkëshortore.

4. Zbulimi i sekreteve bashkëshortore. Pra, edhe ky është një ndër shkaqet e rëndësishme në përhapjen e shkurorezimeve. Në Islam, le ta dimë që në asnjë mënyrë dhe në asnjë rrethanë nuk lejohet zbulimi i sekreteve ndërbashkëshortore. Zbulimi i

tyre është mëkat i madh. Ai që e bën këtë veprim, ka humbur, dhe nuk e ka xhelozinë për nderin e tij. Detajet dhe sekretet e jetës bashkëshortore duhet t’i dijë vetëm Allahu i Madhëruar, e jo bota mbarë. Sot gjejmë se shumë gra, pa ndonjë kompleks, i tregojnë sekretet e burrave të tyre në takime apo tubime të llojeve të ndryshme, dhe po ashtu kemi edhe burra që nuk ngurrojnë t’i përhapin e zbulojnë sekretet e grave të tyre para shoqërisë. Kështu tek ne edhe po fundosen virtytet. Përderisa jemi në këtë pikë, vlen të përmendet edhe një fakt interesant: kur Allahu, xh.sh., na ka ndaluar t’i zbulojmë të metat e njerëzve në përgjithësi, çfarë mendoni se do të jetë qëndrimi i Tij në rastin e përhapjes së sekreteve bashkëshortore?! Besoj se përgjigjen e di secili, dhe nuk është fare nevoja ta deklarojmë!

5. Ndërhyrja e familjes, fqinjëve dhe miqve në jetën bashkëshortore. Edhe ky shkak ka efekt në plasaritjet e lidhjeve bashkëshortore, e të cilat pastaj po çojnë deri te ndarja mes çifteve. Mirëpo, vlen të theksohet se një burrë i arsyeshëm dhe një grua e arsyeshme nuk lejojnë që çështjet apo mospajtimet e tyre të zhvendosen jashtë shtëpisë së tyre,



qoftë te familja e gjerë, fqinjët, apo edhe te rrethi i miqve. Pa mendoni pak më gjatë për ajetin *“(e nëse keni mospajtime) Madje largoheni nga shtrati (mos flini në një shtrat me bashkëshortet tua)!⁹”*.

Allahu me këtë porosi ka synuar që mospajtimi të mbetet mes bashkëshortëve, madje këtë mundësisht mos ta dinë as fëmijët. Kjo ngase, nëse në problemet e bashkëshortëve ndërhyjnë nëna, babai, fëmijët, fqinjët etj., gjërat vetëm se do të përkeqësohen. Qëllimi i kësaj është që askush në shtëpi mos ta dijë këtë.¹⁰ Mos ta harrojmë faktin se njeriu ndikohet nga fjalët e tjerëve, edhe nëse janë jo të sakta, prandaj duhet që mosmarrëveshjet të rregullohen brenda çerdhes së bashkëshortësisë. Për më tepër, askush nuk i di problemet dhe zgjidhjen e tyre më mirë sesa ata vetë. A nuk jemi dëshmitarë se shpesh ndarja vjen edhe si rezultat edhe i një fjale që dikush e fut si thikë në mes të bashkëshortëve?! Ta zëmë se, kur dikush i thotë gruas se çfarë të bleu burri për festën e fundit, cila është dhurata e tij e fundit që ta ka dhuruar, e të ngjashme, gruaja vihet në siklet, dhe ndoshta ndikohet nga ato fjalë, dhe kështu ngjallet dilema në kokën e saj, për sinqeritetin e lidhjes së saj me burrin. Megjithatë një gjë duhet ditur gjithmonë, e ajo është se besimtari/rja e vërtetë gjithmonë mbështetet tek Allahu, dhe nuk tundohet nga fjalët dashakeqe të tjerëve. Prandaj, ndërhyrja mes çiftit bashkëshortor dhe tendosja e raporteve mes tyre është mëkat i madh.

6. Tradhtia bashkëshortore. Ndonëse është theksuar në fund, është shumë me rëndësi. Pra, tradhtia e burrit/gruas ka rol të madh në përfundimin e martesës. Vlen të theksohet se kjo pikë këtu është produkt direkt i shkakut të parë (dështimit në zgjedhjen e bashkëshortit/es së duhur). Kështu, rëndom gabimi apo ngutja në përzgjedhjen e bashkëshortit-tes edhe mund ta sjellë këtë rezultat. Kur një burrë e ka martuar një grua thjesht duke pasur si kriter bukurinë apo pasurinë e tij/saj, natyrisht se lidhja e tillë do të jetë e rrezikuar dhe

jetëshkurtër. Ajo grua që nuk është e stolisur me virtytin e ndershmërisë, mund ta tradhtojë burrin dhe, ai burrë që nuk e posedon fisnikërinë morale, mund ta tradhtojë gruan. Secili prej tyre, në momentin që gjen dikë më të bukur apo më të pasur, ai/ajo do ta fillojë lidhjen me të, e duke tradhtuar prapenjë bashkëshortësinë. Për këtë realitet të hidhur të gjithë jemi dëshmitarë, sidomos te gjeneratat e reja. E, për ta mënjanuar mundësinë e tradhtisë, ndër të tjerash, këshillohemi që të kujdesemi për shikimin e ndaluar; të shmangët vetmimi i burrit me gruan e huaj dhe i gruas me burrin e huaj, pa prezencën e një pale të tretë, si dhe të ndalohen provokimet pasionante nga cilado palë qofshin ato. Nëse kujdesemi dhe i respektojmë normat islame që i rregullojnë raportet ndërmjet dy personave të huaj (një burri dhe një gruaje të huaj), natyrisht se edhe dera e tradhtisë bashkëshortore do të qëndrojë e mbyllur.

Këto ishin disa nga shkaqet që çojnë deri te shkurorëzimet, kështu që, nëse duam ta ruajmë familjen me çdo kusht, atëherë le të kthehemi te mësimet hyjnore të Zotit tonë, dhe të inspirohemi nga jeta fisnike e të dashurit të Zotit-Muhamedit, s.a.v.s., sepse kjo është garancia që divorcet të pakësohet e lidhjet tona bashkëshortore të ruhen e të kultivohen! Familja është motivimi ynë i dynjasë dhe shpresa jonë e Ahiretit. Ajo është celula më e fortë dhe themeli i shoqërisë. Nëse ajo është e shëndoshë, edhe shoqëria do të jetë e shëndoshë.

1 Surja Err Rrum, ajeti i 21-të, Përkthimi i Hasan Nahit.

2 Muhammed Ratib Nabulsi, Të drejtat e bashkëshortëve, f. 7.

3 Tirmidhiu, Sunnen Et Tirmidhi, 3895.

4 Tirmidhiu, Sunnen Et Tirmidhi, 1184.

5 Muhammed bin Ismail El Buhari, Sahih El Buhari, 5090. Muslim bin El Haxhaxh, Sahih Muslim, 1424.

6 Surja Ez Zumer ajeti i 10-të, Përkthimi i Hasan Nahit.

7 Përmendur më herët.

8 Muhammed Ratib Nabulsi, Shtëpia e lumtur f. 71.

9 Surja En Nisa ajeti i 34-të, Përkthimi i Hasan Nahit.

10 Muhammed Ratib Nabulsi, Familja Myslimane, f. 158.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore si kusht për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave në familje

(Trajtesë krahasuese edhe me të drejtën familjare islame)

Argjent Xheladini

HYRJE

Vonesat e mëdha dhe mangësitë procedurale në përmbartimin/ekzekutimin e aktgjykimeve civile në Kosovë e dëmtojnë të drejtën për gjykim korrekt brenda kohës së arsyeshme dhe e komprometojnë sundimin e ligjit. Thomas Hammarberg, komisionari për të Drejta të Njeriut pranë Këshillit të Evropës, në vitin 2009 kishte thënë se “ekzekutimi i mangët i vendimeve përfundimtare gjyqësore duhet të shihet si refuzim për ta pranuar sundimin e ligjit, dhe është një problem serioz për të drejtat e njeriut”.

E drejta për përmbartim të aktgjykimit është një pjesë integruese e së drejtës për gjykim të drejtë brenda kohës së arsyeshme. Ky punim shqyrton kornizën ligjore në Kosovë, të zbatueshme për përmbartimin e aktgjykimeve civile. Punimi po ashtu shqyrton problematikën mbi procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në fushën e së drejtës familjare.

1. LEGJISLACIONI CIVIL

Procedurat përmbartimore civile në Kosovë rregullohen përmes Ligjit për Procedurën Përmbartimore.¹ Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës gjykatat dhe përmbartuesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbartimin në bazë të dokumenteve përmbartues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbartimin e vendimit të marrë në procedurën administrative dhe për kundërvajtje, me të

cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbartimin e tillë me ligj është paraparë kompetenca e organit tjetër.²

Ligji për Procedurën Përmbartimore ka përcaktuar se procedurën e përmbartimit në shkallë të parë e udhëheq dhe e vendos përmbartuesi privat, ndërsa përjashtimisht gjyqtari individual, kur me këtë ligj është caktuar se përmbartimin e cakton dhe e zbaton Gjykata (organi i shkallës së parë). Organi përmbartues vendos për propozimin e përmbartimit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh pas pranimit të propozimit.³ Gjykata është kompetente të vendosë në procedurën e përmbartimit dhe ta zbatojë përmbartimin e vendimeve gjyqësore lidhur me: të gjitha çështjet nga e drejta familjare dhe kthimin e punëtorëve dhe të shërbyesve civilë në punë dhe kompensimet e tjera.⁴

2. PROBLEMATIKA MBI PROCESIN E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE NË FUSHËN E SË DREJTËS FAMILJARE

Ligji për Familjen i Kosovës ka përcaktuar se, së bashku me propozimin për shkurorezim me marrëveshje të dyanshme, bashkëshortët janë të detyruar ta parashtrajnë marrëveshjen me shkrim për përkujdesje, edukim dhe ushqim të fëmijëve të tyre të përbashkët, si dhe propozimin me shkrim mbi atë se si kontaktet personale mes fëmijës dhe të dy prindërve do të garantohen në të ardhmen.⁵

Në të Drejtën Familjare Islame, fjala “hul’u”, nënkupton mohimin e së drejtës për

Ligji për Familjen i Kosovës ka përcaktuar se bashkëshortët janë të detyruar ta parashtrajnë marrëveshjen me shkrim për përkujdesje, edukim dhe ushqim të fëmijëve të tyre të përbashkët, si dhe propozimin me shkrim mbi atë se si kontaktet personale mes fëmijës dhe të dy prindërve do të garantohen në të ardhmen.

jetë bashkëshortore, që varet nga pranimi i gruas.⁶ Pra, nëse bashkëshortët vendosin të shkurojëzohen me marrëveshje, atëherë duhet të jetë edhe pajtimi i gruas për shkurojëzim.

Gjithashtu, Ligji i Kosovës për Familjen, ka paraparë se në procedurën e pajtimit të bashkëshortëve, Organi i Kujdestarisë konstaton se në çfarë kushtesh për jetë dhe zhvillim ndodhen fëmijët e përbashkët të bashkëshortëve, dhe i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që ta sigurojë edukimin, sigurinë dhe mbajtjen financiare, duke u përpjekur që të arrijë marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve, në mënyrë që të mbrohen interesat e fëmijëve.⁷ Ligji për Familjen ka paraparë se prindërit janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijët e tyre të mitur. Nëse fëmija nuk e ka përfunduar shkollimin deri në moshën madhore, prindërit kanë detyrim ta ofrojnë mbështetjen e nevojshme, për ta siguruar shkollimin, respektivisht edukimin në fakultet, deri kur fëmija ta arrijë moshën 26 vjeçare.⁸

E Drejta Familjare Islame ka përcaktuar se prindi që e rrit fëmijën ka të drejtë kompensimi për rritjen, gjidhënien dhe alimentacionin. Kjo është theksuar në fjalën e Allahut, xh.sh.: *Ato (gratë e lëshuara), sipas mundësisë suaj i vendosni në ndonjë vend ku banoni ju, e mos i ngushtoni ato për t'i detyruar (të dalin). Në qoftë se ato janë shtatzëna, atëherë furnizoni ato derisa ta heqin barrën e tyre, e nëse ato u japin gji fëmijëve tuaj, atëherë jepuani atyre shpërblimin që u takon dhe kini mirëkuptim në mes jush ashtu si duhet, e në qoftë se hasni në vështirësi ndër vete, atëherë le të kërkojë për të gjidhënese tjetër. Ai që është i pasur, le të shpenzojë sipas mundësisë së vet, e ai që është ngusht nga pasuria, le të japë nga ajo që i ka dhënë Allahu, e Allahu nuk ngarkon askë, vetëm aq sa i ka dhënë; mirëpo pas vështirësisë Allahu sjell çlirim (begati).*⁹

Praktika gjyqësore e viteve të fundit ka evidentuar raste vendimesh gjyqësore të cilat deri diku nuk i përgjigjen

maksimalisht interesit më të lartë të të miturit. Kjo sidomos në rastet e divorceve, kur fëmija ose fëmijët i lihen për rritje dhe edukim njërit ose të dy prindërve, e disa herë shihen më tepër interesat e prindërve sesa të fëmijëve, ose në rastet e detyrimit ushqimor, kur shpeshherë fëmijët nuk e marrin shumën e nevojshme për edukimin, arsimimin, dhe mirërritjen e tyre. Në Ligjin e Familjes përcaktohet se mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe përgjegjësia e të dy prindërve për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre është e barabartë, e që për fëmijë nënkupton personin nën moshën 18 vjeçare.¹⁰

Ndërkohë, të metat e vëna re nga pushteti gjyqësor kanë të bëjnë pikërisht me respektimin e parimit “interesi më i lartë i fëmijës”:

detyrimi ushqimor që akordon gjykata në përgjithësi nuk është i mjaftueshëm për ta siguruar rritjen dhe edukimin e fëmijës, posaçërisht në këtë kohë. Në pjesën më të madhe të rasteve vendimet e gjykatës nuk japin argumentet e nevojshme për ta justifikuar përcaktimin e masës së pensionit ushqimor. Në raste të tjera ka vështirësi të provohen të ardhurat që siguron prindi, i cili nuk e ka fëmijën në ngarkim, por që duhet të paguajë detyrimin për ushqim. Kjo ndodh për faktin se një numër i konsiderueshëm personash nuk e regjistrojnë aktivitetin e tyre sipas kërkesave të ligjit, ose nuk kanë lidhur kontratë për punën që kryejnë. Sigurisht se kjo bie ndesh me interesat e të miturit, për t’iu siguruar një nivel jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

Gjykatat, ka raste që, në një pjesë të vendimeve të tyre nuk shprehen fare për detyrimin për ushqim, ndërkohë që në Ligjin e Familjes ky është një detyrim që duhet të zgjidhet nga gjykata. Gjithashtu, në një numër vendimesh gjyqësore gjykata nuk shprehet për kështet, format dhe mënyrat se si do



të realizohet pagesa e këtij detyrimi ushqimor nga ana e prindit debitor.

Në të Drejtën Familjare Islame, nëse e analizojmë praktikën, atëherë mund ta vëmë në theks këtë praktikë, sidomos kur gjykatësi vendos që burri të obligohet ta mbajë më dobët familjen e vet, e pastaj ai të bëhet i pasur, dhe gruaja ankohet për këtë; atëherë gjykatësi do të vendosë në favor të saj, dhe burri duhet të shpenzojë më shumë për përkujdesjen ndaj familjes.¹¹

Nëse do të studiohej praktika jonë gjyqësore konkrete e këtyre viteve të fundit, rezulton se ka raste kur prindi ushtron veprimtari private, por nuk i paguan tatimet dhe nuk e deklaron këtë aktivitet. Gjykata, në rastet kur nuk e ka dokumentacionin e duhur, nuk vendos mbi bazën se ku do ta mbështetë detyrimin financiar, pasi nuk ka mundësi ta vërtetojë një burim financiar të palës që do ta paguajë detyrimin konkret. Gjithashtu, një tjetër problem i hasur gjatë analizës së praktikës gjyqësore rezulton edhe emigrimi i shumë prindërve (kryesisht burra), të cilët duke qenë larg, e kanë zgjidhur martesën dhe nuk paguajnë për detyrimin ushqimor. Në këto raste gjykata nuk mund t'i njohë burimet financiare reale të tyre (për shkak edhe të mosparaqitjes së tyre në procesin gjyqësor), dhe përgjithësisht vendos një shumë mbi bazën e pagesës që jepet në rastet e papunësisë. Këto vendime mbeten të pazbatuara, sepse prindi debitor nuk merr pagesë papunësie, pasi është larguar dhe nuk i plotëson kushtet e ligjit për ta përfutur atë; në raste të tjera vendimi gjyqësor nuk bëhet i zbatueshëm, pasi organet kompetente të shteteve ku kanë emigruar nuk i njohin vendimet e gjykatave; ose shtetasit emigrantë në këto vende nuk janë të regjistruar ligjërisht si punëkërkues apo punëtorë pranë institucioneve kompetente, dhe punojnë në të zezë; apo për shkak të mungesës së bashkëpunimit dhe të ndërveprimit ndërkombëtar midis autoriteteve kompetente vendase dhe atyre ndërkombëtare, për ta bërë të mundur realizimin e ekzekutimit të detyrimit ushqimor në favor të fëmijëve apo të pjesëtarëve të tjerë të familjes.

Kjo ndikon në mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, duke çuar në mosrealizim të së drejtës ligjore të palës së interesuar. Ky mosekzekutim brenda një afati të arsyeshëm i titujve ekzekutivë vjen si rezultat i pengesave të natyrës legjislative dhe praktike, si dhe mosrespektimit nga ana e autoriteteve të ngarkuara me ligj të akteve ligjore dhe nënligjore, e që e rregullojnë mënyrën e përmbushjes së detyrimeve të rrjedha nga vendimet gjyqësore për organet e administratës shtetërore dhe entet publike.

Sipas të Drejtës Familjare Islame, babai është i obliguar të kujdeset për furnizimin dhe veshmbathjen e fëmijëve të moshës jomadhore, në bazë të ajetit kuranor: "I ati i fëmijës është i obliguar për furnizimin dhe veshmbathjen e tyre, ashtu siç është rregull."¹²

Ligji për Familjen ka përcaktuar se me rastin e zbatimit të përmbarimit të dhunshëm gjykata kujdeset për karakterin e ngutshëm të procedurës dhe për nevojën që në masën maksimale të mbrohet personaliteti i fëmijës. Gjykata, pasi t'i çmojë të gjitha rrethanat e rastit, vendos se, a thua përmbarimi do të zbatohet me caktimin e gjobave kundër personit tek i cili ndodhet fëmija, ose me marrjen e fëmijës prej atij personi. Nëse qëllimi i përmbarimit nuk mund të arrihet me caktimin e vendimit për gjobat, përmbarimi do të zbatohet me marrjen e fëmijës prej personit tek i cili ndodhet fëmija dhe me dorëzimin e fëmijës te prindi, përkatësisht personi tjetër, e të cilit i është besuar fëmija, dhe me dorëzimin e fëmijës prindit, përkatësisht personit tjetër, të cilit edhe i është besuar ai për ruajtje dhe edukim. Në procedurën e përmbarimit gjykata do ta kërkojë ndihmën e organit të kujdestarisë.¹³

PËRFUNDIM

Përmbarimi/ekzekutimi i aktgjyqësorëve gjyqësorë civilë është një pjesë integrale e së drejtës fundamentale të njeriut për gjykim të drejtë brenda kohës së arsyeshme. Kur, siç është rasti sot në Kosovë, aktgjykimet civilë nuk përmbarohen brenda kohës së arsyeshme, shkelet e drejta për gjykim të drejtë dhe komprometohet sundimi i ligjit. Vonesat e mëdha në përmbarimin e aktgjyqësorëve civilë shkaktojnë rritje të numrit të këtyre lëndëve.

Detyrimi ushqimor gjatë proceseve gjyqësore, e të cilat mund të zgjasin edhe për një afat të paarsyeshëm, nuk zbatohet. Procedurat për marrjen e shërbimeve përmbarimore janë me afate të gjata kohore, dhe ka raste të jenë edhe joefikase. Strukturat e qeverisjes vendore janë ende të papërfshira në këtë çështje, dhe të paangazhuara në identifikimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve që janë përfutur të pensionit ushqimor në përgjithësi, ose kur prindi debitor ndodhet jashtë vendit. Ne rekomandojmë që në praktikën gjyqësore të zbatohen në përpikëri Ligji për Familjen dhe Ligji për Procedurën Përmbarimore.

1 Ligji Nr. 04/L-139, për Procedurën Përmbarimore i Kosovës.

2 Ligji Nr. 04/L-139, për Procedurën Përmbarimore i Kosovës, neni 1 parag. 1 dhe 2.

3 Ligji Nr. 04/L-139, për Procedurën Përmbarimore i Kosovës, neni 3.

4 Ligji Nr. 04/L-139, për Procedurën Përmbarimore i Kosovës, neni 5 parag. 6.

5 Ligji Nr. 2004/32, për Familjen i Kosovës, neni 70 parag. 2.

6 Abdulhamid Mahmud Tuhmaz, Fikhu Hanefi, E drejta familjare, vëll.II, Zurich, 2021, f. 317.

7 Ligji Nr. 2004/32, për Familjen i Kosovës, neni 82.

8 Ligji Nr. 2004/32, për Familjen i Kosovës, neni 290.

9 Kuran, Talak, 6-7.

10 Ligji Nr. 2004/32, për Familjen i Kosovës, neni 3 parag. 2.

11 Abdulhamid Mahmud Tuhmaz, vep. e cit., f. 338.

12 Kuran, El Bekare, 233.

13 Ligji Nr. 2004/32, për Familjen i Kosovës, neni 352.

Sfidat e edukimit të brezave në kohën e internetit

Dr. Azmir Jusufi

Çdo kohë i ka karakteristikat e veta dalluese, të cilat në mënyrë të pashmangshme lënë gjurmë në jetën e njerëzve të asaj kohe. Rrjeti botëror i të dhënave - interneti, shënoi në masë të madhe kohën tonë. Sot, në botë, sipas të dhënave statistikore, internetin e përdorin më se 3.8 miliardë njerëz dhe se ky numër, nga dita në ditë, vazhdimisht është në rritje. Ky rrjet i ofron njerëzimit shërbime të mëdha, por, në të njëjtën kohë në prapavijën e vetë fsheh edhe shumë rreziqe.

PRAPAVIJA E INTERNETIT

Përmes përdorimit të internetit ne i përcjellim ndodhitë në tërë botën, njihemi me kultura dhe zakone të largëta e të huaja; mund të përcillen kërkimet shkencore dhe të arriturat; mund të konsultohen ekspertë nga fusha të ndryshme; të realizohen shërbimet bankare, etj..

Këto janë vetëm disa nga shërbimet e shumta që i ofron interneti dhe të gjithë ne, çdo ditë, pak a shumë, i përdorim. Sigurisht, ekziston edhe ana tjetër e medaljes, sepse ky rrjet mbart edhe shumë rreziqe dhe aspekte negative: interneti është një mjet ideal për përhapjen dhe promovimin e ideve të gabuara e të gjitha ngjyrave dhe llojeve. Nëpërmjet këtij rrjeti futen dyshime në fe, duke u promovuar ideologjitë sektare të devijuara, publikisht dhe haptazi ftohet në imoralitet dhe shumë devijimeve të cilat janë në kundërshtim me fenë, moralin dhe natyrën e shëndoshë njerëzore. E gjithë kjo plasohet në një mënyrë perfide, që magjeps, josh dhe helmon fëmijët, adoleshentët, madje edhe të rriturit, shkatërron dëlirësinë, çon në rrugë djallëzore dhe inkurajon një shumëllojshmëri të sëmundjeve dhe perversioneve. Interneti përdoret për qëllime të abuzimit seksual, kërcënime dhe

Sot, në botë, sipas të dhënave statistikore, internetin e përdorin më se 3.8 miliardë njerëz dhe se ky numër, nga dita në ditë, vazhdimisht është në rritje. Ky rrjet i ofron njerëzimit shërbime të mëdha, por, në të njëjtën kohë në prapavijën e vetë fsheh edhe shumë rreziqe.



shantazhe, sidomos në mesin e të rinjve dhe adoleshentëve. Interneti dhe rrjetet sociale mundësojnë përhapjen e thashethemeve dhe trillimeve, si dhe cenohet privatesia dhe intimja përmes spiunimit. Po ashtu, interneti është përgjegjës për shfaqjen e sëmundjeve të reja moderne: varësisë nga interneti, e cila shkakton sëmundjet mendore dhe fizike si dhe rezultojnë neglizhencën e jetës reale dhe problemeve në familje e shoqëri.

Me të gjitha dobiet që ofron interneti dhe rreziqet që sjell ai, është e qartë se interneti është testi i imanit dhe moralit të njeriut. Portat e të mirës dhe të keqes janë të hapura gjerë. Për shkak të këtij realiteti, njeriu i kuptueshëm që kujdeset për fenë e tij, do të ndalet para këtij fenomeni dhe të shqyrtojë veprimet e veta.

Në mënyrë që interneti të përdoret në mënyrë të drejtë, dhe për t'u mbrojtur nga rreziqet që ai sjell me vete, është e domosdoshme që aktivitetet në internet të harmonizohen me parimet e Islamit.

HUMBJA E KOHËS DHE INTERNETI

Prej rreziqeve dhe aspekteve negative të internetit është se ai është shkaktari kryesor i humbjes së kohës dhe neglizhencës së disa obligimeve fetare, të tilla si namazi, etj.. Zoti xh.sh. u betua në kohën se njeriu është i humbur dhe i dëshpëruar, kushdo qoftë ai, përveç atij që kohën e vet e shfrytëzon për gjëra të mira e të dobishme. Që moti është thënë nëse nuk e shfrytëzojmë kohën, atëherë ajo do të na shfrytëzon ne, ose “do të na shtrydhë”, siç e përkthen konceptin “Asr” gjatë komentimit të sures El Asr, përkthyesi i Kuranin në gjuhën boshnjake, akademiku Enes Kariq.¹

Koha është ajo që uli popujt, të cilët dukeshin se janë të lartë dhe ngriti lart popujt tjerë që dukeshin se kanë qenë të ulët. Koha na tregon se e bëri krenar të drejtin dhe e poshtëroi të padrejtin e zullumqarin. Koha na mësoi që, kur një popull kaloi në padrejtësi, u dha pas dëshirave epshore, pas interesit personal duke e lënë pas dore bashkësinë dhe interesin e përgjithshëm.²

Kështu koha është e pakthyeshme, siç thotë El Me'arri: “E djeshmja që shkoi - edhe pse është afër, të gjithë banorët e Tokës nuk mund ta kthejnë atë!”³

Çdo çast, i cili nuk shfrytëzohet në vepra të mira, është i humbur. Këto fjalë të lartësuar, pasi që treguan qartë, na e

**Para se të ndash
ndonjë lajm,
verifiko nëse ai
është i dobishëm
për të përhapur
apo jo. Nëse me
të pohohen
vlerat pozitive,
moralit fisnik,
inkurajon për të
mirë dhe tregon
për të keqen,
promovon
njohuri të
dobishme, etj.,
transmetoje atë,
por, në qoftë se
është e gjithë e
kundërta, mos ji
pjesëmarrës në
përhapjen e tij.**

tërheqin vëmendjen tonë në historinë, si dëshmitar të veprave njerëzore.⁴

Në Perëndim thonë: “Koha është para”, kurse në Lindje thonë që ajo është më e çmuar se paraja dhe thonë: “Koha nuk mund të blihet as me margaritar.”⁵ Po, kjo është me të vërtetë ashtu, megjithatë, koha është shumë më shumë se kaq.

Ah, sikur njerëzit të dinin rëndësinë e kohës! Aspak nuk është i habitshëm fakti që një njeri e kishte zotëruar një gjuhë të huaj vetëm duke mësuar gjatë pauzës në vendin e tij të punës, ose njeriu tjetër, duke prituri porosinë e tij në restorant në një kohë prej 10-15 minutash. Mirëpo, sot secili që ulet në tavolinë duke prituri porosinë e vet në restorant, mund të vërejmë se menjëherë pyet për fjalëkalimin e internetit, ose futet menjëherë në internet duke humbur kohën kot.

Nuk duhet të lejojmë që gjërat që sjellin dobi të na ikin prej dore, e të jemi prej atyre (Zoti na ruajt!) që do të thonë: “Zoti ynë, tash pamë dhe dëgjuam, na kthe pra edhe një herë e të bëjmë vepra të mira, se tash jemi bindur.” (Es Sexhde, 12). Muhamedi a.s., në hadithet e tij na këshillon për shfrytëzimin e kohës, duke thënë: “Shfrytëzoni pesë gjëra para pesë të tjerave: rininë para pleqërisë, jetën para vdekjes, shëndetin para sëmundjes, pasurinë para varfërisë dhe kohën e lirë para zënies së saj.” (El Hakimi). Po ashtu, transmetohet nga Muadh b. Xhebeli r.a., se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Nuk do të lëviz këmba e robit në

Ditën e Gjykimit derisa të pyetet për katër gjëra: jetën - në çka e ka shpenzuar, rininë - se si e ka kaluar, parën - se si e ka fituar dhe shpenzuar, diturinë - se si e ka përdorur.” (Et Taberaniu).

KONTROLLIMI I INFORMACIONEVE

Një nga veçoritë e internetit është se ai siguron një sasi jashtëzakonisht të madhe të informacioneve. Megjithatë, futja e këtyre informacioneve është në dispozicion absolutisht për të gjithë, në mënyrë që informacionet i plasojnë njerëzit e të gjitha profileve: profesionist e jo profesionist, të dijshtëm e injorant, të virtutshëm e të prishur. Ky fakt kërkon selektimin gjatë marrjes së informacioneve, dhe të pranojmë dhe të konsiderojmë si të vërteta vetëm ato informacione që vijnë nga burime të njohura e të besueshme. Në këtë rregull tregon qartë ajeti kuranor në të cilin Allahu i Lartësuar thotë: “O ju



që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë...” (El Huxhurat, 6).

Edhe kur informacioni vjen nga burimi i besueshëm dhe konfirmohet vërtetësia e tij, për një gjykim të saktë për këtë është e nevojshme të dimë detajet dhe rrethanat që lidhen me të, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të plotë të ngjarjes në fjalë, për shkak se neglizhimi i rrethanave do të kontribuojë në keqkuptime. Si shembull, mund të na shërbejë rasti i jetës së Pejgamberit a.s., kur një natë e shoqëronte gruan e tij Safijën nga xhamia, dhe e panë atë dy sahabë të cilët nxitonin duke u larguar nga ai, mirëpo, Pejgamberi a.s., i thirri dhe u tha: “Ngadalë, ju të dy! Kjo është Safia (gruaja ime).”⁶ Nëse njëri nga dy sahabët do të thoshte se e kishte parë Pejgamberin a.s., me një grua në natë të errët, ai do të thoshte të vërtetën, por të vërteta e cila nuk është përfundimtare, për shkak se nuk janë përcaktuar të gjitha rrethanat dhe detajet e ngjarjes, dhe nuk është paraqitur fakti se gruaja në fjalë në të vërtetë është gruaja e Pejgamberit a.s., gjë që do të ndryshojë tërësisht gjykimin në lidhje me këtë ndodhi.

MOS NGUTJA ME TRANSMETIMIN E INFORMACIONEVE

I Dërguari i Allahut a.s., thoshte: “Është e mjaftueshme për njeriun si gënjeshtër nëse tregon çdo gjë që dëgjon.”⁷ Pasi që informacioni të është kontrolluar, të njihemi me rrethanat dhe të merret një pasqyrë e plotë rreth tij, nuk duhet të nxitonjë me përhapjen e tij. Asnjëherë informacionet nuk janë përhapur aq shpejtë siç është rasti në kohën tonë, kështu që është shumë e rëndësishme për të mbajtur në mend paralajmërimet e Pejgamberit a.s., në lidhje me rreziqet e të folurit dhe gjuhës. Një paralajmërim të tillë u përcjellë nga Ebu Hurejre r.a., duke thënë se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Me të vërtetë njeriu e shqipton një fjalë, të cilës nuk i kushton vëmendje, e për shkak të saj bie në zjarr më thellë se distanca midis lindjes dhe perëndimit.”⁸ Në një transmetim

tjetër, pak sa më të gjatë, përmendet se Pejgamberi a.s., e paralajmëroi Muadh b. Xhebelin r.a., që ta ruajë gjuhën dhe ta “kufizon” atë, e që Muadhi pyeti: “O i Dërguari i Allahut, a do të kërkohet llogari edhe për atë që ne flasim?” për çka Pejgamberi a.s., ia ktheu: “Nëna mos të paq, o Muadh, a do t’i hedh njerëzit me kokë poshtë (në hundët e tyre) në zjarr gjë tjetër përveç të korrat e gjuhës së tyre!”⁹

Në këto transmetime të Pejgamberit a.s., paralajmërohet për rrezikun e të folurit dhe gjuhës, ndërsa në rrjetet sociale kryesisht komunikohet përmes tastierës, në formë shkrimi, pra, me dorë e jo me gjuhë, megjithatë, thelbi është i njëjtë, kështu që edhe rregulli është identik. Vlen të përmendet se Pejgamberi a.s., në një hadith tjetër, në të njëjtën kohë paralajmëroi për gjuhën dhe duart: “Mysliman është ai nga gjuha dhe duart e të cilit janë të qetë myslimanët e tjerë.”¹⁰

Prandaj, para se të ndash ndonjë lajm, verifiko nëse ai është i dobishëm për të përhapur apo jo. Nëse me të pohohen vlerat pozitive, morali fisnik, inkurajon për të mirë dhe tregon për të keqen, promovon njohuri të dobishme, etj., transmetoje atë, por, në qoftë se është e gjithë e kundërta, mos ji pjesëmarrës në përhapjen e tij. Gjithashtu, në qoftë se bëhet fjalë për prekje në nder të një myslimani apo është në pyetje interesi i përgjithshëm i shoqërisë myslimane, mos i lejo vetes që të marrësh pjesë në përhapjen e saj, sepse, Allahu i Lartësuar në Kuran thotë: “E përse kur e dëgjuan atë (shpifje) besimtarët dhe besimtare të mos mendonin të mirën si për vete dhe të thonë: “Kjo është shpifje e qartë?!” (En Nur, 12). Dhe thotë: “Madje kur u vjen atyre (mynafikëve) ndonjë lajm qetësues (kur fitojnë myslimanët) ose shqetësues (kur dështojnë), ata e përhapin atë...” (En Nisa, 83).

Komentuesi i Kuranit, Abdurrahman es-Sadiu, duke komentuar këtë ajet thotë: “Në këtë ajet, gjithashtu, dënohet dhe ndalohet nxitimi në përhapjen e lajmit, menjëherë pas dëgjimit të tij, dhe është urdhëruar që të mendohet para se të flasim, dhe të marrin në konsideratë se a ka dobi që njeriu të merret me këtë, ose është në dështim marrja me të në mënyrë që të abstenohet nga kjo.”¹¹

1 Karić, Enes, “Vrijeme u Kur’anu”, Takvim (Kalendar) 2015, (Sarajevë: Rijaseti i Bashkësisë Islame në Bosnjë e Hercegovinë, 2014) 65.

2 Sherif Ahmeti, Komente dhe mendime islame, (Prishtinë, Lidhja, 1995), 174-175.

3 Karić, Enes, “Vrijeme u Kur’anu”, vep. e cit., 72.

4 Muhamed Pandža dhe Džemaludin Čaušević, Kur’an Časni - prevod i tumač, (Sarajevë, 1937) 947.

5 Asmir Halilović, O začudnošti govora 2, (Sarajevë, Bookline, 2010), 132.

6 Buhari, nr. 3107 dhe Muslimi, nr. 2175.

7 Muslimi, nr. 5.

8 Muslimi, nr. 2290.

9 Ahmed, nr. 22016, dhe Tirmidhiu nr. 2616.

10 Buhari, nr. 10, dhe Muslimi, nr. 41.

11 Abdurrahman es-Sadiu, Tejsirul Kerimir-Rahman fi Tefsiri Kelamul-Menar, (Arabia Saudite, Daru Ibni Xhevzi, 1422 H.), 330.

Ibën Hazm, kolosi mysliman spanjoll

(384-456 H./994-1064)

Nexhat Ibrahim

Ibën Hazmi ishte një polimat, historian, muhadith, hereziograf, komparativist i religjioneve, jurist, filozof, psikolog, mjek, gjuhëtar dhe teolog arab andaluzian.

Ibën Hazmi është dijetar i përmasave të mëdha intelektuale, edhe në kohë edhe në hapësirë, mirëpo te dijetarët myslimanë nuk ka zgjuar interesim të nevojshëm. Interesimi nuk është më i madh as te lexuesit e zakonshëm myslimanë. Dhe për habi, Ibën Hazmi ka zgjuar interesim tek autorët e huaj, jomyslimanët, siç është rasti edhe me Ibën Sinain, Ibën Haldunin etj. Deri tash në gjuhën shqipe nuk dimë nëse është publikuar ndonjë vepër e Ibën Hazmit, ose për Ibën Hazmin, përveçse vepra e përkthyer *Shërimi i shpirtit* dhe *Unaza e pëllumbeshës*. Kjo na shtyn ta ngremë si çështje prezantimin e tij si me përkthime, ashtu dhe me studime për jetën, veprat dhe idetë e tij si personalitet apo në tërësinë e mësimin mysliman.

Ebu Muhammed Ali bin Aḥmed bin Seid bin Ḥazm, apo siç njihet më mirë Ibën Hazmi lindi në vitin 384 h./994, në Kalifatin e Kordobës, në Andaluzi, ose Spanjën e sotme. Ai i përkiste një familjeje intelektuale e politike. Edhe babai i tij, Ahmed, e edhe gjyshi, Saidi, mbanin poste të larta këshilluese në oborrin e kalifit emevit Hishamit II. Studiuesit besojnë se ata ishin të krishterë iberikë që e pranuan fenë islame.

Ibën Hazmi u rrit në një familje me nam edhe në rrafshin kulturor, politik dhe ekonomik, e cila gjendje ndikoi që Ibën Hazmi të ketë qasje në nivele të larta shtetërore e kulturore, që nga adoleshenca e tij. Ato përvoja me njerëz të profilin të lartë politik e shoqëror bënë që Ibën Hazmi të zhvillonte një skepticizëm ngurrues ndaj njerëzve mashtrues dhe shtypës.

Ibën Hazmi jetonte në rrethin e hierarkisë sunduese të qeverisë së Kalifatit të Kordobës.



Përvoja e tij sollën një qasje kureshtare dhe vrojtuese, duke ndikuar që ai të fitojë një arsim të shkëlqyeshëm në Kordobë.

Pas vdekjes së vezirit të madh, Muzaffer, në vitin 1008, Kalifati i Iberisë u përfshi në një luftë civile, e cila zgjati deri në vitin 1031, dhe rezultoi në rënien e autoritetit qendror të Kordobës dhe shfaqjen e shumë shteteve më të vogla, të quajtura *taifa*, që ishte një regres për shoqërinë myslimane në Gadishullin Iberik.

Krahas regresit kolektiv, Ibën Hazmi pati edhe një vështirësi tjetër, vdekjen e babait në vitin 1012, me ç'gjë mbeti pa mbrojtjen dhe ndihmën e babait. Kjo bëri që Ibën Hazmi të burgoset shpesh në kohën vijuese, si një përkrahës i dyshuar emevit. Në vitin 1031, për shkak të rënies së Kalifatit të Kordobës dhe krijimit të shumë mini-shteteve, Ibën Hazmi u tërhoq në pasurinë e tij familjare në

Manta Lisham, dhe bindjet e tij aktiviste kishte filluar t'i shprehte në formën e shkruar.

Ibën Hazmi ishte një polimat, historian, muhadith, hereziograf, komparativist i religjioneve, jurist, filozof, psikolog, mjek, gjuhëtar dhe teolog arab andaluzian.

VEPRAT E IBËN HAZMIT

Ai ishte një përkrahës dhe kodifikues kryesor i shkollës zahirite (dhahirite) të mendimit islam. Ibën Hazmi thuhet se shkroi rreth 400 vepra, mirëpo deri më sot dihen vetëm për 40 vepra të mbijetuara. Në total, veprat e tij të shkruara arrinin në rreth 80.000 faqe. Kundërshtarët e tij politikë dhe fetarë e fituan pushtetin pas rënies së kalifatit të Kordobës, dhe kështu ai pranoi një ofertë azili prej guvernatorit të ishullit Majorka, në vitet 1040. Ai vazhdoi të propagandonte për shkollën zahirite edhe atje, përpara se të kthehej në Andaluzi.

Pjesa më e madhe e veprave të konsiderueshme të Ibën Hazmit, rreth 400 prej tyre, sipas Taberiut dhe Sujutiut, u dogjën në Sevilljë, prej rivalëve të tij ideorë dhe politikë. Veprat e tij të mbijetuara, derisa kritikohen si përsëritëse, didaktike dhe gërryese në stil, tregojnë gjithashtu një mosnderim të patrembur ndaj kritikëve dhe autoriteteve të tij akademike.

Ibën Hazmi shkroi vepra mbi ligjin dhe teologjinë, dhe mbi dhjetë libra mjekësorë. Ai bëri thirrje që shkencat të integrohet në një kurrikulë standarde. Në grupin e shkencave ai i përkufizon në mënyrë diakronike edhe fushat arsimore, sikurse fazat e përvetësimit progresiv të vendosura gjatë një kurrikule pesëvjeçare, nga gjuha dhe interpretimi i Kuranit, deri te shkencat e jetës dhe fizike, në një teologji racionale.

IDETË

Literalizmi

Ibën Hazmi ishte i njohur për literalizmin e tij të rreptë, dhe konsiderohet kampion i shkollës literaliste zahirite brenda islamit suni. Bashkëkohësit e tij e shpikën thënien se “*gjuha e Ibën Hazmit ishte një vëlla binjak me shpatën e Haxhaxhit*”, një gjenerali emevit nga shekulli VII dhe

guvernator i Irakut. Ibën Hazmi u citua aq shpesh, sa shprehja “Ibën Hazmi” u bë proverbiale.

Si etherist ai e kundërshtoi interpretimin alegorik të teksteve fetare, dhe e preferoi një interpretim gramatikor dhe sintaksor të Kuranit. Ai i dha legjitimitet njohës vetëm shpalljes dhe ndjesisë, dhe arsyetimin deduktiv e konsideronte të pamjaftueshëm në çështjet juridike dhe fetare.

Ai hodhi poshtë praktikën e zakonshme në mesin e më shumë shkollave ortodokse, si diskrecioni juridik. Ai fillimisht ishte një ndjekës i shkollës juridike malikite brenda islamit suni, mirëpo më pas kaloi në shkollën shafiite, rreth moshës tridhjetëvjeçare. Më në fund u qetësua në shkollën zahirite. Ai është, ndoshta, pasuesi më i njohur i shkollës dhe burimi kryesor i veprave ekzistuese mbi fikhun zahirit. Ai i studioi parimet dhe metodat e shkollës, nën kujdesin e Davud Zahiriut, dhe përfundimisht u promovua në nivelin e një mësuesi të vetë shkollës.

Në vitin 1029, për aktivitetet në mospajtim me shumicën tjetër, të dy, edhe Davud Zahiriu edhe Ibën Hazmi, u dëbuan nga xhamia kryesore e Kordobës.

Njohja

Në veprën *El Fisalu fil mileli vel ehvai ven nihal*, një traktat mbi shkencën dhe teologjinë islame, Ibën Hazmi e promovoi perceptimin shqisor mbi arsyen njerëzore me të meta subjektive. Duke e njohur rëndësinë e arsyes, pasi vetë Kurani e fton reflektimin, ai argumentoi se reflektimi duhet t'i referohet kryesisht shpalljes dhe të dhënave shqisore, pasi parimet e arsyes rrjedhin tërësisht nga përvoja shqisore. Ai arrin në përfundimin se arsyeja nuk është një aftësi për kërkime apo zbulime të pavarura, por se perceptimi shqisor duhet të përdoret në vend të tij, një ide kjo që përbën bazën e empirizmit.

Jurisprudenca

Ndoshta vepra më me ndikim e Ibën Hazmit në arabisht, përzgjedhje të së cilës janë përkthyer në anglisht, tani është *El Muha'lla bil athar*. Kjo është raportuar të jetë një përmbledhje e një vepre shumë më të gjatë, e njohur si *El Muxha'lla* (المجلد). Fokusi i veprës është në çështjet e fikhut, mirëpo ai gjithashtu i prek çështjet e besimit në kapitullin e



tij të parë, Kitab Et Tevhid, fokusi i të cilit është në çështjet e besimit që lidhen me monoteizmin dhe parimet themelore të qasje ndaj teksteve hyjnore. Një nga pikat kryesore që del nga kryevepra e mendimit jurisprudencial është se Ibën Hazmi e refuzon arsyetimin analogjik (kijasin) mirëpo e preferon një qasje shumë më të drejtpërdrejtë dhe tekstuale ndaj teksteve.

Filozofia

Veprat e Ibën Hazmit prekën lehtë traditat e filozofisë greke. Ai besonte se këto tradita filozofike ishin të dobishme, mirëpo jo të mjaftueshme për ta ndërtuar siç duhet karakterin e një individi. Dhe, ai deklaroi se besimi islam ishte gjithashtu i nevojshëm.

Koncepti i vullnetit të lirë absolut u hodh poshtë prej Ibën Hazmit, pasi ai besonte se të gjitha atributet e një individi janë krijuar prej Zotit.

Logjika

Ibën Hazmi shkroi fushëveprimin e logjikës, dhe theksoi rëndësinë e perceptimit shqisor si një burim për dije. Ai shkroi se “burimet e para të të gjitha njohurive njerëzore janë shqisat e përdorura mirë dhe intuitat e arsyes, të kombinuara me një kuptim të saktë të një gjuhe”. Ibën Hazmi kritikoi gjithashtu disa prej teologëve më tradicionalë, të cilët ishin kundër përdorimit të logjikës dhe argumentuan se gjeneratat e para të myslimanëve nuk u mbështetën në logjikë. Përgjigja e tij ishte se myslimanët e hershëm e kishin dëshmuar drejtpërdrejt shpalljen, mirëpo më vonë myslimanët janë ekspozuar ndaj besimeve të kundërta, dhe kështu përdorimi i logjikës është i nevojshëm për t'i ruajtur mësimet e vërteta të Islamit.

Etika

Në librin e tij, *Në ndjekje të virtytit*, Ibën Hazmi i kishte nxitur lexuesit e tij: *Mos e përdorni energjinë tuaj përveç për një kauzë më fisnike se ju! Një shkak i tillë nuk mund të gjendet përveçse te Vetë Zoti i Plotfuqishëm: ta predikosh të vërtetën, ta mbrosh femrën, ta zmbarsësh poshtërimin që nuk ta ka imponuar Krijuesi yt, t'i ndihmosh të shtypurit. Kushdo që e përdor energjinë e tij për hir të kotësive të botës, është si dikush që i shkëmben gurët e çmuar me zhavorr.*

Poezia

Një poezi ose fragment i një poezie të tij ruhet në *Pennants of the Champions* të Ibën Said Magribit:

*Ti më ke ardhur pak më parë
të krishterët i binin kambanave të tyre.
Gjysma e Hënës po lindte*

*Mos e përdorni
energjinë tuaj
përveç për një
kauzë më fisnike
se ju! Një shkak i
tillë nuk mund të
gjendet përveçse
te Vetë Zoti i
Plotfuqishëm: ta
predikosh të
vërtetën, ta
mbrosh femrën,
ta zmbarsësh
poshtërimin që
nuk ta ka
imponuar
Krijuesi yt, t'i
ndihmosh të
shtypurit.*

*duken si vetulla e një plaku
ose një këmbë delikate.*

*Dhe ndonëse ishte ende natë
kur erdhi një ylber*

me shkëlqim në horizont,

*duke treguar sa më shumë ngjyra
si bishti i palloit.*

Mjekësia

Mësuesit e Ibën Hazmit në mjekësi përfshinin Zahravin dhe Ibën Kattanin, dhe ai shkroi dhjetë vepra mjekësore, duke përfshirë *Kitab fil Advija il mufrada*, të përmendur prej Dhehebiut. Përkundër këtij kontributi, ai nuk njihet sa duhet në këtë fushë.

Gjuha

Përveç pikëpamjeve të tij për ndershmërinë në komunikim, Ibën Hazmi iu drejtua edhe shkencës së gjuhës në njëfarë mase. Ai e shihte gjuhën arabe, gjuhën hebraike dhe gjuhën siriane të një trugu, e cila u degëzua, ndërsa folësit u vendosën në rajone të ndryshme gjeografike dhe zhvilluan fjalorë dhe gramatika të ndryshme nga rrënja e përbashkët. Ai gjithashtu ndryshonte me shumë teologë myslimanë, në atë që ai nuk e shihte arabishten si superiore ndaj gjuhëve të tjera, pasi Kurani nuk e përshkruan arabishten si të tillë. Ibën Hazmi shihte se nuk kishte asnjë provë për të pretenduar se ndonjë gjuhë ishte më e lartë se ndonjë tjetër.

Shiizmi

Ibën Hazmi ishte shumë kritik ndaj shiitëve. Ai tha për sektin: Persianët zotëronin një mbretëri të madhe, dhe një dorë mbi të gjitha kombet e tjera. Ata e zmadhuan rrezikun që paraqisnin (për kombet e tjera), duke e quajtur veten El Ahrâr (të lirët) dhe El Asjad (fisnikët). Si rezultat, ata i konsideronin të gjithë njerëzit e tjerë për skllëvër të tyre. Megjithatë, ata u goditën nga shkatërrimi i perandorisë së tyre, dhe atë nga duart e arabëve, të cilët ata i kishin konsideruar si një rrezik më të vogël midis kombeve të tjera (për perandorinë e tyre). Çështjet e tyre u përkeqësuan, dhe vuajtjet e tyre u dyfishuan teksa kurdisnin luftëra kundër Islamit, dhe atë në kohë të ndryshme. Megjithatë, në të gjitha komplotet e tyre Allahu e shfaqti të Vërtetën. Ata vazhduan të komplotonin marifete më të dobishme. Pra, disa prej njerëzve të tyre e pranuan Islamin vetëm për t'u kthyer kah shiizmi, me pretendimin se e donin Ehli Bejtin (familjen e Pejgamberit, a.s.), dhe e urrenin shtypjen ndaj Aliut. Pastaj, ata r përshkuan këtë rrugë derisa ajo i largoi nga rruga e udhëzimit (Islami).

NDIKIMI I MATURIDIUT DHE ESHARIUT

Formulimi suni, megjithatë, siç paraqitet nga Maturidiu dhe Eshariu, dy përfaqësuesit kryesorë të sunitëve në shekullin X, tregon dallime të dukshme, pavarësisht uniformitetit bazë. Eshariu mësoi se veprimet njerëzore u krijuan prej Zotit, dhe u përvetësuan prej njerëzve, dhe se përgjegjësia njerëzore varej nga ky përvetësim. Megjithatë, ai mohoi se njerëzimi mund të përshkruhet si një aktor në një kuptim real.

Maturidiu, nga ana tjetër, pohoi se megjithëse Zoti është Krijuesi i vetëm i gjithçkaje, duke përfshirë edhe veprimet njerëzore, megjithatë një qenie njerëzore është një aktor në kuptimin e vërtetë, sepse aktrimi dhe krijimi ishin dy lloje të ndryshme aktiviteti që përfshinin aspekte të ndryshme të të njëjtit akt njerëzor.

Në përputhje me qëndrimet e tyre, Eshariu besonte se një person nuk kishte fuqi për të vepruar përpara se të vepronte në të vërtetë, dhe se Zoti e krijonte atë fuqi tek ai në kohën e veprimit.

Maturidiu mësoi se, përpara se të ndërmerret një veprim, një person ka një fuqi të caktuar të përgjithshme për veprim, mirëpo se kjo fuqi bëhet specifike për një veprim të caktuar vetëm kur kryhet veprimi, sepse, pasi fuqia e plotë dhe specifike të vijë në ekzistencë, veprimi nuk mund të vonohet.

Eshariu dhe shkolla e tij gjithashtu menduan se arsyeja njerëzore nuk ishte në gjendje ta zbulonte të mirën dhe të keqen, dhe se veprimet u pajisën me cilësi të mira ose të liga nëpërmjet shpalljes së Zotit si të tilla. Për shkak se njerëzimi në gjendjen e tij natyrore e konsideron interesin e tij personal si të mirë dhe atë që e pengon këtë interes personal si të keqe, arsyeja natyrore njerëzore është e pabesueshme. Prandaj, pavarësisht nga shpallja, vrasja nuk do të ishte e keqe, dhe as shpëtimi i jetës i mirë. Për më tepër, për shkak se Vullneti i Zotit i bën veprat të mira ose të këqija, nuk mund të kërkohen arsyet pas ligjit hyjnor, të cilat thjesht duhet të pranohen.

Maturidiu mban një pozicion të kundërt: arsyeja njerëzore është e aftë ta zbulojë të mirën dhe të keqen, dhe shpallja e ndihmon arsyen njerëzore kundër ndikimit të pasioneve njerëzore.

Pavarësisht nga këto dallime fillestare të rëndësishme midis dy shkollave kryesore të mendimit suni, doktrinat e Maturidiut u zbehën me kalimin e kohës, nën popullaritetin në rritje të shkollës Esharite, që ishte e ndihmuar nga dinastitë e ndryshme, e cila fitoi edhe një valutë të gjërë, veçanërisht



pas shekullit XI, për shkak të veprimtarisë me ndikim të teologu sufist Gazaliut. Për shkak se këta teologë të mëvonshëm vendosën theksin gjithnjë e më të madh te plotfuqia hyjnore, në kurriz të lirisë dhe efikasitetit të vullnetit njerëzor, një pikëpamje deterministe për jetën u bë karakteristikë e islamit suni – e rigjallëruar nga botëkuptimi i sufizmit islam, i cili mësonte se asgjë nuk ekziston, përveç Zotit, Qenia e të Cilit është e vetmja Qenie reale.

PERSPEKTIVA

Dijetarët myslimanë, veçanërisht ata që e pranojnë zahirizmin, shpesh e kanë lavdëruar Ibën Hazmin për atë që ata e perceptojnë si dituri dhe këmbëngulje të tij. Predikuesi jemenas Mukbil bin Hadi Vadi' ishte njëri prej admiruesve të Ibën Hazmit në kohët e fundit, duke mbajtur qëndrimin se asnjë dijetar tjetër mysliman nuk kishte mishëruar traditën pejgamberike të Muhamedit, a.s., dhe sahabëve. Në disa raste, Vadi' e hodhi poshtë vlefshmërinë e kijasit (analogjisë), duke iu referuar

veprave të Ibën Hazmit. Në fakt, Vadi' nganjëherë i këshillonte studentët e tij që të ishin zahiri.

Ebu Abdurrahman bin Akil Zahiri është biografi kryesor i Ibën Hazmit në epokën moderne, me një sërë veprash mbi jetën dhe karrierën e Ibën Hazmit, të botuara përmes shtypshkronjës së Ibën Akilit, që e mban emrin e Ibën Hazmit.

Rigjallërimi modernist i kritikës së përgjithshme të Ibën Hazmit ndaj teorisë juridike islame ka parë disa momente kyç në historinë intelektuale arabe, duke përfshirë ribotimin e veprës *El Muha'lla*, prej Ahmed Shakir, biografisë e Muhamed Ebu Zehres për Ibën Hazmin etj.

Literatura:

- Anwar G. Chejne, *Ibën Hazm El-Endelusi ve mevkufihi mine'l-ulumi*, Kazi Publications, Chicago, 1402 h./1982.
- Camilla Adang, Maribel Fierro, Sabine Schmidtke (ed.), *Ibën Hazm of Cordoba: The Life and Works of a Controversial Thinker*, BRILL, 2012.
- Daniel Nathan Hickman, *Ibën Hazm: an Islamic Source of Courtly Love*, University of Tennessee, 2014.
- Ebu Mensur El Maturidiu, *Kitabu't-tevhid* (libri mbi monoteizmin), Logos-A, Shkup, 2018.
- https://en.wikipedia.org/wiki/Ibn_Hazm.
- Ibën Hazm El Endelusi, *Unaza e pëllumbeshës – për dashurinë dhe të dashëruarit*, Nektari, Tiranë, 2023.
- Ibën Hazmi, *Shërimi i shpirtit*, Zëri Islam, Prizren, 2000.
- Syed N. Barmaver, *Ibn Hazm: život i djelo španskog genija*, Udruženje građana "Multi", Tuzla, 2020.

Knud Ali Holmboe

(DËSHMORI I FJALËS DHE I MENDIMIT TË LIRË)

Klodiana Xhaferaj

“Në thellësi, brenda vetes, njerëzit e Lindjes dhe të Perëndimit janë njësoj. Ata janë dy degë të së njëjtës pemë. Dhe kur njeriu, pa marrë parasysh se nga vjen, kërkon thellë në zemrën e tij, ai do ta ndiejë mallin për rrënjën e pemës.” Knud Holmboe

A e dini se cili është heroi mysliman danez, emrin e të cilit janë munduar ta fshijnë nga memoria, nga historia në Danimarkë?! Shehidi, - me leje të Zotit, - Knud Holmboe, gazetari në kërkim të së vërtetës. Ne jemi mësuar që sa herë të përmendet Danimarka, ta lidhim me vendin ku lejohet dhe ka liri të plotë përqeshja dhe karikatura ndaj pejgamberit Muhamed, salallahu alejhi ve selem. E ndërsa media daneze ka këtë urrejtje ndaj Islamit dhe pejgamberit të tij, para afro një shekulli, Danimarka nxori nga gjiri i saj gazetarin e mendimit dhe të fjalës së lirë, gazetarin që e pasqyroj me vërtetësi gjendjen e vështirë të myslimanëve të Afrikës veriore, të cilët nën kolonizimin e egër të shteteve evropiane.

Edhe sot, pas afro 90 vitesh, shtete të ndryshme evropiane përpiqen që t'i harrohet emri, t'i harrohet biografia. Atë e luftoi politika italiane, franceze, gjermane, angleze, e deri edhe shteti i tij në të cilin lindi: Danimarka. E gjitha kjo sepse përshkroi me detaje trajtimin çnjerëzor që këto shtete ia bënë popujve të Afrikës, të cilat i kolonizuan në fillim të shekullit të shkuar. Deri edhe nazistët, kur hynë në Danimarkë, në vitin 1940, sekuestruan librat e tij, duke i torturuar dhe vrarë edhe pjesëtarë të familjes së tij. Komandanti i ushtrisë britanike, Montgomeri, për librin e tij u shpreh: “Më i fuqishëm se një

ushtri, më i fortë se një flotilje.” Pavarësisht se britanikët përfituan shumë nga libri i tij “Ørkenen Brænder”, libër në të cilin janë të përshkruara me detaje rrugët që i lidhin qytetet dhe shtetet e Afrikës veriore, si dhe është përshkruar me detaje natyra e banorëve, e fiseve, e fshatrave, e lëvizja dhe e erërave, pastaj e puseve e të tjera të dhëna që i përdorën në luftën kundër nazistëve, përsëri edhe ata e luftuan atë. Ai e dënoi imperializmin italian, i cili ishte ndër më brutalët në Afrikën veriore.

Atëherë, pra, kush është Knud Holmboe (Ali Ahmed)? Ky është një gazetar danez i lindur në Danimarkë, në 22 prill të vitit 1902. Në moshën 17 vjeçare shfaqti interes për religionin dhe filozofinë. Ai u rrit në mjedis protestant, mirëpo pasi filloi t'i ndiqte mësimet fetare pranë një manastiri në veri të Luksemburgut, u konvertua në katolicizëm, në vitin 1921. Megjithatë kishte gjithë mundësitë të jetonte një jetë të qetë, pa kokëçarje, për shkak të sigurisë ekonomike që gëzonte i dhe familje e tij si familje sipërmarrësish, ai kishte shpirtin e aventurës, kështu që dëshironte të eksploronte larg ambientit në të cilin jetonte. Ai pranoi çfarëdolloj ofertash pune që kishte në vetvete aventurën. Gazetaria ishte pikërisht fusha ku ai shikonte se mund të derdhte gjithë energjitë e tij. Në moshën 19 vjeçare ai i shkroi disa poezi, mirëpo për shkak të pasigurisë, nuk i botoi. Pasi i kreu studimet për gazetari, filloi të punonte për një sërë gazetash daneze. Artikulli i tij i parë si gazetar ishte për gazetën “Dagens Nyheder”, në Kopenhagen. Artikulli ishte rreth udhëtimit që ndërmori në Norvegji, deri në pikën më të largët të këtij shteti, në Kolen. Në vitin 1924 drejtohet për

“Në thellësi, brenda vetes, njerëzit e Lindjes dhe të Perëndimit janë njësoj. Ata janë dy degë të së njëjtës pemë. Dhe kur njeriu, pa marrë parasysh se nga vjen, kërkon thellë në zemrën e tij, ai do ta ndiejë mallin për rrënjën e pemës.”

Knud
Holmboe



në Marok. Këtu bie në kontakt me Islamin. Fillimisht e mëson gjuhën arabe, si dhe merr mësimet rreth fesë islame. Pastaj e përqafon Islamin. Pasi kthehet në Danimarkë, shkruan veprën e tij të parë “Between the Devil and the Deep Sea: A Dash by Plane to Seething Morocco”, ku tregon për mbresat që i kishte lënë vizita në Marok. Kaq shumë u dashurua pas Islamit, aq sa në letrën që ua dërgoi prindërve të tij, kishte shkruar: “Shpresoj dhe uroj se për Islamin ka të ardhme, veçanërisht në Evropën veriore. Në botën tonë njeriu kërkon të krishterimi më shumë sesa ç’i ofron. Kemi humbur respektin tonë ndaj tij. Shpresoj se Islami është e ardhmja, vetëm Islami. Islami është ai që mund ta realizojë lumturinë e vërtetë për individin, për dallim nga socializmi dhe të gjitha rrymat e ngjashme me të.”

Më pas udhëtoi në Saharanë e madhe, me makinën e tij Chevrolet, ku futej edhe nëpër rrugica e kthina për të zbuluar bashkësi e fise që banonin në ato anë, duke parë me sytë e tij jetën e vështirë që bënin nën kolonizimin spanjoll, francez e italian. Ai i regjistroi me detaje dhe me besueshmëri të lartë. Po ashtu u takua me shumë prej udhëheqësve e luftëtarëve myslimanë të Magrebit islam, Libisë, Egjiptit, Palestinës, Sirisë e Jordanisë. Ai ua nxori të palarat anglezëve, gjermanëve e spanjollëve për krimet që kishin bërë ndaj popullsisë vendase myslimane. Veprat e tij për dekada nuk u ribotuan në gjuhët evropiane. Dritën e botimit e panë vetëm në fillim të këtij shekulli. Në vitin 1925 ai punoi gazetar-korrespondent për disa gazeta angleze dhe daneze, duke mbuluar frontet e luftës që zhvilloheshin në ato zona: Turqi, Palestinë, Siri, Persi dhe Irak, duke vënë në rrezik edhe jetën e tij. Shpëtoi duke u arratisur me një karvan tregtarësh, të cilët lëvizën nga jugu i Basrës drejt Iranit. Në vitin 1927 kaloi gazetar korrespondent

në Ballkan, më saktë në Shqipëri, ku u gjend përsëri në telashe politike, pasi fotoqafat dhe përshkroi varjen në litar të një prifti (me gjasa Dom Gjon Gazulli, i cili është i vetmi prift i varur në këtë vit 1927), gjë të cilën e botoi në gazetën e Evropës. Botimi i fotos së priftit të varur në të gjitha gazetën anembanë Evropës irritoi pushtetin qendror të Italisë. Pas kësaj u bë shumë i kërkuar për të punuar si korrespondent në gazetën më të njohura të kohës, gjë për të cilën u bë i padëshiruar për kolonizatorët italianë në Shqipëri, duke e detyruar të largohej.

Në 1928 shkoi drejt Marokut, së bashku me gruan e tij Leonora Borup dhe foshnjën e tyre, Aishen (Netten). Ai e ndryshoi emrin, duke ia përshtatur besimit islam, dhe e quajti veten Ali Ahmed El Xheziri. Pas dy vitesh bashkëshortja bashkë me vajzën u kthyen në Danimarkë.

Në vitin 1930 vendosi ta përshkrojë Saharanë me makinë, duke u përballur me realitetin; ai realitet i cili nuk pasqyrohej në kronikat e kohës në mediet evropiane. Kështu që, ai vendosi kontakte me rezistencën libiane, të udhëhequr prej Omer El Muhtar (Luanit të Shkretëtirës), dhe kërkoj vullnetarisht të ishte ai zëri përçues i luftës së tyre në Evropë. Më pas shkoi në Egjipt, ku kishte në plan ta organizonte një karvan me ndihma për rezistencën libiane, me armë dhe ushqime, gjë të cilën nuk mundi ta bënte, pasi u arrestua nga autoritetet, madje dhe u burgos një muaj në Egjipt. Pasi e kreu dënimin, e dëbuan drejt Danimarkës, ku e botoi veprën e tij Ørkenen Brænder (Desert Encounter), ku foli për gjenocidin italian ndaj popullatës vendase libiane. Libri pati jehonë të gjerë në Evropë dhe Amerikë, mirëpo në Itali u ndalua shitja e tij. Pas 6 muajve shkoi në Turqi, ku i takoi kryetarët e lëvizjeve arabe-islame të dëbuar nga vendet e tyre.

Në vitin 1931, derisa ishte në rrugëtimin e kryerjes së haxhit, gjenerali anglez Percy Cox, mik i ngushtë i familjes saude, e organizoi vrasjen e Ali Ahmedit, në zonën e Akabes, ndërsa Aliu (Knud) ishte duke ardhur nga Jordania, ku sapo i kishte shpëtuar një tentativë tjetër vrasjeje. E gjitha kjo sepse vepra e tij ndërkohë ishte përkthyer në gjuhën arabe, dhe në Siri myslimanët e revoltuar deshën të hyjnë me forcë në konsullatën italiane në Damask. Kolonizatorët francezë, të cilët e kishin kolonizuar Sirinë, e dëbuan Aliun drejt kufijve të Jordanisë.

Provata tregojnë se ishin disa shërbime sekrete të Gjermanisë, Anglisë, Italisë, të cilat i ndiqnin lëvizjet dhe të cilat ranë dakord që ta zhduknin, aq sa mos t’i mbetej asnjë gjurmë. Deri më sot vërtet nuk dihet se ku është trupi i tij. “Kush e ka prekur tokën e Afrikës me këmbët e tij, përfundimisht do kthehet tek ajo”.

Burimet

- Ali Ahmed Knud Holmboe, (Why I became a Muslim), The Islamic Review, 1931.
- Ali Ahmed Knud Holmboe, Desert Encounter. Quilliam Press; 2nd edition (October 26, 1994).

Mirupafshim, Mekë!

FRAGMENT NGA LIBRI “HERA E PARË NË MEKË”

(Besnik Jaha)

Dita e tretë në Mekë, 18.03.2022

Epremtë. Edhe sot e prita diellin të shfaqej e t'i japë dritë tokës ku isha. Tokës së shenjtë. Qielli nuk dukej pastër për shkak se, me gjasë, gjatë natës kishte pasur *habub* – stuhi pluhuri e rëre nga shkretëtira. Era e kishte davaritur rërën deri në lartësi të mëdha, e megjithatë, prapë nga lartësia e dhomës së hotelit mund ta shihja Qabenë e bekuar. Atë që i nderonte gjithë vizitorët që kishin ardhur ta nderonin nga çdo anë e botës. Duke sakrifikuar kush si kishte mundur, vetëm e vetëm të gjendej aty. Në Bejtullah.

Sot do të largohesha nga Meka. Nga vendi që i ruante të gjalla mrekullitë. Nga vendi ku ishte Arafati, aty ku u takuan Ademi e Havaja pas zbritjes në Tokë nga Parajsa, për ta vazhduar ndjekjen e urdhrit të Zotit.

Në ezel, para se Zoti ta krijonte Ademin, alejhi selam, nga boshti i tij kurrizor i kishte nxjerrë gjithë shpirtrat, të çdo njeriu që do të krijohet, deri në Kiamet, dhe aty u kishte kërkuar të dëshmonin nëse e njihnin për Zot. Aty shpirtrat kishin deklaruar se, sigurisht se e njihnin vetëm Allahun.

“Kujtoje kur Zoti Yt nxori nga shpina e bijve të Ademit pasardhësit e tyre, dhe i bëri dëshmitar të vetes së tyre (duke u thënë): “A nuk jam Zoti juaj?!” Atë thanë: “Po, dëshmuam”, - e (kjo) që të mos thoni në Ditën e Kiametit: Ne për këtë (dëshmi) ishim të pavëmendshëm.”

Më pas Zoti i kishte rikthyer krejt shpirtrat pas në boshtin kurrizor të Adem, alejhi selam, dhe kishte dhënë urdhër që jeta të fillonte. Një nga interpretimet e emrit Arafat lidhet pikërisht me këtë njohje-pranim të Zotit prej njerëzve, sipas kuptimit morfologjik të fjalës *arefe*-njohje. E, mua më dukej se edhe unë sikur kisha ardhur këtu për ta rikonfirmuar

betimin e shpirtit tim: se Allahun e njihja për Krijues e Zot.

Sot po largohesha nga toka ku kishin shkelur gjithë pejgamberët. Ku nga kontinenti i Evropës, sikurse unë, deri në Mekë dikur kishte ardhur edhe pejgamberi durimtar Ejubi, *alejhi selam*.

Sot do të largohesha nga toka e Ibrahimit dhe e Ismailit, *alejhimu selam*. Nga vendlindja e Muhamedit, alejhi selam. Nga vendi ku zbriti Lajmi i fundit i Zotit për njerëzimin mbarë. Nga vendi i civilizimit të lashtë sa vetë njeriu. Nga vendi ku nisi jeta, dhe nga ku buron uji i jetës Zem Zem-i.

Që nga mëngjesi isha pa humor. Kisha mall për këtë vend ende pa u larguar. Nuk më dilte lehtë lamtumira, dhe as që e shprehja. Edhe këtu, me sytë drejtuar Qabesë, nga dhoma, zemra e gjuha shprehnin vetëm mirupafshim. Zemra nuk pranonte asnjë lloj lamtumire.

*Zemra nuk pranon me t'thanë lamtumirë
Ma i dashuri vend, vendi ma i mirë
Qabe e bekuar, Zoti t'ka nderu
Ah sot unë nga këtu, qysh me u largu*

Në koferin tim kisha stivuar rrobat e dhuratat, ashtu që me mjaft zor e bëra edhe mbylljen e tij. Përveç *ihramit*, gjithçka tjetër e mora me vete. Atë e palosa me kujdes e mirë, dhe bashkë me një copë zemre e kujtimi tepër të dashur e lash mbi shtratin e rregulluar.

Në ndërkohë po afrohej edhe koha e xhumasë. Kjo ishte xhumaja ime e parë që po e falja në Mekë. Namazi zgjati më shumë sesa në Kosovë, ndërsa ligjëratat e imamet të Qabesë - hytbeja, m'u duk se ishte më koncize, më e thukët sesa e imamëve kosovarë. Dhe kjo ishte edhe një tjetër gjë që më pëlqeu shumë.

*Sot do të
largohesha nga
toka e
Ibrahimit dhe e
Ismailit,
alejhimu
selam. Nga
vendlindja e
Muhamedit,
alejhi selam.
Nga vendi ku
zbriti Lajmi i
fundit i Zotit
për njerëzimin
mbarë. Nga
vendi i
civilizimit të
lashtë sa vetë
njeriu. Nga
vendi ku nisi
jeta, dhe nga
ku buron uji i
jetës Zem
Zem-i.*

Po ashtu edhe lajmësi, myezini i Qabesë, gjithmonë do të më mbetet në mendje. Zëri i tij ishte magjepsës. Kumbimi në çdo anë i zërit të tij, kur ftonte në namaz, ishte melodia më e dashur për mendjen dhe zemrën.

Sytë drejtuar kah Qabeja, e këmbët drejt derës. Nga dhoma e hotelit pashë plot zogj që fluturonin nëpër qiellin e Mekës. Edhe ata po e bënin *tavafin* e tyre. Aq sa qielli ngopet me zogj e re, aq ngopej Qabeja me besimtarë. Madhështia e saj sundonte jo vetëm mbi besimtarët që ecnin prajshëm pranë saj, por edhe mbi çdo besimtar, sado qoftë larg saj, pesë herë në ditë duke u drejtuar me fytyrë drejt saj.

Këtë ditë nuk do ta ngrysnim në Mekë. Menjëherë pas namazit të xhumasë duhej të niseshim për në aeroportin e Xhides, sepse fluturimi ynë nga aty për në Vjenë ishte planifikuar në atë orar.

Duhej t'i shmangeshim me të shpejtë trafikut të mesditës, i cili në Mekë ishte më se i zakonshëm çdo të premte. Dhe ia arritëm. Përmes tuneleve nën qytetin e Mekës arritëm të dilnim nga qyteti më shpejt sesa qe planifikuar.

Gjatë gjithë kohës sa udhëtuam, deri në dalje nga Meka, shikova anash, ndërsa pa pushim më nëpërmendej risku i Zotit. Këtyre Zoti u kishte dhënë tokë të thatë, mirëpo ua kishte dhënë edhe Qabenë. Kur do Zoti, te vendi më i shkretë në botë e çon edhe bereqetin e riskun më të madh. Në anën tjetër, toka e Kosovës ishte mjaft e pëlleshme, mirëpo djerrinë. Nuk çmohej e punohej si e sa duhej. Shumë miq që kishin pasur rastin të përkthenin për arabët, kur ata e kishin vizituar Kosovën, më kanë treguar se Kosova u dukej parajsë. Tokë xheneti. Ndërsa ne sikur u kemi vënë perde syve, dhe nuk e shohim vlerën e saj. Vlerën e asaj toke që me prodhimet e saj na rriti. Asaj toke që i mban eshtrat e paraardhësve tanë. Asaj toke që na mban edhe sot.

Kur dolëm jashtë qytetit, derisa po udhëtonim në autostradë, Bashkimi ma bëri një pyetje, sepse jeta në kohën tonë edhe na i lejon shumë fantazi. - Çka nëse do të shuhej teknologjia dhe gjithçka tjetër, duke përfshirë edhe makinat e aeroplanët, dhe do të mbeteshim këtu, apo do të na duhej të ktheheshim në Kosovë vetëm në këmbë, si dikur paraardhësit tanë, që të dy udhët, nga Kosova deri në Qabe, dhe anasjelltas, i kanë bërë në këmbë? A do të ktheheshe?

- Po, - i thashë pa menduar dy herë. Dhe me të diskutimin për dashurinë ndaj vendit ku kishim lindur e vazhduam deri në aeroportin e Xhides. Unë jo se nuk e kisha shijuar Mekën. Jo se nuk e dëshiroja kthimin prapë aty (se sytë nuk ngopeshin



duke e shikuar xhaminë e parë të ndërtuar në këtë planet), por sytë kishin mall edhe për nënën, babanë, gruan e vajzat. Sytë kishin mall edhe për Kosovën. Unë jam bir i Kosovës. Zoti ma kishte bërë nasib të lind në Kosovë, prej prindërve shqiptarë. Ndoshta kurrë nuk do ta kuptoj urtësinë e kësaj, mirëpo thellë në vete e prej kohësh e kam përjetuar se kam një amanet ndaj vendit dhe njerëzve të mi. Ta dua vendin tim dhe njerëzit e mi, dhe të punoj gjithë jetën për ta. Të paktën që mos t'ua shpërdoroj sakrificën paraardhësve e dëshmorëve, që për Kosovën qenë shembujt më vetëflijes që njohu historia njerëzore.

Nga ky diskutim Bashkimit i dukej një gëzim në fytyrë. E si mos të kënaqej ai që në luftën e fundit, si ushtar i UÇK-së, Kosovës kishte qenë i gatshëm t'ia falte edhe jetën, ndërsa tani ishte invalid i luftës?!

Kur arritëm në aeroportin e Xhides, rreth orës 15:10, për pak kohë na ra të prisnim në hapësirat VIP. Aty miqtë tanë sauditë sakaq porositën kafe arabe, ëmbëlsira e hurma suker. Shpeshherë ndërhyenin në shërbimin e kamerierëve, duke e marrë kupën e kafesë dhe duke na shërbyer vetë. Me këtë veprim sikur dëshironin të na e dëshmonin një nivel më të lartë të mikpritjes. Një mikpritjeje arabe që kurrë më parë nuk e kisha njohur se ishte kaq e ruajtur dhe e sakralizuar njëkohësisht. Më vonë edhe m'u kujtua se ky ishte vendi i Ibrahimit, alejhi selam. Atij që kishte fituar epitetin Halilullah (I dashur i Zotit) përveç tjerash, edhe për shkak të mikpritjes e bujarisë së shprehur ndaj mysafirëve vetëm për hir të Zotit.

Naifi, shoqëruesi ynë arab, ishte ulur përballë meje. Pasi na shikoi të gjithëve, u kthye drejt meje, nxori telefonin e tij dhe, pas pak, m'u drejtua me fjalët:

- Am i tllrshtual, - ndërsa priste prej meje t'i përgjigjesha.

Nuk po e kuptoja fare se ç'po thoshte. Me arabishten time nuk e dekodoja dot atë fjali që po e thoshte. Vetëm pasi e përsëriti dy-tri herë, dhe pasi u koncentrova më shumë ta kuptoja se ç'po thoshte, arrita ta zbërtheja. Po më thoshte "Jam i trishtuar", në kuptimin i mërzitur, sepse ne po shkonim. Sytë e tij tregonin se ai nuk po shtirej.

Në ndërkohë na paralajmëruan të bëheshim gati për t'u nisur drejt aeroplanit. Me Naifin u përshëndetëm me premtimin për t'u takuar shumë shpejt në Kosovë. Dhe unë i besoja premtimit të tij. Sepse e dija se arabët e kanë një fjalë të urtë, e që thotë se *premtimi është borxh*. Dhe, besimtari po që e shlyen borxhin.

Një vështrim filleve të literaturës islame në gjuhën shqipe në Kosovë (2)

Arbin Ahmeti

“BULETINI INFORMATIV” DHE “TAKVIMI” – PERIODIKËT E PARË ISLAMË NË GJUHËN SHQIPE

Fillimi i botimeve nga ana e Bashkësisë Islame të Kosovës, në vitin 1962, me revistën e saj “Buletini Informativ” (1962), “Takvimi” (1970), dhe “Edukata Islame” (1971), hyn në një fazë të re.

Nisjen e botimit të “Buletinit Informativ”, e bëri Shoqata e Ylemave. Publikimi i tij bëhej çdo tre muaj, që dilte në dy gjuhë, shqip dhe serbokroatisht, e i cili tregonte aktivitetet e Kryesisë së BI-së dhe të organeve të saj. Si për nga emri, ashtu edhe për nga përmbajtja, “Buletini”, sipas studiuesve H. Hoxha dhe R. Shkodra, më tepër kishte karakter informativ për punën organizative dhe veprimtarinë administrative të Shoqatës dhe të Bashkësisë Islame në Prishtinë. Mirëpo, nga viti 1969, e deri në vitin 1970, “Buletini” u botua për herë të fundit, ndërsa më pas merr një dimension tjetër, dhe përveç të dhënave zyrtare, tani filloi të botonte edhe tema me karakter fetar. Kështu që, “Buletini” nga një organ informativ, shndërrohet në një hapësirë ku fillojnë ta sprovonjë veten nismëtarët e publicistikës islame shqipe në Kosovë, si: Haxhi

Sherif Ahmeti, H. Hajrullah Hoxha, H. Muha bajramimet Islami, Feti Mehdiu, H. Ismailhaki Ustaibo, H. Jetish Bajrami, H. Rashid Osmani etj.,¹ disa prej të cilëve do të mbesin për dekada të tëra bartës të penës kryesore të publicistikës islame shqipe në trojet tona.

Në “Buletin” botoheshin edhe disa tema fetare, kryesisht të përkthyer nga revista “Glasnik”, që botohej në Sarajevë. “Buletini” viteve të fundit të daljes së tij u botua vetëm në gjuhën shqipe, dhe u redaktua prej myderrizit të njohur, H. Sherif ef. Ahmetit.

Duhet ritheksuar se atëbotë redaksia e “Buletinit” u ballafaqua me mungesë të madhe të bashkëpunëtorëve. Në lidhje me këtë, në raportin e punës së shoqatës së Ylemave, në vitin 1970, përveç tjerash, thuhet: “Nga ana tjetër, gati të gjithë numrat e shtypur deri tani të “Buletinit” kemi lutur që të lajmërohen korrespondentë, dhe të na dërgojnë materiale që do të mundemi t’i botojmë, natyrisht nëse na përgjigjen me përmbajtjen e tyre, mirëpo deri më sot kemi vetëm dy korrespondentë, dhe ata janë: H. Jetish ef. Bajrami, imam

“Buletini” nga një organ informativ, shndërrohet në një hapësirë ku fillojnë ta sprovonjë veten nismëtarët e publicistikës islame shqipe në Kosovë, si: Haxhi Sherif Ahmeti, H. Hajrullah Hoxha, H. Muha bajramimet Islami, Feti Mehdiu, H. Ismailhaki Ustaibo, H. Jetish Bajrami, H. Rashid Osmani etj



Ballina: “Buletini informativ” (1-2, 1964)



Ballina: "Takvimi për vitin" (1970)

kryesor nga Gjilani, dhe Hajrullah ef. Hoxha, imam nga Mitrovica".²

Në vazhden e aktivitetit të vet, Shoqata e Ylemave, po ashtu duke pasur parasysh rëndësinë e fjalës së shkruar, nuk u ndal vetëm me botimin e "Buletinit", por në vitin 1970 e botoi edhe "Takvimin" e parë në gjuhën shqipe. Shoqata e Ylemave, në krye me H. Sherif Ahmetin, në vitin 1969, e botoi "Takvimin – Kalendarin" për vitin 1970, të përgatitur në mënyrë profesionale prej H. Hajrullah Hoxhës, dhe është koordinuar për trevën e Kosovës, sipas orës allafranga.³ Mirëpo në kalendar, përveç pjesëve të tjera, janë botuar tema të ndryshme, kryesisht nga etika islame, jurisprudenca, tradita e Pejgamberit, a.s., komentimi i Kuranit, besimi islam, shkrime prej autorëve të ndryshëm.

"Takvimi" i parë u botua në formë të vogël, libër xhepit, në tirazh 10.000 ekzemplarë, me 36 faqe, me këtë përmbajtje: Parathënia e autorit, tabelat kalendarike për 12 muaj me të dhënat për kohën e imsakut dhe për pesë kohët e namazit, dhe në fund një artikull me titull "Ahmarrja", shkruar prej H. Sherif Ahmetit.⁴

Në ballinën e kësaj botimi të parë të "Takvimit", është paraqitur xhamia e Sinan Pashës, të cilin veprim e quajmë shumë me rëndësi dhe me peshë të veçantë.

Mirëpo, vlen të theksohet se nga viti 2002 "Takvimi" botohet në format të librit, dhe me treqind e më shumë faqe, kurse pjesa e kalendarit botohet edhe në broshurë të veçantë. Punimi me titullin "Namazi në teori dhe praktikë me fotografi", i cili u botua në "Takvim" në vitin 1979, pati shumë kërkesa për ribotim, prandaj u ribotua dy herë. "Takvimi" gjatë viteve 1986 dhe 1994, e sidomos në këtë të fundit, tirazhin e botimit e arriti në një numër rekord, diku 36.000 ekzemplarë.

Kjo revistë ka qenë një dritare e rëndësishme e përhapjes së mësimave fetare te ne. "Takvimi" po e vazhdon misionin për të cilin është nisur që nga themelimi, duke dhënë kështu një kontribut te besimtarë, pa marrë parasysh vështirësitë nëpër të cilat ka kaluar kohë pas kohe dhe që i janë paraqitur në rrugëtimin gjatë viteve. Dihet mirë se botimi i "Takvimit" e ka bërë emrin dhe historinë e vet, duke depërtuar në çdo familje myslimane, duke e marrë parasysh faktin se kjo është një nga revistat e para islame në gjuhën shqipe.

REVISTA "EDUKATA ISLAME" (1971)

"Edukata Islame" është revista e parë islame në gjuhën shqipe, e cila filloi të dalë qysh në vitin 1971, kur Kosova ishte në Federatën jugosllave, e që në atë kohë iu njohën disa të drejta dhe e fitoi autonominë e saj. Bashkësia Islame e Kosovës e ndjeu përgjegjësi që për nevojat e besimtarëve ta botonte revistën fetare islame "Edukata Islame", e cila doli çdo tre muaj. "Edukata Islame" ishte e vetmja revistë fetare islame që ishte në gjuhën shqipe, ndërsa një punë kolosale po bënin ulemaja e vendit, për nxjerrjen e kësaj reviste në dritë. Në fillim ishte kryekëput me karakter fetar, siç na tregon edhe titulli i revistës "Edukata Islame", revistë fetare. Numri i parë i revistës iu besua H. Sherif ef. Ahmetit, i cili ishte edhe nismëtar i kësaj reviste islame, në të cilën kontribuoi për një kohë të gjatë me shumë shkrime të tijat.

H. Sherif ef. Ahmeti ishte një intelektual i përkushtuar, dhe, edhe me atë pak kuadër që ishte në kohën e tij, dinte si ta vendoste "Edukatën Islame" në binarë të sigurtë, ashti që kjo revistë u njoh jo vetëm në Kosovë, por edhe në të gjitha trojet shqiptare të ish-Jugosllavisë, sikurse në: Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, po edhe në vende të tjera. Mirëpo, krahas temave fetare islame, në këtë revistë mësohen edhe njohuri të tjera shkencore me vlera universale, e sidomos me përmbajtje edukative e arsimore, ide të ndryshme me synime dhe tema të reja, më pak të njohura dhe të studiuar, e që kanë vlera morale, filozofike, historike, gjuhësore, etike, kulturore, artistike etj.⁵

"Takvimi" i parë u botua në formë të vogël, libër xhepit, në tirazh 10.000 ekzemplarë, me 36 faqe



Ballina: "Edukata Islame" (1971)

H. Sherif ef. Ahmeti i afroi rreth "Edukatës..." ato pak kuadro që ishin në Kosovë, e që e njihnin mjaftueshëm kulturën e shkrimit në gjuhën shqipe, sikurse ishin: Hajrullah Hoxha, Avni Aliu, Jetish Bajrami, Bajrush Ahmeti, Jashar Jashari, Ibrahim Spahiu, Rashit Osmani, Resul Rexhepi, Nexhat Ibrahim, Miftar Ajdini, Mujdin Ahmeti, Ferid Berisha, Qazim Qazimi, Emin Behrami, e ndonjë tjetër.⁶ Jo që nuk kishte hoxhallarë të tjerë të dijes, mirëpo nuk e kishin traditën e shkrimit në gjuhën shqipe, meqë ishin shkolluar jashtë vendit ose e kishin kultivuar shkrimin e gjuhës shqipe me grafikë arabe-osmane, dhe kjo e bënte të veten. Megjithatë, H. Sherif Ahmeti arriti të kishte një numër të vogël rreth vete. Në revistën "Edukata Islame", deri në fillim të viteve të '90-ta, më së shumti kishte tematikë fetare, sikurse, p.sh.: tefsir, akaid, thuajse gjithmonë ishin këto rubrika që i mbante H. Sherif ef. Ahmeti, e pastaj kishte edhe kontribute të tjera nga ahlaku, hadithi, fikhu, historia islame, po edhe nga lëndët e tjera fetare. Në këtë revistë një kënd shumë me rëndësi të veçantë iu kushtua edhe aktiviteteve të Medresesë së Mesme "Alaudin".

Një segment shumë i rëndësishëm i "Edukatës..." është se, përmes përkthimeve nga gjuhë të huaja, kjo revistë ka botuar edhe kontribute të penave të shquara të botës islame, sikurse: Sinanudin Sokolloviq, Husein Xhozo, Muhamed Gazali, Muhamed Tantavi,

Jusuf Kardavi, Mustafa Mahmud, Hasan Kaleshi, Enes Kariq, Muhamed Sharavi etj. Duhet theksuar këtu edhe faktin se shkrimet e botuara nga fushat e islamologjisë në revistën "Edukata...", përveçse e shënojnë hapin e parë në këtë fushë, sot ato paraqesin edhe vlera të shtruar në literaturën islame në gjuhën shqipe, dhe janë me rëndësi të posaçme për bibliotekën tonë, sidomos për qëllime hulumtuese, studime historike e kritike.⁷

PËRFUNDIM

Shtypi islam në gjuhën shqipe ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm gjatë gjithë periudhave në trojet tona, si një thesar i çmuar. Nëse matet përmbajtja dhe tematikat tek "Ilmihali", "Mësimi i shkurtër mbi namazin dhe Jasini sherifi", dhe pastaj te "Buletini Informativ", "Takvimi" dhe "Edukata Islame", mund të themi se lëndët fetare e përbëjnë pjesën më të madhe të materialeve të botuara në këto revista, dhe kjo është e kuptueshme.

Prandaj, mund të theksojmë se literatura islame dhe shtypi islam gjatë asaj kohe e ka arritur efektin shumë pozitiv të besimtarët në trojet shqiptare, sikurse, p.sh.: Në edukim e brezave, arsimim, duke i pajisur me gjërat thelbësore fetare islame etj.

E gjithë kjo u arrit me anë të punës së myderrizëve dhe hoxhallarëve tanë, të cilët dhanë një kontribut për daljen në dritë të literaturës në gjuhën shqipe, e që kështu e hapën edhe rrugën më pas edhe për shumë ndërmarrje e punë të mëdha në këtë drejtim, aq sa në vitin 1985 do ta kemi të përkthyer në gjuhën shqipe, për herë të parë, edhe komplet Kuranin fisnik. Sot literatura islame në gjuhën shqipe që botohet nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës po shtohet çdo ditë e më shumë, si nga cilësia, ashtu dhe nga sasia, po edhe konform kërkesave dhe nevojave të besimtarëve të saj në kohën që po e jetojmë.

"Edukata Islame" ishte e vetmja revistë fetare islame që ishte në gjuhën shqipe, ndërsa një punë kolosale po bënin ulemaja e vendit, për nxjerrjen e kësaj reviste në dritë.

1 Hajrullah Hoxha, *Shtypi Islam dje, sot dhe nesër; Përmbledhje kumtesash nga konferenca shkencore (Prishtinë, 23-24 maj 2003)*, Prishtinë, 2005, f. 12.

2 Hajrullah Hoxha, *Literatura Islame në gjuhën shqipe në Kosovë (1957-2017), Fillet, Tradita, Sfidat dhe Sukseset, Përmbledhje kumtesash nga tryeza shkencore (Prishtinë, 27 dhjetor 2017)*, Prishtinë, 2019, f. 77-78.

3 Ibid, f.16.

4 Hajrullah Hoxha, *Literatura Islame në gjuhën shqipe në Kosovë (1957-2017), Fillet, Tradita, Sfidat dhe Sukseset, Përmbledhje kumtesash nga tryeza shkencore (Prishtinë, 27 dhjetor 2017)*, Prishtinë, 2019, f. 78.

5 Ramadan Shkodra, *Bibliografi e revishtës "Edukata Islame" (1971-2016)*, Prishtinë, 2017, f. 8; Akademik Jashar Rexhepagiq, *Shtypi Islam dje, sot dhe nesër; Përmbledhje kumtesash nga konferenca shkencore (Prishtinë, 23-24 maj 2003)*, Prishtinë, 2005, f. 44.

6 Ramadan Shkodra, *Bibliografi e revishtës "Edukata Islame"*, po aty.

7 Po aty.

Legjislacioni Osman për Ruajtjen e Rendit Publik në Hapësirën e Kosovës gjatë viteve 1700-1800

Prof. Ass. Dr. Agron Islami

Sipas ligjit të kohës, kriminel konsiderohej një individ që e prishte rendin e brendshëm shtetëror pa të drejtë, dhe i cili me forcë e përvetësonte pasurinë e tjetrit, bashkëpunonte me grupe banditësh, kryente vjedhje, apo vrasje, sulmonte karvane me mallra etj.

HYRJE

Ruajtja e rendit dhe e qetësisë nëpër provinca osmane ishte njëra nga detyrat parësore të administratës së kohës. Kështu, qysh nga konsolidimi i Devletit/Shtetit osman janë hartuar kanunname të detajuara, të cilat parashihnin edhe dënime për shkelësit e ligjit. Në njërën nga kanunnamet e para të hartuar në kohën e Sulltan Mehmetit II (1451- 1481) specifikohet se: “Nëse një person e vret një qenie njerëzore, do të aplikohet hakmarrja me dënim me vdekje (Kisas)”, dhe nuk do të arkëtohet asnjë gjobë në të holla. Nëse (kadiu) konstaton se vrasja nuk e plotëson kriterin për dënimin me vdekje, atëherë aplikohet gjoba me pagesën e gjakut (me këtë rast). Nëse vrasësi është i pasur dhe ka në pronësi pronë në vlerë mbi 1000 akça, dënohet me 000 4 akça; nëse është mesatar dhe ka prona në vlerë 600 akça, gjobitet me 2007 akça; nëse i takon klasës së varfër, gjobitet me 1009 akça, dhe 50 akça për personin në kushte shumë të rënda varfërie (neni 41). “Nëse janë vrarë dy e më shumë persona, dhe nëse në rastin e konfliktit hakmarrja është zbatuar, me këtë rast vullneti i Sheriatit (Legjislacionit Islam) është zbatuar, dhe nuk do të gjobitet askush. Nëse hakmarrja nuk është quar në vend, vrasësi do të urdhërohet nga ana e kadiut që ta paguaj gjakun (dijet); (neni 42). “Nëse një person godet një person tjetër me shigjetë apo thikë, dhe e plagos atë duke e bërë të varur nga shtrati, gjoba për sulmuesin e pasur është 200 akçe, ndërsa 100 akçe për sulmuesin me kushte mesatare (ekonomike), dhe 50 akçe për sulmuesin e

varfër.” (neni 45).¹ “Nëse një person gjendet i vdekur brenda një lagjeje (qyteti), ose brenda një fshati, ose nëse bëhet një sulm i papritur ndaj një karvani dhe lëndimi ose vjedhja/grabitja është kryer diku ndërmjet fshatrave, (banorët në afërsi të fshatit) detyrohen t'i gjejnë kriminelët. Nëse (ata nuk gjenden), por ka të dyshuar, rasti do të shqyrtohet, dhe ata (të dyshuarit) do t'i kompensojnë humbjet. Nëse nuk ka të dyshuar, atëherë banorët e lagjes apo të fshatit obligohen t'i bëjnë kompensimet. (neni 77).²

Studimet mbi kodin penal osman kanë ofruar fakte se prishës të qetësisë, respektivisht kryesit e veprave penale, kryesisht i takonin nënshtetaseve osmanë, apo edhe klasës së zyrtarëve shtetërorë osmanë dhe, sipas ligjit të kohës, kriminel konsiderohej një individ që e prishte rendin e brendshëm shtetëror pa të drejtë, dhe i cili me forcë e përvetësonte pasurinë e tjetrit, bashkëpunonte me grupe banditësh, kryente vjedhje, apo vrasje, sulmonte karvane me mallra etj. Rastet e tilla në legjislacionin osman trajtoheshin si Eshkējallëk (Eşkîyâ)³, e që nënkuptoheshin individë apo grupe bandash që i sulmonin njerëzit e pafajshëm, i plaçkitnin, i vrisnin, i kidnaponin dhe bënin vepra të tjera të ngjashme, e që, sipas ligjit osman, ishin të dënueshme. Ndërsa, në rastet kur kishte lëvizje kundrejt sistemit shtetëror (qoftë edhe kundër taksave), ato konsideroheshin si Isjâne, e që nënkuptonte (kundërshtimin dhe) kryengritjen kundër sistemit shtetëror, dhe ishin të dënueshme me vdekje.⁴

Sa i përket mënyrës së dënimeve, vlen të përmendet se bëheshin sipas procedurës në fuqi: fillimisht hetohej rasti, pastaj kapej fajtori dhe aplikohesh dënimi sipas legjislacionit në fuqi, shpeshherë edhe duke kërkuar mendim profesional nga institucioni i Shejhul Islamit (Instanca më e lartë e drejtësisë).⁵ Siç u pa edhe më lart, në rastet e vrasjeve, po ashtu edhe të kryengritjeve kundër shtetit, parashihej dënimi me vdekje. Mirëpo, nga dokumentet e proveniencës osmane në shek. XVIII nuk kemi hasur ndonjë dënim me vdekje që është aplikuar në Kosovë gjatë asaj kohe.

VENDIME TË DIVANIT OSMAN NË RAPORT ME PRISHËSIT E RENDIT NË KOSOVË GJATË SHEK. XVIII

Që nga ditët e para të shtrirjes së sundimit në hapësirën e Kosovës, osmanët ishin përballur me grupe që e prishnin rendin publik.⁶ Megjithatë, kishte kohëra dhe momente kur këto shkelje bëheshin përditshmëri, siç është rasti me luftërat e vazhdueshme osmane me fuqitë evropiane të kohës, në veçanti ato të shek. XVII, të njohura si luftëra austro-osmane (1638-1699), të cilat krijuan një terren edhe më të përshtatshëm për grupe të *eshkëja-ve*.

Në vendimin e 16 gushtit kërkohet prej Kadiut të Prishtinës që të dëmshpërblehen të dëmtuarit, duke ua kthyer kurushët, dhe çështja e Zaimit të trajtohet mbi bazën e ligjeve në fuqi.

Duhet theksuar se vendimet e marra në emër të Divanit (*Divân-ı Hümâyûn*), i cili ishte Këshilli i Lartë Ministror, dhe që drejtohej prej vetë Sulltanit, vinin si rezultat i ankesës së qytetarëve të Kosovës, nënshtetas të Devletit Osman (*Devlet-i Osmaniyye*). Gjithashtu, vlen të përmendet se forma e vendimmarrjes ishte e tillë që, në tekst përshkruhej ankesa e ardhur prej qytetarit/qytetarëve, dhe në fund, në formë urdhërore, kumtohej vendimi për ekzekutim. Ekzekutimin duhej ta bënin zyrtarët lokalë, prandaj edhe në fillim të shkresës theksohej titullari që do ta ekzekutonte vendimin në fjalë: për shembull: “Urdhër Kadiut dhe Mytesarrit të Prishtinës, për ekzekutimin e vendimit si në vijim.”

Këtyre vendimeve të shkruara ua rrit vlerën shkencore edhe më shumë fakti se i shpjegojnë edhe rrethanat dhe shkaqet pse dhe si ka ardhur deri te marrja e vendimeve në fjalë. Njëherësh, tematikat e këtyre vendimeve na mundësojnë të kuptojmë se veprat që kanë të bëjnë me vrasje, grabitje, dhunë dhe të ngjashme, më shumë kryheshin nga grupe cubash që vinin nga zonat e thella, respektivisht nga fshatarët dhe, sigurisht që edhe terreni ishte më i përshtatshëm për këta individë apo grupe individësh. Njëri nga rastet e tilla





është me *eshkëjat*/banditët e zonës së Gjakovës, siç theksohet në ankesën e Aliut (i cili vinte po ashtu nga kjo zonë) se, banditët: Balo, Haso dhe Demë Hyseni, banorë të fshatit Prijepol, e sulmuan familjen e tij, dhe me këtë rast vodhën kursimet e 700 kurushëve, bagëtitë dhe ushqime. Përveç Aliut, i cili ia kishte arritur të arratisë, vëllai i tij, Mehmeti dhe bijtë e Omerit, Mustafai dhe Hamdiu, kishin mbetur të vdekur. Pas shqyrtimit të ankesës në fjalë, në dhjetor të vitit 1743, Divani Osman, me një vendim drejtuar Mytesarrit të Sangjakut të Dukagjinit dhe Kadiut të Gjakovës, kërkonte që një orë e më parë fajtorët të arrestoheshin, dhe njëherësh në vendim kërkohet që bagëtia dhe gjërat e tjera materiale të vjedhura t'i ktheheshin Aliut⁷.

Një vendimi tjetër i muajit qershor të vitit 1744 ka të bëjë me një histori të trishtë të dy zonjave të veja nga kasabaja e Vëlqëtrinės (Vushtrrisë)⁸, të cilat ankoheshin ndaj Eshkëjave, me banim në Vushtrri, me emrat Mahmut, Mehdi dhe Ibrahim, që sipas zonjave ankuese “këta ishin pjesëtarë të grupit të udhëhequr prej prishtinasit Ago dhe Jahja”. Këta të parët, në vitin 38/1737 i kishin sulmuar shtëpitë e fshatrave Sibocë e Brezë, ku përveç plaçkës, kishin vrarë dhe plagosur shumë fshatarë. Në vendimin e lëshuar 6 vjet më vonë, prej ish vezirit (ministrit) Abdullah Pashai, dhe kadiut të Prishtinës, kërkohet që fajtorët të kapen dhe të dënohen sipas ligjeve të Sheriatit⁹.

SHKELJET TË PERSONAVE ZYRTARË OSMANË

Boshllëku shtetëror i krijuar pas luftërave austro-osmane (1683-1699) në Kosovë u keqpërdor prej mytasarritëve, zaimëve, kadilerëve dhe zyrtarëve të tjerë osmanë që vepronin në Kosovë. Mytesarriti i Prizrenit, Hasan Pasha ishte njëri

prej atyre zyrtarëve të taksave të obligueshme shtetërore, pra që duhej t'i vilte, dhe ky ua shtoi edhe disa lloje të taksave (bidate), e që nuk parashihehin në politikat e shtetit. Madje, njëren nga taksat e quajti *ikramijje*, apo taksë për shërbime. Ankesa e ushtruar nga ana e qytetarëve prizrenas, më datë 13 nëntor 1747, merret në shqyrtim nga Divani, dhe për rastin e Mytesarritit në fjalë lëshohet një vendim nga ana e përfaqësuesit të zyrës së Sekretariatit të Divanit, Mustafa Efendiut, për shkarkimin e Hasan Pashës, dhe në të njëjtin vendim thuhet se në vend të tij është emëruar Salih Pashai¹⁰.

Një vendim me tematikën e keqpërdorimit të detyrës nga ana e zyrtarit mban datën e vitit 1738. Për rastin në fjalë ishin ankuar banorë nga komuniteti jomysliman të zonës së Moravës (Gjilani i sotëm). Respektivisht, bëhet fjalë për Nikon, Istankon dhe Marikorin, të cilët ankoheshin ndaj Zaimit të Prishtinës, i cili gjatë mbledhjes së tatimit të Ispençës¹¹, në mënyrë jo të ligjshme, kishte kërkuar edhe dy kurush më shumë nga shuma që parashihej në ligjet e taksave. Në vendimin e 16 gushtit kërkohet prej Kadiut të Prishtinës që të dëmshpërblehen të dëmtuarit, duke ua kthyer kurushët, dhe çështja e Zaimit të trajtohet mbi bazën e ligjeve në fuqi.¹²

BURGU DHE SYRGJYNOSJA, SI MJETE TË DËNIMIT NË KOSOVË

Duke qenë se sixhilatet (defterët e kadilerëve) e sangjaqeve që shtriheshin në hapësirën e Kosovës mungojnë, këtë boshllëk dokumentar sadopak e mbulojnë fondet e vendimeve të Divanit. Shembujt e paktë që kemi hasur në këto fonde na bëjnë të kuptojmë se njëri nga dënimet më të rënda në këtë kohë ishte burgosja në kështjellë, që nënkuptonte izolim total për kohë të caktuar, dhe syrgjynosja. Njëherësh, nga këto shkresa zyrtare me vendime vërehet qartë se kështjellat: e Prizrenit, e Novobërdës dhe e Dukagjinit ishin përdorur si vend burgimi për shkelësit e ligjit. Një shënim i vitit 1711 flet për burgosjen e Ismailit, i cili ishte djali i Çavushit të Prizrenit, Sylejmanit. Burgosja kishte ardhur pas kërkesës së këtij të fundit (Sylejmanit). Në vendimin e shkresave të nxjerra nga këshilli ministror thuhej se “Ismaili është kryengritur kundër babait të tij, Çavush Sylejmanit, me ç’rast pas vetes ka tërhequr edhe argatët, Ali Lamin me të bijtë, dhe po ashtu këtyre u është bashkangjitur edhe grupi i eshkëjave/bandës Hysejini dhe Mustafai me vëllezërit e tij, duke e bastisur shtëpinë e Çavushit; këta kanë plaçkitur ushqimet që do të përdorshin për ekspeditën ushtarake shtetërore, dhe njëherësh e kanë mbyllur në shtëpi të vëllain e Çavushit, Nuhiun, si dhe e kanë plagosur rojtarin e ushqimeve me emrin Hysejn”. Në dokument specifikohet se Çavushi, kishte bërë kërkesë që Ismaili të burgoset në kalanë e Prizrenit, me një burgim që do të zgjaste deri në përmirësimin e sjelljes (ıslah-ı nefis) së tij ndaj zyrtarit shtetëror.¹³

Edhe pse shekulli i XVIII ishte një kohë jo e përshtatshme politike për Devletin osman, çështja e funksionimit të komunikimit në mes të qytetarit dhe qendrës ishte mjaft funksionale për kohën.

kishte arritur që t'i largoj dy ajanët, Mustafanë dhe Sejjid Sadeddinin, dhe në vend të tyre, me dokumente të rrejshme, e kishte imponuar djalin e tij, Shemseddinin, si ajan të Novobërdës. Mbi këtë zhvillim banorët, të cilët i kishin dhënë mbështetje dy ajanëve, kishin ushtruar ankesë në Stamboll. Për rezultat, pas shqyrtimit të ankesës në fjalë, Divani merr vendim që rastin ta hulumtojë një zyrtar i Sarajit, me emrin Jusuf. Hulumtimet e këtij të fundit vërtetuan ankesën e banorëve të Novobërdës, dhe si përfundim prerazi u vendos që Nuredini dhe shokët e tij të gjykohen për shkelje të ligjeve të Sheriatit, dhe nëse edhe pas kësaj nuk ndërgjegjësohen dhe vazhdojnë në shkelje të njëjta, atëherë të internohen në një vend më të largët (diyâr-î ahire).¹⁴

Konkluzion

Vendimet e Divanit osman shpërfaqin faktin se një nga problemet sociale në Kosovën e shekullit XVIII ishte edhe prishja e rendit publik, e cila manifestohej me vrasje, vjedhje, plaçkitje etj., veprime të cilat preknin jetën e qytetarit/nënshtetasit osman të Kosovës.

Individët që e prishnin rendin i takonin shtresës më të ulët të shoqërisë, e deri te zyrtarët. Organi i drejtësisë osmane këto raste i kishte trajtuar si të izoluara, prandaj edhe jo rastësisht në vendimet e Divanit është përdorur termi Eshkëja/banditëri, dhe jo Isjân/kryengritje. Megjithatë, shembujt e mësipërm na e japin një pasqyrë të formës dhe të mënyrës së dënimeve që janë aplikuar në rastin e Kosovës dhe, siç kemi parë, zyrtarët apo ish zyrtarët shtetërorë dënoheshin me burgim në kështjellë dhe syrgjynosje.

Duke qenë se këto vendime erdhën si rezultat i ankesave të qytetarëve, mund të konstatohet se edhe pse shekulli i

XVIII ishte një kohë jo e përshtatshme politike për Devletin osman, çështja e funksionimit të komunikimit në mes të qytetarit dhe qendrës ishte mjaft funksionale për kohën.

BURIME ARKIVORE

- BOA. A. DVNS. AHKR. d. 2.
- BOA. A. DVNS. AHKR. d. 4.
- BOA. A. DVNS. AHKR. d. 6.
- BOA. A. DVNS. AHKR. d. 4.
- BOA. A. DVNS. MHM. d. 117.
- BOA. A. DVNS. AHKR. d. 25.

BIBLIOGRAFI

- Ahmet Mumcu, *Osmanlı Devletinde Siyaseten Katl*, Ankara 1963.
- Agron Islami, "Aspekte të jetës socio-ekonomike dhe politike në Kosovë gjatë shekullit XVIII sipas ankesave dhe kërkesave të qytetarëve", *Kosova* nr. 45 (2020), 51-65.
- Dritan Egro, *Ligji Osman ndër Shqiptarët e Mesjetës së Vonë*, Tiranë 212.
- *Dokumente të Shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë* (Përgatitur prej Injac Zamputit dhe Selami Pulahas), vëllimi IV, Tiranë 1990.
- Mehmet Öz, "Modernleşme-öncesinde Osmanlı Toplumunda Eşkiyalık Hareketlerinin Niteliği ve Özellikleri", *Osmanlıdan Günümüze Eşkiyalık ve Terör*, (edit. Osman Köse), (Samsun 2017), 11-21.
- *Qëndresa e Popullit Shqiptar kundër Sundimit Osman nga shekulli XVI deri në fillim të shekullit XVIII* (Përgatitur nga Selami Pulaha), Tiranë 1978.
- *Relacione dhe Dokumente për Historinë e Shqipërisë* (Përgatitur prej Injac Zamputit), Prishtinë, 2018.
- Skender Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVIII*, Prishtinë 1982.
- Şemdeddin Sami (Sami Frashëri), *Kamûs-ı Türkî*, İstanbul 1317 (1899).
- Uriel Heyd, *Studies in Old Ottoman Criminal Law*, Oxford University Press 1937.
- 1 Uriel Heyd, *Studies in Old Ottoman Criminal Law*, Oxford University Press 1937, p. 105-107.
- 2 Po aty, p. 115. Për informacion më të zgjeruar shih: Dritan Egro, *Ligji Osman ndër Shqiptarët e Mesjetës së Vonë*, Tiranë, 212, p. 72-73!
- 3 Sami [Sami Frashëri], *Kamûs-ı Türkî*, İstanbul 1317 [1899], p. 781. Megjithatë, një pjesë e mirë e studiuësve e ngatërojnë banditizmin (eshkējallëkun) me kryengritjen, e cila në administratën osmane specifikohet me shprehjen isjan (isyân), apo Asi (Asî). Kjo vërehet edhe në hyrjen e vëllimit me dokumente osmane të përgatitura prej Selami Pulahas, *Qëndresa e popullit shqiptar kundër sundimit osman nga shekulli XVI deri në fillim të shekullit XVIII*, Tiranë, 1978; Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë (Përgatitur prej Injac Zamputit dhe Selami Pulahas), vëllimi IV, Tiranë, 1990, *Relacione dhe Dokumente për Historinë e Shqipërisë* (Përgatitur prej Injac Zamputit), Prishtinë, 2018.
- 4 Ahmet Mumcu, *Osmanlı Devletinde Siyaseten Katl*, Ankara, 1963, p. 53.
- 5 Mehmet Öz, "Modernleşme-öncesinde Osmanlı Toplumunda Eşkiyalık Hareketlerinin Niteliği ve Özellikleri", *Osmanlıdan Günümüze Eşkiyalık ve Terör*, [edit. Osman Köse], Samsun, 2017, p. 13.
- 6 *Qëndresa e Popullit Shqiptar kundër Sundimit Osman nga shekulli XVI deri në fillim të shekullit XVIII* (Përgatitur prej Selami Pulahas), Tiranë, 1978; Skender Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVIII*, Prishtinë, 1982, p. 482-493.
- 7 BOA. A. DVNS. AHKR. d. 2, vendimi nr. 151.
- 8 Nga këtu e tutje Vushtrri.
- 9 BOA. A. DVNS. AHKR. d. 4, vendimi nr. 466.
- 10 BOA. A. DVNS. AHKR. d. 6, vendimi nr. 41.
- 11 Taksë që merrej prej jomyslimanëve të Ballkanit.
- 12 BOA. A. DVNS. AHKR. d. 4, vendimi nr. 444. Në lidhje me keqpërdorimet e detyrës zyrtare shih: Agron Islami, "Aspekte të jetës socio-ekonomike dhe politike në Kosovë gjatë shekullit XVIII sipas ankesave dhe kërkesave të qytetarëve", *Kosova* nr. 45 (2020), p. 56-58!
- 13 BOA. A. DVNS. MHM. d. 117, vendimi nr. 43.
- 14 BOA. A. DVNS. AHKR. d. 25, vendimi nr. 415.

Koncepti i Gazasë në shtetin Osman

Agon Krasniqi

Osmanët e ngrenë shtetin e tyre dhe e shndërruan në një perandori, përmes bashkimit të Anadollit mysliman me Ballkanin e krishterë.

Gazaja ishte një ndër faktorët, ose mund të themi faktori kryesor, për themelimin e Bejllëkut Osman.¹ Gazaja ishte një ideologji fetare, e që nënkuptonte luftën e shenjtë të Islamit. Ata që vraponin pas gazasë, quheshin gaziinj, apo veteranë të Islamit. Ndër gaziinjët qëndronte edhe themeluesi i principatës osmane, Osman Alp, apo Osman Gazi, i cili shumë herë cilësohet edhe si Sultan Osman Han-i Evvel-i Ebu'l Muluk, apo Sulltan Osmani, Hani i parë, ati i sundimtarëve, duke iu referuar pikturës së Osman Gaziut, të paraqitur nga Kapidagli Konstandin.²

Gazaja si ideologji ishte e përhapur në rajonin e Anadollit, kryesisht pas disfatës së Kosedagit (Koshedagit)³, në vitin 1243, të turqëve selxhuk, prej mongolëve dhe, në anën tjetër nga inkursionet ushtarake të kryqtarëve. Mbi këto elemente gaziu më i madh i kohës qëndronte Osman beu, i cili do të emërohej edhe si Uç bej, apo prijës kufitar nga ana e sulltanit selxhuk. Pas vdekjes së Yavlak Arslanit (beut të Çobanogullarëve), në vitin 1292, gjatë betejës së Kastamonit, atëherë lidershpi kryesor i gaziut do të ishte në kampin dhe qytetin e Osmanit, kryesisht në zonën e Sogutit, zonë kjo që shërbente si rezidencë dimërore për Kajitë, ndërsa Domaniçu si kullotë verore.⁴

Në aspektin gjenealogjik, parardhësit e Osmanit ishin ata që e udhëheqnin gazanë në rajonin e Anadollit, e kjo vërehet edhe te gjyshi i Osmanit, i cili prej osmanologut Hammeri emërohet si Sylejman Shah, ndërsa nga ana e Inalxhikut si Gunduz Alp. Gjithashtu edhe babai i Osmanit, i quajtur Ertugrul Gazi, që mund të cilësohet edhe si

sulltani i gaziinjëve, ishte lider i gazasë, e kjo vërehet edhe në territorin e fisit të tij, që e zgjeron në një sipërfaqe rreth 4000km², duke përfshirë këtu edhe pushtimin e kalasë së Karacahisarit (Karaxhahisarit).⁵ Siç theksuam edhe më lart, gazaja si një ideologji fetare, e kishte liderin e saj, e që ishte Osmani. Megjithatë Osmani, për dallim prej Yavlak Arslanit, luftën ndaj Bizantit e kishte marrë si prioritet kryesor, madje, siç raporton kronisti bizantin Pachymeresi, në sytë e luftëtarëve Osmani ishte kthyer në një lider të vërtetë.⁶

Ajo çka vërejmë në konceptin e gazasë ishte një ideal i luftës së shenjtë, ideal që solli formimin dhe zhvillimin e shtetit osman. Përmes konceptit të gazasë u krijua edhe koncepti i Kizil Elmas apo Mollës së Kuqe, që nënkuptonte nënshtrimin e botës nga Lindja gjer në Perëndim, madje shumë historianë e cilësojnë vijën e Mollës së Kuqe qytetin e Vjenës. Përmes gazasë nënkuptohej zgjerimi i Dar El Islamit, koncept ky që nënkuptonte mbretërimin e Islamit në të gjithë botën. Ajo çka është simbolike në kuadër të gazasë është nënshtrimi i Darl El Harbit, apo botës së pafe, siç konceptohej në atë kohë, megjithëse jo shkatërrimi i saj⁷, pasi Osmanët e ngrenë shtetin e tyre dhe e shndërruan në një perandori, përmes bashkimit të Anadollit mysliman me Ballkanin e krishterë.⁸

Në ngritjen e një personaliteti në gazi rol të veçantë kishin luajtur ahinjët, të cilët tregonin qëllimin e gaziut, që përbëhej nga sinqeriteti i tyre, dhe jo nga ambicia apo nga hipokrizia e tyre. Megjithatë, nëse i referohemi tregimeve të vjetra turke të Dede Korkutit dhe Danishmendnamesë, atëherë



ngritja e një gaziu bëhej në plotësimin e dhjetë kushteve, siç ishin: kurajë, mungesë e frikës, vetëbesim, fuqi, shpirt i të luftuarit, trimëri, qëndrueshmëri, rezistencë, durim, rrokje e mundësive të krijuara dhe besnikëri ndaj shokëve. Megjithatë gazaja, si një koncept i luftës së shenjtë, është farz kifaje. apo një mision fetar dhe farz ajn. apo mbrojtja nga kërcënimi jetësor, kështu që pretendimet e botës perëndimore, duke e konceptuar gazanë si instrument të justifikimit të ligjshmerisë së vrasjeve dhe të plaçkitjes, pa dyshim se janë pretendime të gabuara.⁹

Fakt i veçantë i gazajës nën sundimin e Osmanit dhe rolin e gazasë në ngritjen e shtetit osman, është edhe përshkrimi i kronikës së Oruçit apo Oruç Tarihi, i cili thekson se “osmanët janë gazitë dhe fitimtarët”, nga kjo nënkuptohej se ishin pikërisht osmanët, gazinjë dhe roli i gazajës solli ngritjen e shtetit Osman. Mbi këto baza, bejllëku i Osmanëve e konsideronin vetën si sejfullah apo shpatë e Zotit, pasi koncepti i krijimit dhe zgjerimit të shtetit, përbëhej nga parimet islame, ndër to edhe gazaja.¹⁰

Nëse e bëjmë krahasimin e kronikës osmane dhe të asaj bizantine në lidhje me çështjen e gazasë, atëherë na paraqitet një koncept i përbashkët. Kjo shihet kur historia e Oruçit e paraqet gazanë si udhë e Sheriatit dhe hak ndaj politeistëve, ndërsa nga ajo që paraqet kronisti bizantin George Palamas është fakti se gazaja nënkuptonte përhapjen e sundimit të Islamit në Perëndim, dhe kjo konceptohej si fat i Zotit.¹¹

Koncepti i gazasë në historiografinë turke, për studimet osmane, ishte ngritur prej Paul Wittek, në vitin 1937, i cili

theksonte se elementi i gazasë ishte elementi kryesor i formimit të shtetit osman dhe zgjerimit të këtij shteti. Osmanologu Wittek i referohet veprës së Ahmediut, e quajtur Iskendername, dhe mbishkrimeve që gjenden në Bursa për Sulltan Orhanin, që e cilësojnë si gazi dhe bir të gaziut.¹² Kjo tezë veçse ishte nisur prej Mehmet Fuad Qypriliut, dhe përkrahej në disa aspekte edhe nga ana e Halil Inalxhikut, mirëpo ky i fundit thekson se gazaja është vetëm një dimension i themelimit të shtetit Osman. Megjithatë, teoria e gazasë ishte një ndër teoritë më të fuqishme, e që edhe sot ka ndikim në historiografi, ku ky element ndikoi të formohej shteti Osman dhe të zgjerohej me një hapësirë të madhe gjeografike, duke i përfshirë edhe kontinente (Azi, Evropë dhe Afrikë).

- 1 Bejllëku Osman, ishte njëri ndër bejllëqet e formuara në territorin e Anadollit. Në aspektin e datës se kur u formua ky bejllëk kemi mospajtueshmëri ndërmjet kronikave osmane, dhe më pas edhe mes osmanologëve. Sipas Halil Inalxhikut, si datë e themelimit të shtetit Osman shënohet 28 korriku i vitit 1302, datë kjo e cila ka si indikator betejën e Koyunhisarit, apo betejën e Bafeusit. Pikërisht kjo betejë, sipas Inalxhikut, e ngriti Osmanin në një bej më karizmatik, pasi para saj ai kishte qenë vetëm një “primus inter pares”, apo i pari ndër të ngjashmit e tij. Shih: Erhan Afyoncu, *Hija e shtetit Osman*, (Tiranë: Fan Noli, 2016), f. 43! Në anën tjetër, teoria tjetër e themelimit të shtetit Osman është ajo e vitit 1299, e që kryesisht i referohen kronikës së Ashik Pasha Zades, ku, ndër të tjerash ai theksonte se: “u këndua hytbe në emër të Osmanit, që lufton për Zotin, pasi ai është i biri i Ertugrullit, Osman Hani”. Kështu që, siç thekson Ashik Pasha Zadeja, pas poezisë është se data kur u këndua hytbeja në emër të Osmanit është viti 1299. Shih: Kemal Yavuz, *Aşık Paşazade Osmanogulları'nın Tarihi*, (İstanbul: Kultur Sanat Tanitimi, 2003), f. 71! Ndër të tjerash kemi edhe pohimin e Menakibnamesë së Isak Fakihut, i cili ishte kadiu i sulltan Orhanit, ku theksohet se: “Osmani kishte urdhëruar këndimin e një hytbeje në emër të tij, hytbe kjo që u mbajt nga dhëndri i Sheh Edebalit, imami i parë i shtetit Osman, Tursun/Dursun Fakihu! Kjo shënoi edhe pavarësinë politike të Osmanit në vitin 1299, pas pushtimit të katër fortesave: Inegol, Bilecik, Yenishehir, Yarhisar. Shih: Johan Von Hammer, *Osmanlı İmparatorluğu Tarihi I*, (İstanbul: İlgi Kultur Sanat, 2011), f. 27!

- 2 Halil Inalxhik, Günsel Renda. *Qytetërimi Osman I*, (Tiranë: Alsar, 2016), f. 37.
- 3 Beteja e Koşedagit (Koshedagit) u zhvillua në vitin 1243, në periudhën e sulltan Gıyasettin Keyhusravit II, betejë kjo që e shënoi edhe vasalitetin e shtetit të selxhukëve nën Perandorinë Mongole.
- 4 Mehmet Maksudoglu, *Historia Osmane dhe Institucionet*, (Tiranë: Alsar, 2019), f. 21.
- 5 Pushtimi i Kalasë së Karaxhahisarit prej turqve ishte zhvilluar dy herë. Hera e parë e pushtimit ishte në vitin 1236, me ndihmën e sulltan Alaeddin Kejkubadit, dhe hera e dytë prej Osman Gaziut, në vitin ۱۲۸۸.
- 6 Halil Inalxhik, *Devlet-i 'Aliye Studime mbi Perandorinë Osmane, periudha klasike (1302-1606) zhvillimi politik, institucional e ekonomik*, (Tiranë: Fan Noli, 2021), f. 14.
- 7 Nënshtrimi i Darl El Harbit në shtetin Osman nuk përkufizohej asnjëherë me shkatërrimin e ndonjë vendi, kjo pasi shteti Osman kishte instaluar politikën e Islametit, e cila ishte ngritur si institucion në shtetin Osman. Politika e Islametit ishte një politikë që kishte të bënte me të bërit për vete dikënd, përmes tolerancës, dhe kjo vërehet te shteti Osman, ku ka nuanca të tolerancës. Shih: Inalxhik, *Qytetërimi I*, f. 39-40
- 8 Halil Inalxhik, *Perandoria Osmane periudha klasike 1300-1600*, (Tiranë: Dituria, 2013), f. 15-16.
- 9 Inalxhik, Renda, *Qytetërimi I*, f. 48.
- 10 Inalxhik, *Devlet-i 'Aliye*, f. 23.
- 11 Inalxhik, Renda, *Qytetërimi I*, f. 44.
- 12 Në lidhje me tezën e gazasë, shih veprën: Paul Wittek, *The Rise of the Ottoman Empires*, (London: The Royal Asiatic Society of Great Britain and Ireland, 1965)!

Në Kosovë u kremtua festa e Bajramit të Kurbanit

Më 28 qershor 2023

Myslimanët anembanë botës sot e kremtuan njëren nga festat kryesore të Islamit, Bajramin e Kurbanit. Edhe në Kosovë, në të gjitha xhamitë e Kosovës, në mënyrë solemne u kremtua kjo festë. Ceremonia kryesore e faljes së Namazit të Bajramit u mbajt në Xhaminë e Madhe në Prishtinë, me mesazhe për paqe, solidaritet, harmoni dhe dashuri ndaj njëri-tjetrit. Ceremonia filloi me faljen e namazit të sabahut, të cilit i priu Bashkim ef. Mehani, ndërsa ligjëratën kushtuar festës së Bajramit të Kurbanit e mbajti Dr. Selatin Mehani, kurse namazit të Bajramit i priu Burhan ef. Hashani, e hytben e mbajti Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili në këtë hytbe potencoi rëndësinë e kryerjes së haxhit, si shtyllë e Islamit, si dhe solidaritetin e besimtarëve me therjen e kurbanit. Myftiu Tërnavë nga kjo hytbe përçoi mesazhet e tij për paqe në gjithë botën, duke potencuar se tensionet e fundit të krijuara duhet te tejkalohen sa më parë. Festa e Bajramit të Kurbanit për besimtarët myslimanë vjen pas kryerjes së obligimit të haxhit, e edhe nga

Kosova shumë besimtarë po e kryejnë këtë obligim. Ndërsa, që nga falja e namazit të Bajramit besimtarët myslimanë therin kurbane, për ta dëshmuar sakrificën ndaj Krijuesit dhe solidaritetin me njëri-tjetrin. Myftiu Tërnavë ka shprehur shqetësimin e tij edhe për shtimin e dhunës në familje, si dhe për rritjen e numrit të divorceve dhe rënien e natalitetit.

Myftiu Tërnavë në vazhdim foli edhe për gjendjen e sigurisë, duke kërkuar shtensionim të situatës. Ai ka kërkuar që Qeveria dhe institucionet ndërkombëtare të punojnë edhe më shumë në këtë drejtim.

“Të nderuar vëllezër dhe motra, kjo festë është edhe shoqërore, prandaj përkushtimi për shoqërinë është obligim në fenë islame, ashtu që askush mos mos ndihet i privuar nga të mirat materiale. Prandaj, të qëndrojmë të solidarizuar dhe në harmoni me njëri-tjetrin!” (...) “Veprat e këqija janë ato që e cenojnë fenë islame, dhuna e çdo lloji, tradhtia bashkëshortore, bixhozi, alkooli, të gjitha këto janë pothuajse të njëjta”, ka theksuar Tërnavë.



PRITJE PËR URIME ME RASTIN E FESTËS SË BAJRAMIT TË KURBANIT

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës edhe këtë herë, sikurse viteve të tjera, organizoi pritje për urime me rastin e festës së Bajramit të Kurbanit. Për të uruar në vizitë erdhën krerët më të lartë shtetëror, përfaqësuesit e partive politike, përfaqësuesit e misionëve të ndryshme në Kosovë, përfaqësues të jetës fetare, kulturore etj. Në pritje të tyre ishte myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava me bashkëpunëtorë.

Përfaqësuesit e institucioneve që erdhën për vizitë në Kryesinë e BIK-ut ishin:

- Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti.
- Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca
- Ipeshkvi i Kosovës, Don Lush Gjergji
- Shefi i EULEX, Giovanni Pietro Barbano
- Ambasadori i OSBE-së, Michael Davenport
- Shefja UNMIK-ut, Caroline Zijadeh
- Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama etj.

Përfaqësuesit e partive politike:

- Memli Krasniqi, Kryetar i PDK-së.
- Lumir Abdixhiku, Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës.
- Ramush Haradinaj, Kryetar i AAK-së.
- Kryetari i Partisë së Ashkalinjve për Integrim, Qazim Rrahmani
- Po ashtu për vizitë ishin edhe shumë udhëheqës të tjerë të sektorëve të rëndësishëm të jetës në Kosovë.





PAS VIZITËS DEKLARUAN:

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca: “E shfrytëzoj rastin që në emër të Kuvendit të Kosovës, myftiut Tërnavë dhe të gjithë besimtarëve t’ua uroj Bajramin e Kurbanit. Shfrytëzoj rastin ta falënderoj myftiun Tërnavë për punën e tij në dimensionin edhe të zhvillimit të misionëve humane, e të cilat Bashkësia Islame gjithnjë i ka zhvilluar. Po ju uroj edhe një herë për këtë festë të rëndësishme, e po shpresoj që kjo festë të ju sjellë fat, lumturi e paqe”, - deklaroi Konjufca.



Kryeministri Albin Kurti, pasi e falënderoi për bashkëpunimin dhe angazhimin që Bashkësia Islame e Kosovës, edhe myftiu Tërnavë kanë shprehur, tha: “Erdhëm për të ju falënderuar për rolin që vetë BIK-u dhe myftiu si udhëheqës e ka luajtur në vazhdimësi, si dhe për t’i uruar për Bajram. Të mirat, duke u ndarë, shtohen, pasi duke u ndarë bëhen të mira për të gjithë. Nuk ka ditë më të përshtatshme për ta uruar këtë ditë sesa festa e Bajramit të Kurbanit”, - tha Kurti.



Kryepeshki i Peshkvisë së Kosovës, Don Lush Gjergji: “Jemi këtu për t’ia shprehur myftiut urimet më të përzemërta për këtë festë, të Bajramit të Kurban. Flijimi, vuajtja dhe mësimi janë kapitali ynë. Ne kemi vuajtur, pësuar e mësuar ndër vite. Ne besojmë në Zot, prandaj besojmë edhe në njëri-tjetrin”, - tha Don Lush Gjergji.



Memli Krasniqi, kryetar i PDK-së: “Në emër të PDK-së e uroj myftiun, dhe përmes tij të gjithë anëtarët dhe besimtarët. Kjo është një festë që na e simbolizon solidaritetin dhe sakrificën. Në mënyrë të veçantë i kujtojmë miqtë tanë që ndodhen në Hagë. Ua urojmë atyre nga këtu këtë festë”, - tha Krasniqi.



Lumir Abdixhiku, kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës: “Sot, me bashkëpunëtorë të LDK-së, e vizituam BIK-un dhe myftiun Tërnavë, dhe nëpërmes tij ua uruam festën të gjithë besimtarëve. Më lejoni të ju uroj edhe ju, gazetarëve në veçanti. Kjo është festë edhe për familjet tuaja, e ju sot jeni në punë”, - u shpreh Abdixhiku.

Ramush Haradinaj, kryetar i AAK-së: “Sot personalisht, po edhe me kolegë të Aleancës, e kemi nderin t’i shprehim urimet për festën e Bajramit të Kurbanit. Ne na ka përcjellë sakrifica, e edhe porositja e Bajramit të Kurbanit është sakrifica. Ne do të vazhdojmë të qëndrojmë bashkë si shqiptarë, dhe do të festojmë bashkë”, tha Haradinaj.

Qazim Rrahmani, kryetar i Partisë së Ashkalinjve për Integrim: “Në emër të Partisë së Ashkalinjve për Integrim e shfrytëzoj rastin ta uroj festën e Bajramit të Kurbanit! Qoftë kjo festë e solidaritetit, e paqes dhe e harmonisë! Zoti i bekoftë gjithë popujt, e edhe popullin tonë të Kosovës”, u shpreh Rrahmani.

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RADHËS



Me më 1 qershor Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, në mbledhjen e sotme, të kryesuar nga kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë, shqyrtoi raportin mbi aktivitetin gjatë muajit Ramazan 2023, raportin mbi zekatin dhe sadekatul-fitrin për këtë vit, parapërgatitjet për Haxhin 2023, si dhe

shqyrtoi lëndë të ndryshme dhe mori vendime në bazë të kompetencave që i takojnë kësaj Kryesie. Myftiu Tërnavë shprehu falënderimin e tij për gjithë anëtarët e Kryesisë, si dhe për të gjithë punëtorët e BIK-ut për kontributin dhe mundin që janë duke dhënë në shërbim të ngritjes së fjalës së Allahut xh. sh. . Ai

tha se kjo është një përgjegjësi që e kemi marrë mbi supet tona, andaj duhet të tregohemi të matur për këtë amanet, por edhe të guximshëm bazuar në përgjegjësinë tonë që kemi si para Zotit ashtu edhe para besimtarëve tanë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NËNKRYETARIN E XHAMISË “MESXHIDI NUR” NË FRAUNFELD TË ZVICRËS

Më 2 qershor Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim nënkryetarin e xhamisë “Mesxhidi Nur” në Fraunfeld të Zvicrës, z. Xhabir Shala. Myftiu Tërnavë e falënderoi z. Shala për vizitën dhe për gjithë kontributin që janë duke dhënë për mirëqenien e besimtarëve myslimanë shqiptarë atje. Ai edhe njëherë rikonfirmoi gatishmërinë e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që edhe më tej të vazhdohet dhe të intensifikohet bashkëpunimi me qendrat dhe xhamitë në diasporë. Nga ana e tij, nënkryetari Shala shprehu falënderimet e tij për ndihmën e ofruar nga Bashkësia Islame e Kosovës sa herë që është kërkuar një gjë e tillë. Gjatë këtij takimi nënkryetari Shala dorëzoi te Bashkësia Islame e Kosovës shumën



e vitrave të mbledhur te mërgimtarët tanë. Gjatë kësaj vizite, nënkryetari Shala, vizitoi edhe Institutin për

Hulumtime dhe Studime Islame, në të cilin u mirëprit nga drejtori i saj, prof. Sabri ef. Bajgora.

MYFTIU TËRNAVA VURI GURTHEMELIN E XHAMISË SË RE NË LAGJEN KODRA E TRIMAVE NË PRISHTINË

Më 5 qershor në lagjen Kodra e Trimave në kryeqytet afër shkollës fillore “Hilmi Rakovica” është vendosur gurthemeli i xhamisë së re. Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Termava, kryemami i Kosovës, Vedat Sahiti, imamë dhe besimtarë të shumtë morën pjesë në vënien e gurthemelit të kësaj xhamie. Kjo ceremoni shënoi një ngjarje të rëndësishme për banorët e kësaj pjesë që përballeshin me mungesë të theksuar të xhamisë. Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, tha se ndërtimi i kësaj xhamie, me iniciativë të banorëve është i rëndësishëm së veçantë. Kryetari i Këshillit të BI-së së Prishtinës, Hetem Sopjani, përgëzoi banorët për vënien e gurthemelit të kësaj xhamie. Kjo xhami po ndërtohet pas sigurimit të hapësirës



nga banorët, ndërsa një donator nga Emiratet e Bashkuara Arabe do të përkujdeset për aspektin financiar.

MBAHET TRYEZË SHKENCORE ME RASTIN E 120 VJETORIT TË LINDJES SË HFZ. FAHRI EF. ILJAZIT



Me 8 qershor Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame organizoi tryezë shkencore me rastin e 120-vjetorit të lindjes së hfz Fahri ef. Iljazit- Alim dhe udhëheqës i shquar i Bashkësisë Islame, ku u vlerësua jeta, vepra dhe kontributi e njërit prej personaliteteve, myderrizëve, myftinjve e alimëve më të shquar të Bashkësisë Islame në shekullin e kaluar – hafiz Fahri efendi

Iljazit. Në këtë Konferencë morën pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, Sabri Bajgora – Drejtor i Institutit të Hulumtimeve dhe Studimeve Islame, dekani i FSI-së Dr. Islam Hasani, Ramadan Shkodra – Drejtor për Botime – BIK, anëtarët e Kryesisë së BIK-ut, familjarë të familjes Iljazi, përfaqësues të KB Islame të Kosovës, hulumtues, profesor e shumë

të pjesëmarrës tjerë. Tryeza filloi me ashërë kënduar nga – Ylli Kaçiku.

Kurse në fjalën e hapjes Ramadan Shkodra – Drejtor për Botime – BIK foli në emër të Këshillit Organizativ tha se falënderoi të gjithë pjesëmarrësit te cilët kontribuan me kumtesat e Njëherazi ai premtoi se me mbështetjen e Myftiut Tërnavë do të mbahen edhe tryeza tjera dhe aktivitetet kulturore. Ai

tha se në këtë tryezë shkencore kujtojmë rolin dhe kontributin e një prej ulemave tonë hfz Fahri ef. Iljazit- Alim dhe udhëheqës i shquar i Bashkësisë Islame.

Më pas Sabri Bajgora – Drejtor i Institutit të Hulumtimeve dhe Studimeve Islame tha se : është nder dhe privilegj i veçantë që sot gjendemi në këtë Sallë, për një ngjarje të këtillë shkencore, siç është kjo tryezë shkencore, që i dedikohet një figure kaq emblematike siç është figura e ndritur e alimit dhe udhëheqësit të shquar të Bashkësisë Islame, Hfz. Fahri ef. Iljazi. Fatmirësisht, në këtë Tryezë shkencore, ende kemi njerëz që e mbajnë gjallë kujtimin për të, dhe nga ata do të dëgjojmë mbresa e kujtime të dorës së parë. Për neve, është po ashtu një nder, që në mesin tonë, në Kryesinë e BIK-ut, kemi edhe nipin e Hfz. Fahri efendiut, Fatmir ef. Iljazin, i cili e vazhdon me sukses këtë rrugëtim gjeneratash të familjes së madhe Efendija. Nga shumë prej gjeneratës së tyre që janë shkolluar nëpërmjet duarve të këtij alimi të madh, gjithnjë kemi dëgjuar fjalë të mëdha, por në fund, të gjithë ata, e ndjenin veten të pafuqishëm ta përshkruanin në mënyrë meritore personalitetin e tij të pashoq. Ky alim i madh, së bashku me shokët e tij, ishin sikur drita nëpërmjet të cilës udhëzohej populli.

Në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, tha se organizimi i kësaj Tryeze shkencore për myderriz Fahri ef. Iljazin, edhe njëherë dëshmon vendosmërinë e Kryesisë së BIK-ut, për të vazhduar traditën e saj të nisur vitet e fundit për ndriçimin e asaj plejade të tërë të ulemave që u shquan ndër vite e dekada për punën e tyre vetëmohuese e këmbëngulëse për të mirën e njerëzimit, të fesë dhe të atdheut tonë. Myderriz Fahri efendiut, – me gjithë që jetoi e veproi në kohë të vështira ku ndërrimet e sistemeve shoqërore e ideologjike ishin të shpeshta dhe në të shumtën e rasteve edhe të dëmshme e me pasoja për ne si popull, dhe të cilat nuk ishin



aspak dashamirëse për besimet në përgjithësi, e besimin islam në veçanti, – ai falë edukimit të mirë e të drejt që kishte marrë që nga familja disa breza hoxhallarësh dhe i kalitur e formuar nga qarku i ulemasë së Gjakovës, tërë jetën ia kushtoi misionit për të cilin ishte përgatitur, për din e iman, për fe dhe për të mirën e shoqërisë dhe të vendit, gjithnjë mbi parimet dhe mësimet e Kuranit fisnik, të cilin e kishte mësuar përmendsh që në rininë e tij, tek i ati i tij muhafizi e myderrizi i njohur Iljaz ef. tek i cili edhe i nisi edhe studimet në Medresenë e Madhe të Gjakovës, për t'i përfunduar me ixhazet në medresenë e njohur “Mehmet Pasha” të Prizrenit para myderriz, myftiut e dijetarit Hafiz Nysret efendi Galibit. Në fund, edhe një herë përgëzoj IHSI për organizimin e kësaj tryeze shkencore dhe mirënjohje e falënderim gjithë dashamirësve dhe kontribuuesve për ndriçimin dhe vlerësimin e jetës dhe veprës së Hafiz Fahri efendi Iljazit, për shpirtin fisnik të të cilit, ju lus të këndojmë bashkërisht një “Fatiha”!

Në emër të familjes, të pranishmit i përshëndeti Muhamed Iljazi – I biri i Fahri ef. Iljazit i cili falënderoi Myftiun Tërnavë dhe BIRK-un për organizimin e kësaj tryeze shkencore.

Drejtuës i seancës është kryeimami I BIK-ut, Vedat ef. Sahiti.

Në pjesën tematike me kumtesa u paraqitën. Dr. Sadik Mehmeti “Të dhëna për shkollimin e Fahri ef. Iljazit dhe aktiviteti i tij si myderriz në Medresenë e Madhe të Gjakovës; – Mr. Ramadan Shkodra Kontributi i Fahri ef. Iljazit në riorganizimin e Bashkësisë Islame të Kosovës pas Luftës Dytë Botërore; – Akad. Feti Mehdiu Fahri ef. Iljazi dhe mevludi i Tahir efendi Popovës; – Alban Dobruna Fahri ef. Iljazi – kryetar i Nënmyftinisë së Gjakovës gjatë Luftës së Dytë Botërore; – Elez Osmani Fahri ef. Iljazi – (1903-1985) në kujtesën time; – Esat Rexha Kujtimet e mia për Myderriz Fahri ef. Iljazin; kurse fjalën përmbyllëse e bëri Dr. Valon Myrta – Kryetar i KBI – Gjakovë.

RIHAPET XHAMIA E PLANEJËS SË PRIZRENIT QË ISHTE SHKATËRRUAR GJATË LUFTËS

Me 12 qershor Xhamia e Planejës në Prizren edhe zyrtarisht është rihapur pas dy dekadave. Rihapja e saj u bë në një organizim me këndim të kuranit dhe tekbireve.

Banorë, besimtarë, imam morën pjesë në hapjen e kësaj xhamie, ku veç tjerash në këtë rihapje të kësaj xhamie mori pjesë edhe Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Kjo xhami ishte ndërtuar më 1785 nga banorët, por më pas ishte mbyllur, ndërsa gjatë luftës ishte rrënuar tërësisht për të mbetur për dy dekada vetëm rrënojat e kësaj xhamie.

Në Ditën e Çlirimit të Prizrenit kjo xhami u rihap përsëri, ndërsa u theksua nevoja e jashtëzakonshme për banorët e asaj pjesë që të rihapet kjo xhami.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë tha gjatë kësaj ceremonie se roli dhe



rëndësia e kësaj xhamie që ka luajtur në të kaluarën është jashtëzakonisht e rëndësishme, aq sa edhe rifunksionalizimi i saj që të jetë në përdorim të besimtarëve mysliman.

Në anën tjetër edhe Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Prizren, Besim Berisha dhe Kryeimami i këtij qyteti, Orhan Bislimaj e konsideruan

jashtëzakonisht të rëndësishme rihapjen e kësaj xhami për faktin historik ashtu edhe për rolin që do të ketë në komunitet.

Menjëherë u bë thirrje tek banorët e kësaj pjesë që aktivitetet për mësim besim do të fillojnë në këtë xhami me fëmijë të grup moshave të ndryshme.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NGA KOMUNA OSMANGAZI E BURSËS

Me 16 qershor Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim një delegacion nga komuna Osmangazi nga Bursa, të kryesuar nga kryetari Mustafa Dundar. Në këtë takim Myftiu Tërnavë i njohu mysafirët mbi historinë, organizimin dhe aktivitetet e BIK-ut, duke theksuar se ne vazhdimisht jemi përpjekur dhe kemi dëshmuar se shoqëria jonë kosovare është shoqëri që respekton diversitetin fetar dhe kulturor të të gjitha komuniteteve. Komunitetet fetare në Kosovë jetojnë në paqe, harmoni dhe dashuri njëri me tjetrin dhe asnjëherë nuk kemi pasur problem ndërfaqetare. Myftiu Tërnavë më tej falënderoi shtetin dhe popullin mik të Turqisë për kontributin që ka dhënë dhe që po jep për Kosovë, si dhe shoqatat turke që janë këtu në Kosovë si “Yunus Emre”, Drejtoria e Vakëfeve etj. Ai po ashtu theksoi se mërgatën tonë kudo që të jenë e veçanërisht në



Turqi të cilët kanë dhënë një kontribut të madh dhe të vazhdueshëm për Kosovën në të gjitha periudhat. Nga ana e tij, kryetari i komunës Osmangazi nga Bursa, Mustafa Dundar, shprehu falënderime për mikpritjen nga Myftiu Tërnavë dhe BIK-un që vazhdimisht kanë ndihmuar shqiptarët në Turqi dhe se angazhimi dhe përkujdesja e

institucionit të BIK-ut asnjëherë nuk ka munguar. Ai shprehet i lumtur që Kosova për çdo ditë po ndërtohet, zhvillohet dhe përparon dhe kjo neve na gëzon pa masë. Në fund dy palët u pajtuan se bashkëpunimi edhe më duhet të vazhdojë në të mirë të dy vendeve.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KMSHZ-SË MEHAS EF. ALIJA

Më 19 qershor Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar me drejtorin për Diasporë, z. Ekrem Simnica, ka pritur sot në takim kryetarin e Komunitetit Mysliman Shqiptar të Zvicrës, njëherësh imamin e xhamisë “El Hidaje”, Mehas ef. Alijan. Myftiu Tërnavë e falënderoi z. Alijan për vizitën dhe për gjithë kontributin që janë duke dhënë ai dhe Komuniteti Mysliman Shqiptar në Zvicër për mirëqenien e besimtarëve myslimanë shqiptarë atje. Ai edhe njëherë rikonfirmoi gatishmërinë e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që edhe më tej të vazhdohet dhe të intensifikohet bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy institucioneve.



Myftiu Tërnavë çmoi lart angazhimin dhe punën e deritanishme të KMSHZ-së. Nga ana e tij, kryetari Alija shprehu falënderimet e tij dhe të institucionit që

ai drejton për bashkëpunimin dhe për ndihmën e ofruar nga Bashkësia Islame e Kosovës sa herë që është kërkuar një gjë e tillë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E SHOQATËS ME TË PAMË TË DOBËSUAR

Me 20 qershor Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë priti në takim kryetarin e Shoqatës së të Verbërve dhe me të Pamë të Dobësuar në Prishtinë, z. Behxhet Gashin. Në këtë takim Myftiu Tërnavë pranoi mirënjohje në shenjë falënderimi nga kryetari i kësaj shoqate në Prishtinë, i cili çmoi lartë bashkëpunimin dhe angazhimin e Myftiut Tërnavë ndaj kësaj shoqate, por edhe personave me të pamë të dobësuar. Në anën tjetër, Myftiu Tërnavë u zotua se bashkëpunimi dhe angazhimi i Bashkësisë Islame të Kosovës, me këtë shoqatë nuk do të ndalet asnjëherë dhe se në vazhdimësi do të jetë afër kësaj kategorie të



shoqërisë. Përveç tjerash, Myftiu shprehu gatishmërinë se do të jetë

pranë kësaj shoqate në secilin shqetësim të saj.

MYFTIU TËRNAVA, PRITI NË TAKIM AKADEMIKËT FETIH MEHDIUN DHE MUHAMED MUFAKUN

Me 20 qershor Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në selinë e Kryesisë dy akademikë e shquar, Fetih Mehdiun dhe Muhamed Mufakun, ku diskutuan për rolin e intelektualëve në shoqërinë

moderne si dhe në veçanti për projektin e ndriçimit të personaliteteve fetare shqiptare. Akademikë Fetih Mediu dhe Muhamed Mufaku, falënderuan Myftiun Tërnavë për mbështetjen e ofruar dhe bashkëpunimin e ngushtë

në lidhje me ndriçimin e personaliteteve fetare, një fushë në të cilën sipas tyre është e domosdoshme të punohen dhe të ndriçohen personalitet e tilla. Në anën tjetër, Myftiu Tërnavë, çmoi lartë rolin e dy akademikëve në angazhimin

e tyre për ndriçimin e personaliteteve fetare, por mbi të gjitha për rolin e tyre të intelektualëve që kanë. Takimi u vlerësua si një mundësi e rëndësishme për të ndarë pikëpamjet, përvojat dhe idetë në lidhje me rolin dhe kontributin e intelektualëve në shoqëri. U theksua se bashkëpunimi i tilla ndërmjet Myftiut të Kosovës dhe akademikëve të shquar është i domosdoshëm për të avancuar shoqërinë dhe për të promovuar vlerat e përbashkëta.



MYFTIU TËRNAVA PRITI DISA PREJ NXËNËSVE TË AKADEMISË 'HIFDH KIDS'

Me 21 qershor Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në zyrën e tij disa prej nxënësve të Akademisë së Kuranit 'Hifdh Kids' të shoqëruar nga dy mësueset e tyre, Rineta Nitaj dhe Fatime Nitaj.

Myftiu Tërnavë u shpreh shumë i gëzuar që takoi nxënësit e kësaj akademie si dhe për interesimin e tyre ndaj fesë islame. Në veçanti vlerësoi përgatitjen e tyre të larta fetare të marra gjatë mësim besimit në 'Hifdh Kids', ku njëkohësisht inkurajoi të gjithë fëmijët që të bëhen pjesë e kësaj akademie. Myftiu gjithashtu inkurajoi nxënësit të angazhohen në shoqëri dhe të ndihmojnë në ndërtimin e një mjedisi të harmonizuar ku janë të dobishëm për shoqërinë, teksa krejt në fund u



dhuroi edhe nga një libër. Në anën tjetër, nxënësit shprehën falënderime të thella ndaj Myftiut Tërnavë për kohën e tij dhe për mënyrën e tij të hapur dhe inkurajuese të komunikimit, teksa nuk

nguruan edhe me pyetje të ndryshme rreth fesë islame apo edhe Festës së Kurban Bajramit dhe Haxhit, periudhë në të cilën gjendemi aktualisht.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM FERID EF. BEDROLLIN

Me 21 qershor Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar me drejtorin për Diasporë, z. Ekrem Simnica, sekretarin e Përgjithshëm të BIK, Ahmet ef. Sadriun dhe drejtorin e Institutit për Hulumtime e Studime Islame, Sabri ef. Bajgora, ka pritur sot në takim Ferid ef. Bedrollin, imam në Qendrën Islame Kulturore Shqiptare në Staten Island të Nju Jorkut. Myftiu Tërnavë e falënderoi imamin Bedrolli për vizitën dhe për gjithë kontributin që janë duke dhënë



ai dhe besimtarët tanë në ShBA. Ai edhe njëherë rikonfirmoi gatishmërinë e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që edhe më tej të vazhdohet dhe të intensifikohet bashkëpunimi me mërgatën tonë të largët. Nga ana e tij, imami Bedrolli shprehu falënderimet e tij dhe të Qendrës që ai drejton për bashkëpunimin dhe për ndihmën e ndërsjellët.

KOSOVËS IU SHTUA EDHE NJË HAFËZ I RI NGA MAMUSHA



Më 4 qershor, në një atmosferë festive, mes tekbireve e salavateve, në xhaminë e re të Mamushës u përurua hafëzi i ri, Burak Taç. Trembëdhjetë vjeçari nga Mamusha, Burak Taç është hafëzi më i ri i Kosovës, i cili e ka mësuar Kuranin përmendsh dhe ka përfunduar hifzin me sukses të plotë para muhafizit, imamit të xhamisë së re në Mamushë, hafëz Musa Akbulut. Krah as duashë së hafizllëkut, u bë edhe duaja e përfundimit të hatmes së dhjetë nxënësve, të cilët kanë vijuar mësim besimin dhe kanë përvetësuar leximin e Kuranit dhe kanë bërë hatme pranë imamit të xhamisë së re në Mamushë. Në këtë manifestim madhështor mori pjesë edhe kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i cili fillimisht e përgëzoi imamin e xhamisë për angazhimin dhe kontributin e madh në edukimin e brezave të rinj, e sidomos në nxjerrjen e hafëzit të ri dhe uroi familjen dhe të gjithë xhematin e Mamushës për hafëzin e ri, duke e lutur Allahun që hafëzi, Allahu, t'i falë shëndet e suksese në jetë dhe të jetë prej atyre hafëzëve të denjë që bartin amanetin e fjalës së Allahut. Hafëzi i ri është një krenari për mbarë Bashkësinë Islame të Kosovës, jo vetëm për familjen e tij, theksoi mes tjerash kryeimami Sahiti.

Madhërisë Sate

*Madhërisë Sate i përulem,
kur toka ballin e thërret.
Madhërisë Sate i lutem,
se vetëm aty zemra është e qetë.
Madhërisë Sate i lotohem,
se gjuha s'gjen dot fjalën e vet.
Madhërisë Sate i përgjrohëm,
se te Ti është shpëtimi i vërtetë.
Madhërisë Sate i drejtohem,
kush tjetër nuk e dëgjon dertin tim.
Madhërisë Sate i falem,
se Ti je dermani i dertit tim.
Madhërisë Sate i ngrita duart,
E pëshpërima mëdëgjohet mbi qiellin e shtatë.
Madhërisë Sate...dhe gjithmonë...
vetëm Madhërisë Sate i lutet ky shpirt i ngratë*

Esma Curri

Forumi për Dialog dhe Paqe në Ballkan

Samiti Ndërkombëtar i Udhëheqësve të Kishave të Krishtere dhe Feve të tjera

PAQJA QOFTË ME JU, EVROPË – PAQJA QOFTË ME JU, BALLKAN!

Në qytetin bregdetar Koper të Sllovenisë, nga 17-18 qershor u mbajt Forumi për Dialog dhe Paqe në Ballkan, nën moton “Paqe ty, Evropë, paqe ty, Ballkan!”. Në këtë ngjarje morën pjesë një numër i madh personalitetesh e autoritetesh të rëndësishme të jetës fetare e kulturore në Ballkan. Në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, në forum morën pjesë shefi i kabinetit të Myftiut Mr. Besim ef. Mehmeti dhe zvendëssekretari Kryesisë, Rexhep ef. Luma.

Krahas tyre, në Forum ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Kishës Katolike, Kishës Ortodokse, Kishës Protestante dhe Komunitetit Hebrej nga shtetet: Sllovenia, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Bullgaria, Kosova, Hungaria, Rumania, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia.

Forumi u organizua nën patronatin e Presidentes të Republikës së Sllovenisë, Dr. Natasha Pirc Musar, e cila foli në fillim të Forumit. Ajo duke i përshëndetur dhe falënderuar pjesëmarrësit në këtë Forum, nënvizoi se është e rëndësishme të diskutohet për paqe, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor. ”Ju si përfaqësues fetarë mund të bëni shumë në këtë aspekt. Sa më shumë bisedime të tilla dhe projekte të përbashkëta, aq më pak do të ketë intolerancë dhe më shumë do të ketë kuptim se zgjidhja është paqja, e jo konflikti.”

Si delegat i Papës Franjo, në forum mori pjesë sekretari shtetit të Vatikanit, Petro Parolin. Kardinali Petro Parolin, në fjalën e tij vuri në dukje se rajoni i Ballkanit dikur dukej fuqi baruti, mirëpo në të njëjtën kohë, ne kemi parë në rajon edhe shumë shembuj të jashtëzakonshëm të bashkëjetesës midis anëtarëve të kombësive, kulturave dhe besimeve të ndryshme”, - theksoi ai. Megjithatë, sipas tij, sfidat në rajon mbeten. Ndër të tjerash, është e nevojshme që vazhdimisht të investohet në kulturën e takimit “që mos të mbizotërojë kultura e konfliktit”.

Në emër të kishës Katolike të Kosovës foli Ipeshkvi Dodë Gjergji. Në fjalimin e tij ai tha se dialogu dhe komunikimi burojnë nga fillimi i njerëzimit, gjë që e predikojnë dhe i japin rëndësi gjithë religjionet abrahamike, përmes librave të shenjtë. Ky fakt tregon rëndësinë e takimit dhe të dialogut. Më pas Ipeshkvi theksoi se “Bukuria e shtetit tim të ri, Kosovës, është se feja te populli im nuk ka qenë asnjëherë burim konflikti, as në kohën e ndarjes në dy kisha, atë katolike dhe ortodokse, e as në kohën e Islamizimit, në kohën e Perandorisë Osmane. Këtë e them me mburrje, dhe e argumentoj se ne jemi kombësia e parë që munda ta ushqejë kulturën kombëtare dhe kulturore të përbashkët brenda dallimit religjioz. Kjo është natyra e të gjithë neve, dhe e kalitur thellë në mesin tonë.”



Më pas Ipeshkvi foli për sfidat, problematikat dhe shembujt e bashkëjetesës fetare, si dhe kontributin e komuniteteve fetare në përf forcimin dhe përhapjen e kulturës së bashkëjetesës dhe tolerancës.

Në emër të myftiut Tërnavë Forumin e përshëndeti shefi i Kabinetit të myftiut Tërnavë, Mr. Besim Mehmeti. Ai, ndër të tjerash, tha: “E nderuara presidente e Sllovenisë; i nderuar Sekretar i Shtetit të Vatikanit, të nderuar të pranishëm! Më lejoni që fillimisht ta falënderoj organizatorin për ftesën, respektin dhe mundësinë për të ju drejtuar ju në këtë audiencë! Edhe pse unë kisha përgatitur ekspozenë time, dhe e kam dërguar tek organizatorët, mirëpo ne në Kosovë, shqiptarët, kemi një marrëveshje të pashkruar, e ajo është se: kur një lider fetar është i pranishëm, dhe tjetri jo, ai flet në emër të të gjithëve, prandaj, meqë në këtë rast pak më parë foli Ipeshki Dodë Gjergji, unë mund të them se edhe ne si komunitet islam qëndrojmë besueshëm pas opinioneve dhe vlerësimeve të tij të paraqitura këtu.” Ky veprim në këtë forum paraqiti një shembull të jashtëzakonshëm të bashkëjetesës fetare duke u përfaqësuar bashkërisht, nga kreu i Kishës Katolike, Ipeshkvi Dodë Gjergji dhe përfaqësuesit e BIK-ut, ndërsa u mirëprit dhe u vlerësua lart prej të pranishmëve në Forum, si dhe u duartrokoi gjatë prej të pranishmëve.

Po ashtu, në një takim të shkurtër presidentja e Sllovenisë vlerësoi lart veprimin e përfaqësuesit të BIK-ut dhe paraqitjen e Ipeshkvit, duke çmuar shembullin e ofruar në konferencë, dhe duke vlerësuar bashkëjetesën fetare në Kosovë. Kjo ngjarje e tëra u transmetua direkt nga televizioni slloven. Kjo konference nxori deklaratën e përbashkët, siç vijon:

DEKLARATA PËRMBYLLËSE E FORUMIT¹

- Meqë të gjithë janë vëllezërit dhe miqtë e mi, unë them: “Paqja qoftë me ju!”, “Paqja qoftë me ju!” (Bibla, Ps 122:6-8).
- Në dekadën e tretë të shekullit të 21-të, Evropa është përfshirë në një seri sprovash: lufta në Ukrainë, krizat në fusha të ndryshme, një largim i përgjithshëm mes njerëzve, si dhe mungesë shprese për të ardhmen. Parashikimet optimiste për integrimin evropian dhe global, bazuar në një kuptim perëndimor sekular të njeriut dhe të shoqërisë, kanë treguar se i kanë kufijtë e tyre. Megjithatë, në çdo periudhë historike ka mundësi dhe vende në kryqëzim të qarqeve kulturore të ndryshme, e që e bëjnë të mundur takimin dhe bisedën, veçanërisht ndër udhëheqësit fetarë, të cilët janë të parët që thirren që të shikojnë përtej agjendave politike dhe të tjerave kalimtare, duke mbetur edhe në lidhje me sëmundjet e kësaj bote. Një nga këto vende është vendi i Sllovenisë, i vendosur në “zemër të Evropës”, mes alpeve, Mesdheut dhe Liqenit Pannonik (hungarez), i cili vepron si një urë mes botëve sllavike, gjermanike dhe romane. Kjo është e reflektuar në një mënyrë të veçantë nga qyteti bregdetar i Koperit (gr. Iustinopolis, lat. Caput Histriae, it. Capodistria), pranë detit Adriatik, i cili me pozicionin gjeografik dhe përvojën historike e lidh Mesdheun lindor dhe perëndimor, dhe po kështu edhe degët lindore dhe perëndimore të krishterimit dhe traditat e tjera fetare.
- Ne, folësit e këtij “Forumi për Dialog dhe Paqe në Ballkan”, jemi të vetëdijshëm për nevojën dhe detyrimin për ta nxitur respektin reciprok dhe bashkëjetesën paqësore mes anëtarëve të traditave të ndryshme fetare, grupeve etnike dhe të tjerave grupe, e cila vërtetohet nga shumë shembuj pozitivë nga historia komplekse dhe sfiduese e kësaj zone gjeografike. Dhe, kemi arritur në një qëndrim të përbashkët, kështu që edhe po i deklarojmë përfundimet e renditura më poshtë:
- Në rrethana të paqëndrueshme, besimi në Zot, i cili nuk i thyen premtimet e tij (Bibla. 2 Kor 1:18), mund të jetë një mbështetje për të ngulmuar në të mira në sferën nderpersonale, shoqërore dhe shpirtërore. Kjo është arsyeja pse udhëheqësit fetarë dhe të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë kanë një perspektivë të përzetshme, që në rrethanat dhe të mirat tokësore kalimtare, ta njohin vetëm veprimin, dhe jo vetëm një qëllim për plotësimin e jetës këtu dhe në jetën që do të vijë.
- Duke u rrënjëzuar në një traditë shpirtërore, të krishterët, myslimanët, dhe hebrenjtë kanë një ndjenjë qëllimi dhe përgjegjësie ndaj çështjeve sociale. Kjo promovohet në mënyrë të parë përmes dialogut që promovon lirinë fetare dhe kujdesin e qëndrueshëm për burimet natyrore dhe zhvillimin ekonomik të balancuar, i cili duhet ta vendosë mirëqenien e personit dhe të komunitetit në qendër, dhe jo nënshtrimin ndaj rritjes ose fitimeve të pakufishme. Në këtë kuptim, perspektiva e” ekologjisë së vëllazërisë njerëzore”, nga letra enciklike Fratelli tutti (2020) e Papa Françeskit, duhet të merret gjithnjë më shumë në konsideratë.
- Arritja e drejtësisë ekologjike dhe ekonomike jep një kontribut vendimtar në punën për promovimin e paqes në Ballkanin Perëndimor, sot dhe në të ardhmen.
- Si personat fetarë, të lidhur nga urtësia e Ungjillit, po edhe ata që e bëjnë paqen dhe, gjithashtu nga mesazhi i pejgamberëve të shenjtë për paqen, qëllimi ynë i përbashkët është arritja e një paqeje të atillë që është fryt i drejtësisë. Ne i bëjmë thirrje të gjithë personave të mirë, veçanërisht atyre me autoritet, që në vend të parë ta paraqesin gjithmonë promovimin e dialogut dhe të paqes.
- Komunitetet fetare, bazuar në angazhimin për dialog dhe ndihmën humanitare për të gjithë ata që preken, pa dallim, duhet të jenë të vetëdijshme për kompleksitetin e situatës së tanishme, dhe ta theksojnë dëshirën e tyre për të qenë të pavarur nga interesat politike dhe të tjerat interesa tokësore.
- Në Ballkanin Perëndimor dhe në vendet e tjera duhet të njihet qartë e drejta e të gjitha komuniteteve fetare për ekzistencë, dhe t’u bëhet thirrje autoriteteve shtetërore për respektimin e lirive të tyre, në interes të paqes dhe të dialogut.
- Ekstremizmi, terrorizmi dhe të gjitha format e dhunës dhe të luftërave nuk kanë asgjë të bëjnë me fe të vërtetë, dhe duhet të refuzohen si në nivel shoqëror, ashtu edhe brenda vetë komuniteteve fetare.
- Në dekadat e fundit, vendet e Gadishullit Ballkanik po e përballojnë gjithashtu një problem demografik, të lidhur me çështjen e emigrimit ekonomik. Dhe, është një çështje e shumanshme - duke përfshirë edhe aspektet morale dhe shpirtërore – e cila kërkon, midis të tjerash, një reflektim kritik të veprimeve të kaluara nga vendimmarrësit politikë, ekonomikë dhe fetarë.
- Po ashtu ka një rëndësi të madhe të takimeve të rregullta dhe kërkimit të zgjidhjeve të përbashkëta midis komuniteteve fetare të ndryshme në Ballkan, dhe Kisha Katolike, Kisha Ortodokse dhe Komuniteti Islam kanë një përgjegjësi të veçantë, duke marrë parasysh ndikimin e tyre historik dhe aktual.
- Nuk mund të ketë takim të singertë dhe dialog të frytshëm pa lutje dhe besim në Krijuesin, i cili është Zotërues i historisë dhe e plotëson atë që njeriu vetëm nuk mund të bëjë. Vetëm një besim i forcuar në Zot dhe një vlerësim i singertë i veprimeve të kaluara të vetvetes, të prekura nga dobësitë njerëzore, ndihmon për të arritur paqe dhe prosperitet në sferat ndërpersonale, sociale dhe shpirtërore.

Koper, 17 qershor 2023

1 <https://katoliska-cerkev.si/koncna-deklaracija-foruma-za-dialog-in-mir-na-balkanu>.

Në qarkullim pjesë e tretë e përmbledhjes "Ligjërime për Fenë e Atdheun"

Tetë vjet pas botimit të përmbledhjes dyvëllimëshe "Ligjërime për Fenë e Atdheun", Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, në vazhdhën e prezantimit të kontributeve, angazhimeve dhe qëndrimeve të Bashkësisë Islame të Kosovës, me Muftiun Naim ef. Tërnavë në krye, e ka vlerësuar si të arsyeshme që të përqartitet për botim edhe vëllimi i tretë, i cili përfshinë fjalimet, trajtesat, qëndrimet, adresimet dhe hyjbet e Muftiut Naim ef. Tërnavë në harkun kohor 2014-2022. Kështu, ky vëllimi si vazhdimësi e dy të mëparshmeve, i cili është para jush, u finalizua pas një pune sistematike në identifikimin, mbledhjen, tubimin, sistemimin dhe redaktimin e materialeve që kanë të bëjnë me aktivitetet, hyjbet, urimet, trajtesat, intervistat, deklaratat etj. e Muftiut për periudhën në fjalë (2014-2022).



REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 392 KORRIK 2023